

JORDAN HAXHINIKOLLA

Barshësi

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32

405

TREGIME

814-32

M35

JORDAN HAXHNIKOLLA

BARDHESI

tregime



1123

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

BARDHËSI

Në muzgun e ditës që po lindte, ndërtesa e re e spitalit të qytetit dukej si një masiv i mbështjellë nga një tis i hollë mjegulle. Qyteti po zgjohej nga qetësia e thellë e natës. Autobusi i parë, që bënte linjën spital-qytet, qëndroi përpara derës së hekurt. Që andej zbritën sanitarët, gratë e lavanterisë dhe njerëz të tjerë.

Infermierja e rojës së repartit të kirurgjisë, Djella Naska, hapi gojën nga pagjumësia dhe shtriqi duart. Edhe kur bënte rojë Djella kishte mjaft urgjenca. Dhe çfarë urgjencash! Nga më të vështirat. Salla e operacionit priste e përcillte të sëmurë. Të tre mjekët, Hasani, Naimi dhe Petriti vetëm në orët e vona, të lodhur e të rraskapitur, dilnin nga salla për të shkuar në shtëpi. Por atë mbrëmje Djella e kaloi mirë. Urgjenca nuk pati. E vetmja e sëmurë që e shqetësoi disa herë gjatë natës qe Kristavgjia, pacientja e dhomës nr. 2.

...Infermierja kontrolloi të sëmurët një për një. Më në fund, hyri në dhomën e Kristavgjisë.

— Mirëmëngjes!, — përshëndeti.

Rrezet e diellit qenë futur nga dritaret dhe ngrohnin shtratin ku flinte Hëna, një grua kooperativiste.

«Së shpejti vijnë mjekët dhe ata duan rregull», —

mendoj infermierja e rojës. Djella hapi dritaren dhe ajri i freskët u fut në dhomë.

— Qenka bërë ditë!, — u dëgjua zëri i Hënës.

— Shoqet e tua tani kanë dalë me kohë në arë, — tha me zë të ëmbël Nora, shitëse zarzavatesh.

— Ne dalim shpejt! Bujqësia ka punë dhe jo llafe. E sëmura tjetër, Besnikja, hapi sytë me përtesë.

— Pse na zgjoni kaq herët!?, — i tha ajo Djellës e pakënaqur. Gratë qeshën. Qeshi edhe Djella.

Teuta, që rrinte në shtratin nr. 11, zbriti nga krevati, mori sapunin dhe peshqirin e doli jashtë për t'u larë.

— Ja ç'do të thotë të jesh e re!, — tha Hëna.

— Dikur edhe ne kemi qenë si ajo: të shkathëta, të freskëta.

— Po, kemi qenë.

— Na ishte njëherë... — u tall Besnikja.

— Fillove ti nga përrallat?!

— Ç'të bësh! Kush e shtyn këtë ditë. Uf, sa keq! Pa hapur sytë mirë fillon e të pushton mërzia.

Hëna ngriti kokën dhe iu drejtua të gjithëve:

— Së shpejti unë ju lë shëndetin. Doktor Hasani më tha të lajmëroj burrin që të vijë të më marrë.

— Lum ti!

Hëna ishte operuar nga dhjami, që i qe shkaktuar nga ngritja e peshave të rënda. Vite me radhë kishte ngritur bucela me ujë, i hidhte në shpinë, i lidhte me litar dhe nisej për në shtëpi. I dridhej shpirti kur e kujtonte. Kooperativistët ndërjuan një kanal ujësje-llës dhe sollën ujë me bollëk. Hëna e hodhi litarin tutje, por dhjami i mbeti.

Teuta u kthye nga banja, e freskët si një lule. Përshëndeti shoqet dhe u fut në shtrat.

— U lave?, — e pyeti Djella.

— Po.

Vajza nxori nga poshtë jastëkut një pasqyrë të vogël dhe u pa me kujdes. Mblodhi buzët. Nxori dhembët. Pastaj ngriti njërën vetull. Siç u duk, mbeti e kënaqur nga pasqyra. Buzëqeshi. Pastaj, sikur të ishte kujtuar, ktheu sytë nga Kristavgjia.

Në qytet e njihnin të gjithë Kristavgjinë; gazeta lokale kishte shkruar disa herë për të, i kishte botuar fotografinë si punëtore e dalluar. Qe shtruar për një dhembje në fund të barkut, të cilën mjekët ende nuk e kishin përcaktuar se nga vinte. Hasani kishte mendimin e tij, kurse Naimi, me sa dukej, nuk qe i një mendjeje me të. Sa herë që doktor Hasani e prekte në fund të barkut me atë dorën e tij të madhe e lesh-tore, Kristavgjia hidhej përpjetë nga dhembja. E vërteta është se gruaja kishte besim të madh te mjeku i vjetër. Ajo e mbante mend Hasanin që prej shumë kohësh. Tërë jetën e tij ai e kishte shkrirë në repartin e kirurgjisë duke operuar njerëz të sëmurë dhe që kishin pësuar aksidente. Tani ai ishte plakur, por kishte mbetur gjithnjë njeri i mirë e i dashur për të gjithë.

Djella iu afrua së sëmurës.

— Kristavgji, si je sot?

— Sëmurë jam, moj Djella.

— Mos u mërzit! Do t'i them mjekut të të vizitojë.

Nga qoshja u dëgjua zëri therës i Besnikes:

— Ah, lëre! Tani do të marrë fund çdo gjë. Mjerë kush ka keq, pa mjekut aq i bën.

— Pse flet ashtu, Besnike?, — e ndërpreu Hëna.

— Pse, si do ti që të flas! Sipas qejfit tënd?

— Mjekët bëjnë çmos për të na shëruar. Thua se ata nuk duan që ne të shërohemi, a? Po dhe mjekët kanë vështirësitë e profesionit të tyre, — foli Kristavgjia.

— Ashtu e ka Besnikja. Lëshon ndonjë fjalë si bombë.

Arsimtarja u zemërua.

— Ky është mendimi im. Ju pëlqen apo jo, mua aq më bën.

Nga korridori u dëgjua zëri i trashë i Hysos, që shpërndante ushqimin.

Hëna e Teuta u ngritën nga shtrati dhe nisën të ndanin mëngjesin bashkë me Djellën.

— Do të hash një çikë?, — e pyeti Djella të sëmurën e shtratit nr. 10.

— Nuk më hahet.

— Teuta, — i tha infermierja maturantes së gjimnazit, — ndihmoje ca Kristavgjinë!

Vajza u çua, iu afrua së sëmurës dhe filloi ta konte me lugë si fëmijë. Në dhomë pllakosi heshtja. Dëgjoheshin vetëm përplasjet e lugëve të vogla pas gotave.

Djella u shërbente të sëmurëve të dhomave nr. 2 dhe nr. 3. Ajo qe e re, rreth 25-vjeçe, me një trup të shëndoshë e të lidhur, me flokë gështenjë, me dy sy të mëdhenj mbi të cilët kalonin si dy harqe të shkurtra vetullat e holla. Shkollën për infermiere e kishte bërë në Korçë. Qysh në fillim e emëruan në spital në repartin e kirurgjisë. E nisi punën me dëshirë të madhe. Zbatonte urdhrat e mjekëve, u shërbente të sëmurëve me dashuri dhe kështu, pak e nga pak fitoi mirënjohjen e tyre. Mjekët e respektonin për kujdesin që tregonte.

Djella kishte një natyrë të dashur. Në trup vinte e shkurtër. Flokët i mbante të mbledhur nën skufjen e bardhë. Kur ndonjë tufë e vogël floku i dilte jashtë

kapuçit, fytyra e saj merrte një bukuri që të bënte për vete.

Atë ditë Hasani erdhi shpejt nga mbledhja e mëngjesit. Pas tij vinin dy kirurgët e tjerë: Naimi dhe Petriti.

Sa vuri këmbë në repart, mjek Hasani e pyeti:

— Si është Kristavgjia?

— Sëmurë, doktor.

— Hm!, — ia bëri mjeku duke rrudhur vetullat.

— Hëngri ndopak?

— Nuk i hahet.

Kryekirurgu u fut në dhomën nr. 2 me duart e lidhura pas shpine.

— Si je, Kristavgji?

— !!!

— Nuk ka fjetur gjithë natën, doktor, — ndërhyri Teuta.

— Rënkon, — foli Hëna.

Mjeku i pa të sëmurat një e nga një me vështrimin e tij të stërvitur.

— Sot më dukesh më mirë, Kristavgji.

E sëmura buzëqeshi.

— E thoni për të më bërë qejfin, — foli ajo.

Shefi lidhi duart nga pas dhe iu afrua.

— Një ditë do të dalësh që këndeje e shëruar. Dëgjomë mua! Kur erdha tani në spital, takova te dera tët shoq. «Po ti ç'rri këtu, — i thashë, — Kristavgjia do të bëhet mirë...».

— E ç'të bëjë dhe ai... — tha ngadalë Kristavgjia.

— E merr malli për ty si duket. Ka ardhur që me natë të të shohë, — bëri shaka mjeku.

— U lodh.

— Pse flet ashtu? Ai të ka shoqe jete.

Besnikja ngriti zërin me sa fuqi pati:

— Është burri yt dhe duhet të interesohet. Unë, po të shoh se im shoq nuk ma var tani që jam në spital, ia rregulloj qejfin.

Mjekët qeshën. Djella iu afrua Kristavgjisë dhe i rregulloi shtratin. Ngriti sytë dhe vështrimi i saj u kryqëzua me atë të Petritit. Djella u skuq. Hoqi vështrimin dhe iu afrua Hasanit. Naimi rrinte pranë shtratis me duar të kryqëzuara përpara gjoksit dhe heshte. Ai gjithnjë heshte. Asnjëherë nuk fliste përpara mjek Hasanit. Mblidhte duart mbi gjoks dhe shikonte herë të sëmuret herë shefin; kur e pyesnin, përgjigjej shkurt me një po ose jo, ose tundte kokën e tij pak të madhe. Ndërsa Petriti ndryshonte nga ai. Mjeku i ri qe mjeshtër i fjalës dhe fliste më tepër sesa dinte. Hasanit i bënte nderime të mëdha me ato gjestet e veta të studjuara e plot elegancë, i paraqiste kartelat e të sëmurëve, ia lexonte me zë prej aktori, ndërsa Hasani, me sytë gjysmë të mbyllur, e dëgjonte me vëmendje duke murmuritur: «Mirë, shumë mirë».

Hasani u kthye nga Djella.

— Ti ishe rojë mbrëmë. Je e lodhur, prandaj mund të ikësh të pushosh.

— Ja, edhe pak.

Mjekët dhe infermierja dolën nga dhoma nr. 2. Djella u fut në infermieri, hoqi bluzën dhe u bë gati për të dalë. Pas saj hyri Petriti.

— Djella, u lodhe gjatë rojës?

— Pak.

— Po të mbyllen sytë!

— Do të vete të fle.

— A sheh ëndrra, Djella?

— Shoh!

— Po mua, a më sheh ndonjëherë?

Infermierja ngriti supet lart dhe buzëqeshi.

— Jo.

— Shumë keq. Kurse unë të shoh çdo natë...

Petriti iu afrua. Djella qëndroi në këmbë, me çantën në dorë.

— Do të takohemi?

— Po tallesh me mua?

— E kam me gjithë mend, Djella.

Ajo e pa në sy. Petriti që i pashëm, me ballin të gjerë, supet të gjera. Çdo gjë që e bukur tek ai njeri: duart, flokët, sytë, veshët. Çdo gjë. Megjithatë, ajo nuk e besonte.

Petrin Lamia po mbushte dy vjet që punonte në repartin e kirurgjisë. Kirurgjia i pat pëlqyer që gjatë jetës studenteske. Iu vu asaj me mish e me shpirt dhe, kur e transferuan në spitalin e rrethit, e caktuan të punonte si kirurg pranë Hasanit dhe Naim Kurtit. Qyteti vitet e fundit që transformuar. Blloqe të tëra banesash qenë ngritur buzë rrugëve duke ia ndryshuar pamjen. Ndërmarrje të reja ngriheshin në periferi të tij, me oxhaqet e larta nga dilnin pa pushim shtëllunga tymi të zi. Banorët qenë shtuar. Kryekirurgu i spitalit, mjek Hasani, pak e nga pak po plakej dhe po i afrohej pensionit. Kohët e fundit ai ankohej për marrje mendsh, për hipje të tensionit të gjakut dhe operonte vetëm rastet e rënda e të vështira. Vërtet ishte dhe Naimi, por operacionet qenë shtuar aq shumë, sa ata të tre mezi u bënëin ballë. Petriti i ishte futur kirurgjisë seriozisht dhe ëndërronte të bëhej kirurg i mirë. Ishte rreth 27-vjeç, po dukej më i ri. Vishej mirë dhe me shije. Pantallonat i mbante të rregullta, ndërsa këmishët më të preferuara kishte ato me ngjyrë të bardhë. Petriti që mjeshtër në lidhjen e nyjës

së kravatës. Që kur qe student në fakultet i kishte dalë nami për këtë punë. Studentët vraponin në dhomën e tij për të lidhur kravatat, sidomos në vigjilje të festave apo mbrëmjeve të vallëzimit. Me vajzat i kishte ecur gjithnjë. Në spital i vinte përqark Djellës. Me sa dukej dhe ajo e simpatizonte, por ngurronte t'ia hapte zemrën. Ai e kuptonte se ajo nuk qe indiferente ndaj tij. Në fund të fundit Djella ishte një vajzë me ndjenja e me ëndrra.

Dera e dhomës së mjekëve trokiti. Petriti ndërpreu fillin e mendimeve. Ai e njihte mirë atë të trokitur. Vetëm Djella trokiste në atë mënyrë.

— Mirëdita, doktor!

— Përse më thërret ashtu, Djella?

— Po si të të thërres?

— Thjesht, Petrit. Dëgjo; Djella. Sot jam rojë dhe kam vendosur të operoj Teutën.

— Teutën?

— Po.

— Bisedove me shefin?

— Bisedova.

— Po atë sikur do ta operonte Naimi.

— Lëre atë, Djella! Nuk më pëlqen kur operon.

Është i rëndë.

— Po të të dëgjonte, me siguri do të ta tregonte qejfin.

— Ia kam thënë në sy.

Djella qeshi.

— Nuk më besohet!

— Për fjalë të nderit, ia kam thënë.

— E pra ai ka një zemër të mrekullueshme. Në radhë të parë mjeku duhet të jetë njeri, pastaj teknik. Kurse ti...

— Kurse unë?

— Ti je tjetër tip. I merr gjërat lehtë.

- Unë?
- Po, ti. Të njoh që nga sytë.
- Djella! Unë të dua, — i tha Petriti me zë të ulët.
- Këtu jemi në punë dhe nuk na kanë lezet këto gjëra.
- Gjithmonë e rregullt dhe shembullore në de-tyrë!

Djella ndërroi bisedë.

- E lexove fletërrufenë që i kanë vënë mjek Hasanit në qytet?
- Jo! Kush ia ka vënë?
- Maturantët e gjimnazit. Se ka mbi derën e shtëpisë një potkua.

— E di...

— Ata e pyesnin se si është e mundur që një mjek i nderuar, i cili merret me shkencë, të besojë në fatin që mund të sjellë një copë hekur.

— Kushedi se si është bërë shefi.

— Është i ndjeshëm si një fëmijë, — tha Djella.

— Unë them se s'ka për t'u përgjigjur, — foli i sigurtë Petriti.

Infermierja doli nga dhoma e mjekëve me disa kartela të sëmurësh në duar. Petriti qëndroi për një çast në këmbë, pastaj u kujtua se ishte mjek rojë atë ditë, dhe, pasi rregulloi pak flokët me dorën e djathtë, u largua nga dhoma. Në korridor mënd u përplas me Stefanin, të shoqin e Kristavgjisë.

— Më falni, — i tha punëtori, — më thanë se këto ditë do të operoni Kristavgjinë. A është e vërtetë?

— Po.

— Besoni se do të shpëtojë?

— Do të bëjmë çmos që operacioni të vejë sa më mirë.

— Ju falemnderit!

Punëtori sillte ndër duar kasketën me njolla vaji. Gishtërinjtë e tij lëviznin gjithë nervozizëm. Burri lëvizte nëpër korridor poshtë e përpjetë dhe nuk linte njeri pa pyetur se si do të shkonte operacioni i Kristavgjisë. Të gjithë i thoshin fjalë të mira. Por a do të dilte mirë me gjithë mend?

Naim Kurti po rrinte në dhomën e mjekëve vetëm. Ajo ishte një dhomë e thjeshtë: Një tavolinë katrore, nja tri karrige, një komo e porsa lyer me bojë vaji mbi të cilën qenë vendosur disa kartela të sëmurësh dhe filma radiografish. Naimi e dinte se midis atyre filmave që dhe ai i Kristavgjisë. Nuk ishte vetëm një, po disa. Naimi i shihte ata gati çdo ditë me kujdes për të lexuar ndonjë gjë të dyshimtë. Por ata heshtnin, qenë të ftohtë, pa shenja patologjike. Çfarë e mundonte atëherë Kristavgjinë? Mos që ndonjë tumor? Naimi dyshonte për një gjë të tillë. Vetëm Hasoni nuk që dakord. Ai ngulte këmbë në të tijën.

Në tavolinën katrore qenë vendosur disa lule të freskëta në një kavanoz. Naimi u afrua pranë tëre, u mori erë dhe ndjeu kënaqësi. «Këto lule i ka vënë Djella», — mendoi. Ajo i kishte këputur me siguri në lulishten e spitalit me dorën e saj delikate. Këtë punë e bënte çdo mëngjes. Për kë i vinte ajo këto lule në dhomë?

— Mirëmëngjes, doktor!

— Mirëmëngjes, Djella!

Sa herë që takohet me Djellën, e pushtonte një ndjenjë gëzimi. Por në të njëjtën kohë ai edhe emocionohet si një djalë i ri, që dashuron për herë të parë. Çfarë që ajo ndjenjë? Pse digjej nga dëshira për të qenë vazhdimisht pranë saj? Në qytet ai njihte mjaft vajza por asnjëra s'i hynte në sy. Kurse Djellës donte

t'i dëgjonte zërin ose fëshfërimën e fustanit, kur ajo ecte në korridor ose në dhomën e të sëmurëve. Këto ndjenja Naimi i mbante të fshehta. I kishte ndrydhur thellë në zemrën e tij, ndaj Djella nuk dinte asgjë.

— Doktor, a do të operohet sot Kristavgjia?

— Do ta operojmë, Djella. Po pres shefin.

Djella iu afrua mjekut.

— Shefit i kanë vënë vënë fletërrufe nxënësit e gjimnazit.

— E lexova. Për mendimin tim, ata kanë të drejtë. Vënia e potkoit mbi derë është thjesht një paragjykim.

Djella e dëgjonte me vëmendje duke e parë drejt e në sy. Një cullufe floku i kishte dalë mbi ballë nga skufja dhe i jepte bukurinë e një vajze të re. Ç'mendonte vallë ajo për Naimin? Ndoshta nuk mendonte asgjë. Ndoshta simpatizonte Petritin. A nuk i shihte shpeshherë tek bisedonin? Çfarë thoshin vallë? Ç'qe ai përpara Petritit? Hiçgjë. Petriti qe fol e qesh me të gjithë, i freskët, i shkathët, i gatshëm për çdo bisedë. Në punë dhe jashtë vishej pastër e hijshëm. Bluzën e bardhë e hekuroste çdo ditë në garderobë. Asnjë qime floku nuk gjeje në bluzën e tij. Në cepin e xhepit dikush kishte shkruar me të qëndisur Dr. P. L. Mos ia kishte qëndisur Djella? Ndoshta.

Naimi qe tjetër natyrë. Më shumë heshte sesa fliste, por, edhe kur i nxirrte fjalët, i peshonte mirë që më parë, prandaj dhe nuk tërhiqte vëmendjen e të tjerëve. Vishej thjesht. Jetën e kishte ndërtuar vetë. I ati e pat lënë të vogël, ndërsa e ëma punonte në fabrikën e cigareve. Pasi mbaroi gjimnazin Naimi i dhanë bursë dhe vazhdoi studimet për mjekësi. Tani qe një kirurg i formuar, i apasionuar pas punës dhe profesionit të kirurgut. Hasani e kishte ndihmuar mjaft

për të çarë në rrugën e kirurgjisë, sidomos vitet e para. Naimi vuri re se shefi përdorte metoda të vjetra operimi. Me sa dukej, ai nuk studjonte, nuk vihej në korent të operacioneve të reja që përshkruheshin nëpër revista të specialitetit. Vërejtjet që i bënte Naimi, shefi nuk i priste mirë. «Ju jeni vartësi im dhe do të bëni ashtu si them unë,» — i pat thënë një herë.

Për Kristavgjinë midis tyre lindën mosmarrëveshje rreth diagnozës dhe mënyrës së operimit. Kristavgjia do të operohej. Naimi po priste të vinte Hasani dhe të hynin në sallën e operacionit. Po ai po vonohej. Përse? Mos e kishte shqetësuar vënia e fletërrufesë nga maurantët e gjimnazit? Ndoshta këshillohej me drejtorin e spitalit nëse duhej t'u përgjigjej apo jo të rinjve që e kritikonin se pse mbante mbi derë një potkua.

Të gjitha këto gjëra Djella i dinte me imtësi. Ajo e çmonte së tepërmi Naimin për aftësitë e tij. Ai ishte i zoti dhe i aftë. Vetëm se qe një tip i mbyllur, gati i vrazhdë.

Edhe tani, në dhomën e mjekëve, sytë e tij shndrisnin nga një gëzim i përmbajtur.

— Djella, ti i ke vënë këto lule?, — e pyeti Naimi me zë të druajtur.

— Pse? Nuk ju pëlqejnë?

— Përkundrazi. Jam i apasionuar pas luleve.

— Prandaj dhe i vë.

— Të falemnderit, Djellë!

Zëri i mjekut kishte një tingull të çuditshëm. Djella u prek nga ai zë i ngrohtë.

Në sallën e operacionit të tre mjekët po laheshin pranë rubinetave ku rridhte ujë me bollëk. Laheshin në qetësi, pa folur. Hasani qe një burrë i shëndoshë,

me shtat të lartë, me shpinën pak të kërrusur. Flokët i ishin thinjur e rralluar. Sa vjet bënte që punonte si kirurg? Ndoshta mund të kishte kaluar në vizitë gjysmën e banorëve të atij qyteti dhe shumë prej tyre i kishte operuar duke i shpëtuar nga vdekja e sigurtë. Studimet i kishte mbaruar në Austri. Punoj nëpër spitale të vjetra, të papërshtatshme. Vetëm pas çlirimit të vendit, në qytet u ndërtua një spital i madh e modern. Reparti i kirurgjisë u pajis me një sallë të bukur, komode për punë, që më parë mjeku as që mund ta ëndërronte. Kirurgu punonte me ëndje dhe mundohej t'u shërbente njerëzve me ndërgjegje. Personeli erdhi duke u shtuar. U shtuan infermieret, u shtuan edhe mjekët. Në fillim i dërguan Naimin, i cili tanimë qe një kirurg i formuar. Dy vjet më parë kishte ardhur Petrit Lamia, i cili po përgatitej për profesionin e vështirë të kirurgut.

Çdo gjë në repartin e kirurgjisë qe bërë me interesimin e Hasanit, por kohët e fundit ai qe plakur, ndonëse në dukje mbahej mirë për moshën e tij. Hasani e kuptonte se forcat e kishin lënë dhe se nuk e kishte më atë rezistencën e dikurshme, kur ngrysej e gdhiehej në sallën e operacionit në këmbë, duke operuar urgjencat. Vitet kishin bërë punën e tyre. Megjithatë Hasani dëshironte të punonte në atë repart, po të qe e mundur, deri në fund jetës së tij. Dikush i pat thënë të dilte në pension. Mjeku qe revoltuar. Të dilte në pension kur ai mund të punonte? Kjo donte të thoshte të largohej nga reparti i kirurgjisë, nga ato sende që e rrethonin dhe që ai vetë, me aq mund i kishte grumbulluar. Jo. Një mijë herë jo. Ai nuk mund ta mendonte veten pa punë. Një gjë e tillë qe për të bërë me vdekjen. Një ditë ai do të dilte në pension. Por jo tani.

Tek lante duart përpara rubinetit, Hasani e ndiente veten të emocionuar. Rasti, që do të operonte sot, nuk qe operacion i lehtë. Ndoshta qe ndër operacionet më të vështira. Në të djathtë të tij lante duart Naimi. Ai dukej fare i qetë. Shefi i hodhi një sy dhe e pa mjekun tek fërkonte gishtërinjtë me furcen e vogël. Nuk dalloi tek ai asnjë emocion «Njeri i çuditshëm është: i heshtur, i ftohtë, por i ndershëm sa s'ka ku të vejë», — mendoi. Ai njeri nuk dinte t'i shtrembëronte gjërat. Ato që mendonte i thoshte hapur, pa druajtje. Ndoshta mungesa e taktit në sjelljet me njerëzit e bënte pak të vrazhdë në sytë e të tjerëve. Dhe pikërisht kjo vrazhdësi nuk i pëlqente Hasanit. Rreth së sëmures nr. 10, ata kishin bërë një farë debati dy ditë më parë.

— Kristavgjinë kam dëshirë ta operoj unë, doktor, — i kishte thënë Naimi. — Aq më tepër që edhe pacientja ka shfaqur një dëshirë të tillë.

Mjeku ngriti sytë nga kartela dhe e pa Naimin në bebe të syrit.

— Domethënë, sipas teje janë të sëmuret ata që përcaktojnë se kush nga mjekët do të operojë në repartin e kirurgjisë? Këtu ka rregull e disiplinë, dhe të lutem, t'i zbatosh ato njëlloj si gjithë të tjerët!

— Mos u zemëroni!...

— Po të kesh ndonjë ankesë kundër meje, ja ku e ke drejtorinë, mund të shkosh të ankohesh kur të duash.

Tek po lahej, Hasanin e zuri një dhembje koke. Ç'të qe ajo dhembje tani, kur duhej ta ndiente veten mirë? Mos i kishte hipur gjë tensioni? Kirurgët e rinj duan të futen menjëherë në thelë, të operojnë stomak, të nxjerrin veshka, sikur operacionet të jenë lodra fëmijësh. A e dinte Naimi si kishte mësuar ai

në kohën e vet? Shefi i tij mezi ia dha zanatin. I qe dashur të punonte si qeni, ditë e natë, vite me radhë, deri sa më në fund arriti të zotëronte sekretet e kirurgjisë. Sigurisht. Naimi e quante konservator. Ndoshta mendonte se Hasani nuk donte t'ia jepte lehtë mjeshtrinë e kirurgut. Le të thoshte si të donte. Aq i bënte. Hasani do ta linte të operonte vetëm atëherë, kur do të bindej se mund ta bënte një gjë të tillë. Po të ndodhte ndonjë fatkeqësi, kush përgjigjej? Sigurisht shefi i repartit. Njerëzit do të thoshin: «U plak dhe Hasani. Pse nuk del xhanëm, në pension, t'ia lërë vendin Naimit?». Kirurgu e dinte nga përvoja se mjekësia është e vështirë dhe nuk mësohet vetëm në libra. Madje, të bëhesh mjek nuk është e vështirë, por të jesh i tillë është e zorshme. Në mjekësi shumë gjëra janë relative. Mund të kesh sukses në mjekimin e një rasti me kancer dhe të dështosh në një rast me rrufë kronike. A e dinte Naimi këtë?


Pas larjes, mjekët kaluan në sallën e operacionit, ku u veshën me bluza sterile.

— Gati?, — pyeti Hasani.

— Gati!


Shefi bëri disa hapa përpara dhe qëndroi pranë tavolinës së operacionit. Përballë tij u vendos Naimi. Dhembja e kokës nuk i kishte kaluar. Hasani e ndjeu se nuk qe në formë. Mendja i fluturoi te fletërrufeja që i kishin vënë nxënësit e gjimnazit. Kirurgut iu duk sikur e shtrëngoi njeri në fyt. Mos e shtrëngonte lidhësja e grykses? Djella i vajti pranë dhe ia zgjidhi. Po dorezat prej llastiku përse nuk ia linin gishtërinjtë të lëviznin si donte ai?

I hodhi përsëri një sy Naimit. Mjeku qëndronte përballë tij i vëmendshëm, i gatshëm «Nuk është njeri i keq, — mendoi Hasani, — po ja që i pëlqen të japë



ndonjë mendje. Po Petriti ku është? Ja, tek po i mat tensionin së sëmurës, i ri, i shkathët, me lëvizjet e tij gjithnjë elegante». Njerëzit dhe aparatet ishin në vendet e tyre. Të gjithë prisnin me sytë ngulur tek ai.

«Duhet të filloj», – mendoi Hasani.



Zgjati dorën nga instrumentisja. Infermierja i vuri mbi dorë një bisturi të re që shndriste nën dritën e fortë të llampës qëndrore. Hasani e ndjeu metalin në dorë dhe u emocionua, si dikur. Mbi barkun e Kris-

tavgjisë u ravijëzua një vijë e bardhë, e hollë, e cila pastaj u mbush me gjak. Operacioni kishte filluar.

Prerja që e bukur, e hequr si me rigë. Naimi fshinte me tampon gjakun e kuq e të ngrohtë, kapte me pinca arterjet e prera në mes dhe i lidhte me shpejtësi. Punonte shpejt e saktë dhe nuk donte të mbetej pas shefit. Më në fund, ja dhe organi i sëmurë. Hasani ndjeu sikur dikush ia kapi zemrën me dorë dhe ia shtrëngoi fort, si të donte ta pengonte që ajo të rrihte. Diagnoza e tij nuk qëlloi në shenjë. Naimi kishte pasur të drejtë. Djersë të ftohta ia mbuluan ballin e gjerë. Djella iu afrua përsëri dhe ia fshiu me garzë.

— Të falemnderit, Djella!, — murmuriti Hasani me një zë të shuar, të pafuqishëm.

Dora iu drodh, iu morën mendtë. Po sikur të rrëzohej aty në mes të sallës? A nuk ishte turp? E tërë vëmendja e tij prej kirurgu me përvojë u përqëndrua në atë organ të sëmurë, ku ngrihej një tumor i madh sa një portokall. Duart mezi i lëviznin. Ç'dreqin kishin?

Naimi e vështroi shefin i habitur. Përse nuk po e vazhdonte operacionin?

«S'është koha për t'u menduar gjatë, duhet vepruar, sepse organet janë jashtë dhe gjendja e së sëmurës nuk pret», — mendoi Naimi.

Hasani vështroi duart e Naimit që lëvizën drejt organit të sëmurë. Gishtërinjtë e tij vepronin me shpejtësi e me shkathtësi.

«Sa bukur! Sa mirë që po e shkëput tumorin nga organi dhe me sa lehtësi!».

— Mbajeni organin mirë! — e urdhëroi Naimi i zhytur në tensionin e punës.

Hasani u bind. Mori tamponin dhe fshiu gjakun,

në mënyrë që Naimi ta shihte më mirë vendin ku operonte. Naimi e tregoi veten mjeshtër të vërtetë! Si nuk e kishte vënë re më parë këtë gjë? Ndoshta maturantët e gjimnazit kishin të drejtë, kur e quanin njeri me mbeturina.

Çdo gjë vajti mirë. Tutje, mbi një tavolinë, u vendos tumori sa një portokall, i kuq, i gjakosur, me ca damarë të frikshëm, që i ngjanin kthetrave të një përbindshi. Kristavgjia do të shpëtonte.

Vizitorët e jashtëm u grumbulluan përpara portës prej hekuri të spitalit. Prisnin orën për të hyrë brenda. Stefani qëndronte fare afër derës, që të hynte sa më parë në dhomën nr. 2.

— Vajti ora, — i tha portierit një plak me syze.

— Do edhe ca, — u përgjigj ai pa e prishur qetësinë.

— Pa dy minuta është.

— Kur të vejë tamam do ta hap. Ti, shoku Stefan, mos më nevikos! Secili bën punën e tij.

Stefani nuk foli. Pa orën e dorës. Donte dhe një minutë të vinte katër pasdite. «Më mirë të numëroj deri në 60'», — tha me vete.

Ai hyri i pari. Pas tij erdhi edhe nëna e Teutës, një grua e bukur por pak e ngjallur. Fill pas asaj, bëri ballë një fshatar i gjatë me fytyrë të imtë, të nxirë nga dielli e me një torbë në dorë.

— Si je tani, Kristavgji?, — e pyeti Stefani të shopen, duke ia mbajtur dorën në pëllëmbët e tij.

— Mirë jam.

— Të falënderosh doktor Naimin. Prej tij e ke jetën.

Kristavgjia lagu buzët me gjuhë.

— Të gjithë janë përpjekur të më shpëtojnë. Nuk do t'ua harroj gjithë jetën e jetës.

— Të kam sjellë një kavanoz me komposto pjeshke. Është shumë e mirë, të jep fuqi.

Stefani mblodhi duart për t'i treguar së shoqes se si do të bëhej ajo pasi të hante komposton.

— Do ta ha, — ia bëri qejfin e shoqja.

— Ja kështu të dua.

Teuta, e sëmura e shtratit nr. 11, nuk i gëzohej dot së ëmës. Nëna i përkëdhelte ballin me dorën e saj të bardhë.

— Si dukesh tani pas operacionit? Doktor Petriti më tha që të mos bëhem merak.

— Kam dhembje barku, moj mama.

— Ashtu është pas operacionit, të keqen mamaja.

— Kam frikë.

— U! Ç'është kjo frikë! Apendicitin ta hoqën. Për pak ditë do të dalësh nga spitali.

— Do të mbetem pas me mësimet, — tha vajza e dëshpëruar.

— Ti je nxënëse e mirë. Do t'i arrish menjëherë shoqet.

Teuta u gëzua si një foshnje. Kujtoi klasën që ziente nga zhurma e nxënësve në kohën e pushimit, mësuesin e matematikës, që «nuk dinte të qeshte», mësuesen e letërsisë të apasionuar pas Migjenit.

— Mama, vërtet të tha doktor Petriti se do të dal së shpejti?

— Po, moj Teuta.

Më në fund do të shpëtonte nga dhoma nr. 2, nga rënkimet orë e çast të të sëmurëve dhe nga pyetjet e bezdisura të mjekëve: «Ku të dhemb? Ke fjetur mirë?». Në shkollë jeta ziente. Atje kishte aq hare e gëzim, sa që Teutës i dukej sikur boshti i gjithë botës

kalonte pikërisht nëpër ndërtesën e gjimnazit, ku mësonte së bashku me shokët e shoqet e veta.

— Mama, — pyeti vajza të ëmën, — a iu përgjigj doktor Hasani fletërrufesë që i vuri klasa jonë?

— Po. Teuta.

Teutës i qeshi nuri. Pra mjek Hasani i qe përgjigjur fletërrufesë së tyre. Kjo qe një gjë e mirë për kirurgun. Kjo do të thoshte se ai e kishte kuptuar kotësinë e atij potkoi mbi derën e shtëpisë. A nuk ishte për të qeshur? Një mjek, njeri i shkencës, mbante mbi derë një copë hekur të ndryshkur nga koha.

Në qoshen tjetër të dhomës, Besnikja, e sëmura e shtratit nr. 13, jepte e merrte me të shoqin.

— U mërzita sa s'ka ku të vejë këtu në spital, more Niko. Mjekët nuk më bëjnë asgjë. Më vënë dorën në bark, më pyesin nëse dal jashtë në rregull, tundin kokën dhe ikin tutje. Ja, kjo punë bëhet përditë.

— Mos u mërzit!, — i tha i shoqi me zë të butë.

Hëna po mblidhte teshat. I shoqi rrinte në këmbë pranë krevatit, i druajtur nga prania e grave. Me bisht të syrit shikonte Besniken dhe habitej me gjuhën e saj të gjatë. Hëna sa nuk fluturonte nga gëzimi. Darka do ta zinte në shtëpi, pranë fëmijëve, pranë njerëzve të saj të dashur.

— Shoqe, ma bëni hallall në ju kam bezdisur!

Fshatarja qëndroi në mes të dhomës me bohçen në dorë.

— Ma bëni hallall!, — përsëriti ajo!

— Ç'është ajo, moj Hënë! Ti na ke kënaqur me muhabet, — i tha Nora, e sëmura e shtratit nr. 12.

— Rruga e mbarë dhe i gjeç të gjithë shëndoshë!, — e uroi Besnikja.

— Po qan?, — e pyeti Hëna duke e përçafuar Besniken.

— Ashtu jam unë. Dukem e ashpër por zemrën e kam të butë e të dhimbshme.

Në dhomë pllakosi heshtja. Shtrati i Hënës mbeti bosh.

— Lum si ajo, shpëtoi!, — foli Kristavgjia.

— Një ditë dhe ti do të dalësh, ke për të parë, — i tha Stefani.

Nora, shitësja e zarzavateve e kishte mbërthyer vështrimin te dera e dhomës. Pse po vonohej i shoqi? Mos nuk qe kthyer akoma nga shërbimi? Një nyjë iu mblodh në fyt. Mos ishte gjë sëmurë? Sa mirë është kur të vijnë njerëzit e tu! Një fjalë e ngrohtë, një vështrim i ëmbël dhe shtrëngimet e duarve shumë herë vlejné më tepër se ilaçet. Pas pak, do të dukej në derë edhe i shoqi i buzëqeshur, i rruar, me kravatën ngjyrë gri, që Nora ia pëlqente aq shumë.

Ndërkohë një autoambulancë u fut me shpejtësi të madhe në oborrin e spitalit. Në dhomën nr. 2 u dëgjua fjala «shpejt» e pësëritur disa herë. Stefani nxori kokën në dritare.

— Sollën një urgjencë, — u shpjegoi grave.

— Uf! Të shkretën!

Shumë njerëz kaluan nëpër korridor, gati sikur vraponin.

— Drejt e në sallë!, — u dëgjua zëri i Naimit.

Më vonë, në dhomë hyri Djella për të shpërndarë barnat. Infermierja shkoi te Kristavgjia, te Besnikja, pastaj erdhi e u ndal te shtrati i Norës, që rrinte e heshtur dhe e trembur.

Djella po shënonte në ambulancën e repartit barnat e të sëmurëve në një regjistër të veçantë. Këtë punë e bënte çdo ditë me kujdes. Në ambulancë dëgjohej fishkëllima monotone e sterilizatorit. Avujt

ngjiteshin lart deri në tavan, pastaj shpërndaheshin në ajrin e ngopur me lagështirë.

Pasi mbaroi, qëndroi e menduar me duart mbi tavolinë. Kohët e fundit ajo mendohej shpesh.

— Puna e mbarë, Djella!

Petriti u fut në ambulancë. Bashkë me të hyri në dhomë një erë e këndshme parfumi.

— Çfarë po bën?

Mjeku zgjati krahun dhe e zuri për dore. Dora e tij iu duk e ftohtë si akull dhe për një çast Djellës iu bë sikur ftohtësia që ndjeu i kaloi nëpër trup. E zemëruar, tërhoqi krahun.

— Ç'pate, Djella?! Sot nuk je në formë, — buzëqeshi Petriti.

— Jo, jam shumë në formë.

— Dua të bisedojmë përsëri për çështjen tonë.

«Unë nuk e dua Petritin», — i shkrepri Djellës në mendje. «Jo, nuk e dua». Fjalët që thoshte i dukeshin false.

Djella mori një pamje serioze dhe iu drejtua mjekut me një ton të ashpër:

— Teuta ka dhembje barku dhe temperaturë.

— Ku është Naimi?

— Në pavion.

Mjeku shoi cigaren dhe doli nga ambulanca me nxitim.

Petriti takoi Naimin dhe së bashku shkuan te shtrati nr. 11. Vajza që skuqur në fytyrë sikur ta kishte djegur rrezet e diellit në një ditë vere. Puls i rrihte shpejt. Prekja e barkut i shkaktonte dhembje të padurueshme.

Mjekët u panë sy më sy.

— Duhet ta operojmë dhe një herë, — foli Naimi kur dolën në korridor.

— Përse po mendon?

— Zor është të ta them, por diçka po ndodh në barkun e saj!

— Dreqi e merr vesh!, — tha Petriti duke kryqëzuar krahët në gjoks i mërzitur. — E operova sipas të gjitha rregullave teknike. Nuk është apendiciti i parë që operoj.

Kirurgët u ndanë. Naimi u kthye në dhomën nr. 2 dhe iu afrua Norës. Kjo grua që një e sëmurë imagjinare. Asaj i që mbushur mendja se kishte shumë sëmundje. Ndoshta vizitat e shumta në mjekë të ndryshëm ia kishin mbushur mendjen se ajo vuante dhe vetëm operacioni mund ta shpëtonte. Naimi kishte ditë që merrej me të. I bënte vetëm mjekim me fjalë, për ta bindur se nuk kishte asgjë dhe prandaj s'që nevoja të operohej.

— Vërtet, doktor?

— Sigurisht.

— Sikur të jetë kështu unë nuk di si t'ju falënderoj.

— Dëgjoni Nora!, — zëri i Naimit që i ëmbël e i ngadalshëm. — Analizat rezultojnë negativ: radiografitë, analizat e gjakut dhe të tjerat.

— Këtë dua dhe unë, — tha gruaja e gëzuar dhe në fytyrën e saj u duk një buzëqeshje e lehtë.

— Unë ju këshilloj të dilni nga spitali, e shoh që nuk ju bën mirë ky ambient.

— Ju falemnderit!

— Kështu pra, pasnesër do të dilni.

— Mirë doktor.

Naimi e njihte mirë Norën. Ajo që një grua e sjellshme dhe e urtë. Sa herë blinte te dyqani i saj i pastër dhe i rregullt. Gruaja që një shitëse e kulturuar dhe të gjithëve u shërbente duke u munduar t'i kë-

naqte me frutat e freskët të dyqanit të saj. Pastaj Naimi kaloi në dhomën e mjekëve; aty gjeti Djellën duke punuar. Mbi tavolinë tufa me lule të freskëta shpërndante një aromë të këndshme në të gjithë dhomën. Ai u mori erë.

Ajo e pa me vëmendje fytyrën e mjekut. Zakonisht, kur Djella ishte vetëm në dhomë, Naimi nuk futej brenda; ai i fliste nga pragu i derës. Sa ndryshonte nga Petriti! Si dita me natën. «Nuk është vështirë të bëhesh mjek, vështirë është të jesh i tillë». Ku e kishite lexuar këtë frazë? Në një libër apo në faqet e gazetës? Ai ishte një kirurg i vërtetë, sikur ishte prerë për të qenë mjek. Naimi bënte çmos t'ua lehtësonte njerëzve dhembjet me fjalë, me barna, ose edhe me thikë, kur e kërkonte nevoja.

— Djella kur e ke lejën sivjet?

Pyetja që e papritur. Naimi e pa në sy dhe buzëqeshi me një naivitet prej fëmije.

— Në korrik.

— Ku do të shkosh të pushosh?

Infermierja ngriti supet.

— Nuk e di. Nuk kam menduar akoma.

— Ti duhet të pushosh, Djella. Dukesh menjëherë që je e lodhur. Pogradeci është një vend shumë i përshtatshëm.

Pse e vështronte ashtu me pamjen e një njeriu që dashuron? Pse mundohej të fshihte ndjenjat e tij? «Eh, sa vështirë është ta kuptosh njeriun se ç'ndjenja e mundojnë!», — mendoi Djella.

Mjeku pa orën e dorës dhe u çua në këmbë.

— Po ikën?, — pyeti Djella.

— I premtova një shoku se do t'i vete në shtëpi. Ka nënën sëmurë. Nuk dua ta bëj të më presë.

Para se të dilte, u kthye edhe një herë nga infermjerja.

— Djella, pasnesër, Nora do të dalë nga spitali. Të lutem pregatiti dokumentet!

Rrezet e diellit u futën në dhomën nr. 2 dhe ranë mbi krevatin e Teutës. E sëmura e kaloi natën keq. Dhembjet nuk e lanë të qetë dhe ia larguan gjumin. Përse ndodhi kështu me të? Dy shoqeve të saj që u operuan nga Naimi në një ditë me të, ua hoqën penjtë dhe po pregatiteshin të dilnin. Kurse ajo do të hante dhe një thikë të dytë. Petriti, që e operoi, nuk i thoshte asgjë. Naimi vinte për ta vizituar, i prekte barkun, shikonte Petritin në sy i heshtur, pastaj dilnin së bashku në korridor për të biseduar. Asnjëri nuk merrte vesh se ç'po ndodhte me të. Teuta dinte vetëm një gjë: nga dita në ditë po bëhej keq e më keq.

Gjatë kohës që po mjekohej në spital, Teuta mori një vendim: do të bëhej mjekë. Vajzës i bënin përshrypje korridoret e bardha, salla e operacionit me llampën e madhe në mes, që i ngjante syrit të një qikllopi gjigant, gatishmëria e infermiereve dhe e mjekëve për t'u shërbyer njerëzve në çaste të vështira. Të gjitha këto lindën tek ajo dëshirën për t'u bërë mjekë. Naimin e shihte aty gjatë gjithë ditës, pastaj në mbrëmje, duke kontrolluar të sëmuret e operuar. Dendur dëgjonte këmbët e tij tek barisnin lehtë në korridor në mes të natës ose dhe më vonë. Kur çlodhej ky njeri? Në figurën e Naimit maturantja idealizoi mjekun më popullor, njeriun që harronte veten për të lehtësuar dhembjet e të tjerëve. Edhe ajo do të bëhej një ditë mjekë dhe do të punonte si Naimi.

— Teuta, moj!

Vajza ktheu vështrimin nga Besnikja.

— Bëhu burrneshë, moj doktoresha jonë e ardhshme! Mos ki frikë. Këtë radhë do të të operojë Naimi.

— Dridhem e tëra.

Teuta zgjati dorën nën jastëk dhe nxori pasqyrën e vogël.

«Sa qenkam dobësuar!», — tha me vete. Mbylli sytë e trishtuar. Përse mjekët kërkonin ta operonin për së dyti? Çfarë kuptonin ata? Po sikur të refuzonte të hynte në sallë? Jo! Nuk mundte. Dhembjet po i bëheshin të padurueshme dhe kishte çaste që Teutës i shkonte ndër mend të fuste duart në plagë dhe ta hapte. Po sikur të vdiste? Sa e marrë që bëhej! Naimi do ta shpëtonte me siguri, si një e një që bëjnë dy.

Në sallë Teuta e mblodhi mendjen. Prania e Naimit e qetësoi. Iu duk sikur dikush ia hoqi frikën me dorë.

Petritin e mundonin dhjetëra mendime. Përse nuk i eci operacioni Teutës? A nuk ishte turp i madh për të që të sëmurën ta operonin dy herë për të njëjtën gjë? Tani në operacion ai nuk ishte kirurgu kryesor. Naimi qëndronte përballë tij i heshtur, por duart i punonin shpejt mbi plagën e hapur rishtazi.

— Ja!, — thirri Naimi duke mbajtur me pincë diçka të kuqe.

— Ç'është ajo?!, — pyeti instrumentistja.

— Garzë! E keni harruar në barkun e së sëmurës.

— .!!!

Petritit iu duk sikur i ra tavani i sallës mbi kokë. Ndjeu vështrimin e njerëzve që merrnin pjesë në operacion dhe ngriu i tëri. Deshi të fliste, por nofullat iu mbërthyen nga një ngërç i fortë. Ishte gafa më e madhe që kishte bërë në jetën e tij prej kirurgu. Ku e kishte pasur mendjen?

Teutën e shpunë në dhomën nr. 2, në krevatin

e saj. E ëma i rrinte vajzës te koka, e ledhatonte, e puthte në ballë duke murmuritur: «Ç'qe kjo pikë e zezë që i ndodhi çupës sime?».

— Mbaje veten!, — i tha Kristavgjia nënës së Teutës.

Zëri i saj qe bërë më i fuqishëm. Një ditë do të dilte nga spitali, do të shkonte te fëmijët e saj, ndërsa Stefani do të gëzohej sa nuk thuhej. Ai e donte Kristavgjinë njëlloj si në muajin e parë të martesës. Ndoshta dhe më shumë. Kristavgjia e njihte mirë të shoqin. Çdo pasdite Stefani vinte në spital të takohej me gruan. Disa herë qe zënë me portierin pasi nuk e linte të hynte brenda. Megjithatë, ai nuk largohej që andej pa u takuar me të.

Në dhomë hyri Djella me rrobat e Norës. Ajo do të dilte nga spitali sipas porosisë së Naimit. Infermierja deshi ta ndihmonte të vishej po Nora nuk pranoi. U vesh vetë ngadalë, pa folur. Pastaj drejtoi trupin, rregulloi flokët, mori fotografinë e të shoqit nga komodina dhe qëndroi në mes të dhomës.

— Atëherë, shoqeni, mirupafshim!

Besnikja zbriti nga shtrati, ndërsa Kristavgjia qëndroi ndenjuri në krevat. Vetëm Teuta nuk lëvizte dot. Ato u përqaftuan në heshtje, pa thënë asnjë fjalë. Dhe ashtu e heshtur, Nora doli nga dhoma nr. 2.

Zilja e telefonit prishi qetësinë e ambulancës së repartit të kirurgjisë. Djella ngriti receptorin.

— Kush jeni, ju lutem?

— Jam doktor Hasani! Djella, ti je? Po si je, moj çupë?, — u dëgjua zëri i kirurgut që përtej fillit të telefonit.

— Mirë jemi, doktor, kemi mjaft punë. Si u bëtë tani? Të gjithë pyesin për ju.

- Çfarë thonë?, – u interesua ai.
- Kur do të ktheheni në spital?
- Pas 3-4 ditësh. Naimi aty është?
- Tani duhet të vijë.

– I thuaj të kalojë nga shtëpia ime, se edhe kafën e kam taze.

Djella qeshi. U dëgjua dhe e qeshura e Hasanit në mikrofon.

- Do t'i them bile menjëherë.

Infermierja la receptorin në vend dhe ndjeu një farë lehtësimi. Hasani do të kthehej përsëri në spital. Me largimin e Petritit nga kirurgjia për një vit dhe dërgimin e tij në punë prodhuese në uzinën e qytetit, reparti mbeti me një mjek mangut. Pas mbledhjes së kolektivit, Petriti nuk u duk më në repart. Çdo mëngjes në orën gjashtë ai hipte në autobusin e uzinës bashkë me punëtorët. Djella e takoi rastësisht dy herë. Që të dyja herët mjeku kishte kthyer kokën mënjanë për të mos e pëshëndetur. Ç'faj i kishte ajo? Për pakujdesinë e tij, Teuta edhe pak humbi jetën. Asnjëri nuk i pati faj. A e pat dashur Djella Petritin? Nuk e dinte. Ajo që vajzë dhe ndiente nevojën që një njeri të mendonte për të, t'i thoshte një fjalë të ëmbël, ta priste me padurim, të shihte orën herë pas here në rast se vonohej. Tani e kishte gjetur. Djella që e sigurtë që Naimi e donte. Po përse nuk ia shprehte? Jo, ai nuk do t'ia thoshte asnjëherë ato dy fjalë të vetme: «Të dua, Djella!». Ajo e kuptonte atë më mirë se me fjalë. E kuptonte nga sytë, nga qëndrimi, nga mënyra se si i prekte lulet që Djella i vinte çdo ditë në tavolinë. E merrte vesh nga gëzimi që ndiente kur ai gjendej pranë saj. Ai bëhej atëherë si një fëmijë: emocionohet, qeshte, skuqej, ose heshte. Edhe Djella

e ndiente veten mirë kur punonte pranë Naimit. I pëlqente të rrinte me të, të bisedonte dhe të dëgjonte teoritë mjekësore që i shpjegonte rreth sëmundjeve. Sa shumë gjëra dinte! Shpesh Djellës i pëlqente ta shikonte vjedhurazi, kur ai nuk i kishte sytë tek ajo. Sapo Naimi ngrinte kryet, ajo hidhte vështrimin në një drejtim tjetër.

Tani ai mbante peshën kryesore të repartit të kirurgjisë. Qëllonte që dy mëngjese bashkë e kishin gjetur në sallë të operacionit. Kur çlodhej ky njeri? Sytë i kishte vazhdimisht të skuqur nga pagjumësia. Në sallë hynin e dilnin të sëmurë të planifikuar, urgjenca të rënda të paplanifikuara, të aksidentuar që dilnin nga operacioni pas disa orëve të zbetë e pa ndjenja nga narkoza. Vetëm ajo, Djella, i dinte të gjitha këto dhe i vinte keq për mjekun. Naimi nuk ankohej. Asnjëherë nuk e hapte gojën përpara infermiereve. Ajo ishte dëshmitare dhe e disa zënieve e grindjeve të vogla midis tij dhe shefit.

Duke menduar për këto, Djella nuk dëgjoi trokitjen dhe nuk e pa derën që u hap. Kur ngriti kokën, sytë e saj u kryqëzuan me ata të Naimit.

— Si janë të sëmurët? Si është Teuta!, — e pyeti.

— Fare mirë, doktor.

Djella, që ai e kishte dashur prej kohe në heshtje, ishte aty në dhomë, vetëm, e veshur me të bardha, e rregullt, e bukur. Kështu do të vazhdonte ta donte gjithnjë? Kur do të merrte guximin t'ia thoshte atë që po mendonte prej disa muajsh? Heshtja u bë e padurueshme. Naimi kërkoi disa fjalë, por ato nuk i erdhën në mendje. Tani ishin vetëm, fare vetëm.

Menjëherë ai ndjeu përbrenda një dëshirë të fortë që e shtyu të fliste.

- Djella!
Infermierja e pa në sy.
– Djella, unë...

Hasani kishte marrë lejën e zakonshme dhe pushonte në shtëpi.

Ishte ulur në kolltukun përkarshi televizorit, i përqëndruar në ekran. Një profesor i nderuar fliste për të mirat dhe të këqijat e antibiotikëve. Hasani e njihte profesorin që shumë vjet më parë. Disa herë kishin udhëtuar së bashku me vapor ose me tren, kur shkonin për studime jashtë shtetit, ose kur ktheheshin në Shqipëri për të kaluar pushimet verore.

Hasani po e merrte veten mirë. Lodhja dhe marramendja i kaluan dhe tani ishte në gjendje të fillonte nga puna. Por a do të mund t'u bënte ballë kërkesave të mëdha të repartit të kirurgjisë? Po sikur të përsëritej kriza?

Çështjen e fletërrufesë së maturantëve mjeku e ndjeu me gjithë mend. Ai iu përgjigj të rinjve me sinqeritetin më të madh, duke u thënë hapur se mbajtja e potkoit mbi derën e shtëpisë që një paragjykim i lashtë, i vjetëruar nga koha, pavarësisht se qëndronte atje që nga koha e gjyshit dhe ai, kryekirurgu i spitalit, ua dinte për nder nxënësve për mësimin që i dhanë. Njeriu gjithnjë mëson, bile edhe në pleqëri.

Po incidenti i Petritit e vrau më shumë Hasanin. Që nga koha që punonte në spital, asnjëherë nuk kishte ndodhur një gjë e tillë e shëmtuar. Një vartës i tij të harronte garzën në barkun e së sëmurës! Kjo ishte e tmerrshme, e shëmtuar. Dhe kush pa, Petriti, të cilin ai shpresonte ta bënte kirurg të talentuar. Kurse Naimi i që dukur i ngathët dhe i heshtur. Me sa shihet, Hasani nuk që treguar psikolog i mirë në njohjen

e vartësve. Njohja e njerëzve kishte qenë një pikë e dobët për të. Gjithmonë gabonte kur arrinte puna për të bërë vlerësimet e aftësive të personelit vartës. Tani i dilte se njeriu të cilit mund t'ia lëshonte pa frikë repartin e kirurgjisë ishte Naimi. Ai e kishte parë me sytë e tij në operacionin që i bënë Kristav-gjisë. Naimi ndërhyri në kohën më të volitshme, atëherë kur Hasani s'po mundte të vepronte më tutje nga dhembja e kokës dhe nga marramendja. Atëherë Naimi e mori përsipër operacionin, duke operuar me një shkathtësi që e habiti: gishtërinjtë i lëvisnin me shpejtësi në thellësi të barkut sikur të ishin pajisur me organe të pamjes.

U dëgjua zilha e derës. Hasani u ngrit. Në prag qëndronte Naim Kurti me kostum dalëboje dhe me këmishën e hapur.

— Shyqyr që e gjete derën, — e ngacmoi shefi, i gëzuar nga vizita e mjekut.

— Kam ardhur me porosinë e Djellës.

— Ah! Urime! Të trashëgoheni! Unë dje e mora vesh fejesën tuaj. M'u bë qejfi shumë. Djellën e kam si vajzën time.

— Ju falemi nderit!

Dhoma e pritjes që e thjeshtë, e këndshme, e lyster me një ngjyrë të ëmbël. Pranë dritares që vendosur një saksu e madhe nga thellësia e së cilës dilnin lart lule krahëshqiponje. Në mur varej një «natyrë e qetë».

— Po shikoni televizorin?

— Ç'të bëj? Ka gjëra interesante!

Naimi u ul përkarshi.

— Po ju bëj një kafe, — tha Hasani.

Nga televizori dëgjohej zëri i ngjirur i profesorit mjek...

Kur Naimi doli nga shtëpia e Hasanit, pothuajse qe errur. Jashtë ishin nderur dritat dhe qyteti gumëzhinte nga zhurma e njerëzve. Pranë tij kalonin me qindra njerëz, punëtorë, ushtarë, nëpunës, vajza të reja të krehura dhe të veshura me kujdes. Dritat e vitrinave ishin nderur dhe u jepnin xhamave të mëdhenj një shkëlqim të bukur.

Naimi pa orën.

— Më tetë kam takim me Djellën përpara kinemasë.

U nis buzagaz për në vendin e takimit.

KUR DOLI DIELLI MAJË MALIT

Ishim në klasë. Mësuesi na kishte dhënë një temë hartimi.

Viktori, që rrinte në bankën e parë, ngriti gishtin.

— Me lejë!

Mësuesi e pa disi i habitur.

— Ç'ke, Viktor?

Nxënësi u ngrit në këmbë.

— Tema është e bukur, me përmbajtje patriotike. A mund të shkruajmë ashtu si ndiejmë?

Viktori hodhi vështrimin nga klasa, sikur të kërkonte ndihmën tonë. Ne ishim të një mendje me të. Ai kishte shprehur qartë dhe thjesht atë që na shqetësonte të gjithë: a mund të shkruanim ashtu siç ndienim në ato çaste?

— Sigurisht që mund të shkruani ashtu siç doni, siç ndieni.

Mësuesi shëtiste vështrimin e tij të ëmbël nëpër fytyrat tona kureshtare. Me shikimin e tij ai na thoshte më tepër sesa fjalët, na nxiste të shkruanim për atdheun e pushtuar, për luftën që kishte filluar. Atëherë qenë ditë të vështira për Shqipërinë. Okupacioni fashist kishte shtrirë kthetrat e gjakosura anembanë

vendit. Bijtë e Shqipërisë kishin rrëmbyer armët dhe me yll në ballë po luftonin nëpër male.

Sapo kishim filluar të shkruanim për këto ngjarje, kur u hap dera e klasës sonë dhe brenda u fut si një hije mësuesi i gjuhës shqipe i paraleles tjetër, një njeri i zymtë, që s'i qeshte fytyra kurrë. Ai njihej në shkollë si profashist. Pasi mbylli derën, iu drejtua mësuesit tonë me një zë aq të ulët, sa që ne nuk dëgjuaam asnjë fjalë. Vura re se fytyra e mësuesit tonë ndryshoi por pastaj e mblodhi veten.

Tjetri, duke ngritur zërin, tha:

— Po bëni hartim?

Pyetja tingëlloi e thatë, djallëzore.

— Po!

— A shkruajnë këta politikë në hartime? E?

— Jo, — u përgjigj shkurt mësuesi ynë.

— Mua më shkruajnë, megjithëse i shaj. S'e marr vesh: hartim bëjnë apo politikë? Ë?

Kësaj radhe mësuesi ynë ngriti vetëm supet dhe nuk u përgjigj. Tjetri, duke buzëqeshur në mënyrë të shëmtuar, doli nga klasa ashtu si hyri, si një hije. Me të dalë jashtë ai, gjithë klasa u çlirua nga një ankth i keq. Atë dhe një mësues tjetër, me një kapele të madhe e të zezë në kokë, nxënësit e shkollës sonë nuk i donin. Jo vetëm ne, por as edhe mësuesit e tjerë që na nxisnin ndjenjat patriotike nuk shoqëroheshin me ta.

Në klasë pllakosi përsëri heshtja. Mësuesi iu afrua bankës sime, dhe me një zë që i dridhej më tha:

— Të kërkojnë në drejtori.

U ngrita. Duke ecur nëpër klasë, ndjeva se të gjithë më kishin ngulur sytë. Edhe mësuesi. Andej nga fundi i klasës se kush murmuriti: «E thërresin për punë të demonstratës».

Kalova nëpër korridor, ngjita shkallët dhe u gjenda në katin e dytë. Ja tek ishte dhe klasa e katërt, ku ndodhej Shpresa me ata sy të çelur që ia pëlqeja aq shumë. Ajo qëndronte në bankën e dytë, pranë dritares, gjithnjë e buzëqeshur. Shpresa skuqej si një shegë devedishe kur unë kaloja andej.

Trokita në zyrën e drejtorit.

— Hyr, — dëgjova zërin e tij që nga brenda.

Hapa derën dhe qëndrova në këmbë në mes të dhomës. Drejtori rrinte ulur përpara tavolinës, mbi të cilën qenë shpërndarë një tok letrash. Pranë tij qëndronte nëndrejtori, italiani Cassinelli, me atë mjekër të shkurtër e të ashpër, si të një cjapi. Ndërsa në të djathtë qe ulur një burrë që nuk e njihja dhe që më vështronte nga koka deri te këmbët.

— Afrohu, — më tha me një dashmirësi krejt fallco, si për të më dhënë zemër.

U afrova duke mos ditur ku t'i fusja duart; t'i mbaja prapa shpinës apo të lëshuara poshtë.

— Me këtë zotërinë, — tha përsëri ai me një tingull metalik të prerë, — do të shkosh deri në shtëpi. Ka ca punë me ty, me sa duket do të kontrollojë shtëpinë. Ti qëndro i qetë. Më kuptove?

Që të dy, Cassinelli dhe ai burri huaj, më vështronin në sy. «Ja se ç'na qenka! Ky burri që qëndron pranë drejtorit është agjent», — më vetëtiu në kokë. E pasi ai u përshëndet me drejtorin, dolëm jashtë. Në korridor dëgjoheshin vetëm hapat tanë: të mitë dhe të agjentit.

Që të gjithë nxënësit ishin nëpër klasa. Me sa duket agjenti e kishte menduar që largimi ynë nga shkollla të mos binte në sy. Te qoshja e rrugës, pikërisht sapo morëm kthesën, dy karabinierë të fshehur më

vunë në mes. Që të dy mbanin pushkë të shkurtra italiane.

Çdo gjë m'u bë e qartë. Duke ecur po vrisja mendjen: a kisha lënë në shtëpi ndonjë send që mund të më kompromentonte? M'u kujtuan traktet. M'i kishte dhënë Viktori në darkë për t'i shpërndarë, por më patën mbetur nja pesë copë. Në mëngjes, duke nxituar për në shkollë, i vura prapa pasqyrës. Po sikur t'i kishin gjetur?

Në shtëpi pashë mjaft karabinierë që kontrollonin dhomat. Banoja me nënën në një shtëpi të vogël dollmalie me gjashtë-shtatë shkallë, si shtëpitë e Elbasanit. Nëna, të cilën siç duket e kishin marrë nga fabrika e cigareve tek punonte, qe hutuar. Kur hyra në derë i shoqëruar nga karabinierët e armatosur, ajo më hodhi një vështrim sikur të më thoshte: «Bëju burrë!». Sytë më vajtën menjëherë te pasqyra, përpara së cilës qëndronte një karabinier. Ai shikonte mustaqet me vëmendje dhe, siç duket, ishte i kënaqur prej tyre. Në çast kapi pasqyrën me duar, ndërsa mua më ngriu gjaku. Ç'do të bënte me të? Do ta hiqte nga muri? «Tani mbaroi çdo gjë», — mendova. Për çudi, karabinieri u largua menjëherë nga pasqyra dhe hyri në kuzhinë.

— Kontrolloni mirë!

Oficeri italian, një njeri i vrenjtur e që nuk i qeshte fytyra, më hodhi një vështrim të rreptë. Edhe unë e pashë drejt e në sy për një kohë të gjatë. Italisht kuptoja diçka, aq sa mund të merresha vesh.

— A keni armë?

— Jo.

— Je i sigurtë?

— Po.

Karabinierët e bënë shtëpinë rrëmujë po nuk gje-

tën gjë. Kjo më qetësoi. Traktet nuk u zbuluan. Fashisti më tha se duhej të shkoja deri në komandë për të plotësuar disa formalitete e pastaj do të shihnin e do të bënin. Në fillim nëna e humbi pak, por menjëherë mblodhi veten, fshiu lotët dhe më përcolli me vështrimin plot dhembshuri:

— Burgu për burrat është, bir i nënës. . .

Karabinierët më vunë në mes dhe u nisën për në komandë.

Në komandën e karabinierisë hyra nëpërmjet një porte të madhe. Pas portës shtrihej një oborr i gjerë, i rrethuar, me ndërtesa. Lart shikohej një copë qiell. Pas pak më mori në pyetje një kapter fashist, një farë Mario, siç e quanin. Mbante flokë të gjatë që herë pas here i binin në sy. Ai i kapte me dorë dhe i flakte mbrapa.

— Të thuash të vërtetën, se ndryshe. . .

Ai më pyeste dhe unë i përgjigjesha me atë italishten e sakatosur të një liceisti.

Ke marrë pjesë në demonstratë?

— Po!

— Kush të shtyu?

— Asnjeri!

Mario më shponte tejprtej me vështrimin e tij të djallëzuar e të ftohtë. Më paralajmëroi që të mos mërzhitesha, se të gjitha ato që dija do të m'i nxirrte me marifete të tjera, po të mos i thosha vetë. Po të tregoja emrin e ndonjërit, çdo gjë do të lehtësohej. I thashë se nuk më kishte shtyrë asnjeri dhe se në demonstratë kisha marrë pjesë pa dashur, tek pashë gjithë atë turmë të madhe njerëzish. Mendova se me këtë mund ta gënjeja.

Papritur ndjeva një të goditur të fortë në faqen e djathtë që m'u ndez si prush. Fashisti më kishte që-

lluar; megjithatë zemra më gufonte nga një gëzim i madh. Nga pyetjet që më bënte fashisti kuptova se rreth grupit tonë nuk dyshohej asgjë. Kjo kishte rëndësi. Shokët, pas arrestimit, me siguri do të merrnin masat e duhura e do të tregoheshin më të vëmendshëm.

Dy karabinierë më shpunë në birucë. Ajo ishte një dhomë e ngushtë, fare e vogël. Në derën e saj të ftohtë ndodhej vetëm një dritare e vogël, ku s'mund të nxirrje dot as hundën. Që andej merrte dritë e gjithë biruca. Atje brenda kishte njerëz.

— Mirë se vjen!, — dëgjova disa zëra nëpër errësirë.

— Kush jeni ju?

— Shokë jemi.

— Përse ju kanë arrestuar?

— Për pjesëmarrje në demonstratë.

Biruca mbante erë lagështirë dhe amoniak. Po më merrej fryma. Duke u zhytur në errësirën e birucës, humba lidhjen me njerëzit e gjallë. Vendi ishte i ngushtë, ajri i prishur. Sa kohë do të qëndroja aty. Pak e nga pak fillova të shihja në errësirë, të dalloja njerëzit, shokët. Disa pinin cigare e disa dremisnin. Mbi kryet tanë varej tymi i duhanit që më detyronte të kollitesha herë pas here.

Aty në birucë njoha Petritin, një djalë të gjatë e të dobët që kishte punuar si mekanik në një oficinë. Kishte një zë të ëmbël që të bënte për vete. Ai fliste vazhdimisht për situatën politike, na thoshte se fashistët nuk do ta kishin të gjatë, se gjermanët në Frontin e Lindjes po thyenin kokën, se Partia Komuniste Shqiptare po i printe popullit në luftën heroike për çlirimin e atdheut. «Ata duan të nxjerrin nga ne të dhëna, emra shokësh, bazat e fshehta, teknikën. Be-

soj se asnjëri nga ne nuk do ta turpërojë veten e të bëhet tradhtar, qoftë edhe sikur ta varin. Tremben vetëm ata që nuk kanë asnjë qëllim në jetë, asnjë ideal».

Petriti, ky djalosh me shëndet të lig, dinte të fliste mirë dhe bukur. Unë e shikoja në gojë dhe mundohesha ta imitoja në çdo gjë. Shkollë kishte vetëm pesë klasë, por dinte sa një mësues. Gjatë qëndrimit në karabinieri, e kishin torturuar me spica nëpër thonj, i kishin vënë vezë të nxehta në të dyja sqetullat, por ai nuk e kishte hapur gojën. Sqetullat i kishte akoma plagë, por ai s'donte t'ia dinte. Atij i pëlqente të shtrihej në krevatin prej dërrase dhe t'ia thoshte ndonjë kënge partizane.

Dalngadalë po vjen behari...

Ne të tjerët i afroheshim pranë, e vinim në mes dhe këndonim bashkë me të, ngadalë e shtruar. Melodia e këngës na pushtonte që të gjithë.

Një natë, dy karabinierë erdhën dhe e morën përsëri Petritin. Pas dy orëve e sollën pa ndjenja, me fytyrë të gjakosur dhe syrin e djathtë të nxirë e të enjtur. Petriti mezi e mori veten pas katër a pesë ditësh. Ne i qëndruam mbi kokë.

Një ditë na kishin nxjerrë në oborr për nja dhjetë minuta, sa për të marrë pak ajër të pastër. Po rrinim të strukur në një qoshe të murit pranë derës së birucës, ku mezi arrinin disa tufa nga rrezet e diellit. Ishim që të gjithë të zbetë, me fytyra të hequra e të parruara. Petriti ishte më i dërrmuar. Qielli, ajo copë qielli që dukej, që mbuluar vende-vende me ca re të bardha, mu si arna të qepura pa kurrfarë bukurie.

Shikoja dritaret e asaj ndërtese të zyrtë dhe kujtoja shokët. Përditë sillnin njerëz, i pyesnin, i rrihnin për vdekje dhe pastaj i fushnin nëpër biruca. Një natë më parë dëgjuam të thirrurat e një njeriu që torturohej. Na doli gjumi që të gjithëve dhe mbanim vesh. Kush ishte ai? Çfarë po i bënin? Urrejtja na mbledhej si lëmsh mu në fund të gjoksit. «Një ditë do të hakmerremi për të gjitha këto», — foli Petriti, si për të na dhënë kurajë. Re të zeza po na vinin mbi kokë. As jeta e atyre që ishin jashtë nuk ishte e siguruar. Ç'bënin shokët? Ç'bënte Viktori? Ndoshta dhe ata një ditë do të kalonin nga kjo birucë, që kishte parë kaq vuajtje e tortura dhe do të dëgjonin hapat e rëndë të rojës së armatosur.

Në kohën që roja na bëri me shenjë të futeshim në birucë, një burrë i gjatë e kockëmadh, i veshur me kostum të zi, me kapele të zezë e me papijon, kapërceu pragun e portës së karabinierisë. Kur na pa deshi të fshihej, por ishte vonë. Ne e kishim njohur.

— Të pamë, «grerëz» e dreqit, — i bërtiti Petriti në çastin që po futeshim në birucë.

Mbeta me gojë hapur. «Grera» ishte një nga profesorët e shkollës, që na jepte mësim. Dhe ja tani këtë e shikoja përpara derës së karabinierisë. Ishte spiun. Më erdhi neveri dhe fillova të dridhesha i tëri nga zemërimi. Tani kuptova pse pedagogët e shkollës nuk rrinin me të në shëtitje apo në kafene.

— I poshtri!

— Shokët do t'ia gjejnë vendin, mos ki merak!

Ditën e njëzetë na lajmëruan të bënim gati plaçkat. Siç dukej do të na hiqnin që aty. Ku do të na dërgonin! Pasdite na nxorën e na lidhën dy e nga dy: dora e djathtë e njërit me dorën e majtë të tjetrit. Mua më lidhën bashkë me Petritin. Me dorën që na

kishte mbetur e lirë hodhëm plaçkat mbi kurriz dhe u nisëm në rresht dy e nga dy, të shoqëruar nga karabinierë të armatosur. Kapërcyem portën e madhe dhe dolëm përsëri në rrugë. Këmbë njeriu nuk të shihte syri. Ora mund të ishte diçka më tepër se gjashtë e mbrëmjes. Njerëzit qenë mbyllur nga «kopri-fuokoja» nëpër shtëpitë e tyre. Rrugët ishin të shkretëta. Aty-këtu takonim nëpër qoshka ndonjë patrullë. Rojet ndaleshin për një çast, na hidhnin vështrime të rrepta nga koka deri te këmbët dhe diç pëshpërisnin midis tyre. Ne ecnim të lidhur dy e nga dy, pa i parë fare. Vetëm Petriti çalonte nga pak dhe mundohej të mos rënkonte. E shikoja me bisht të syrit tek përpiqej të duronte dhembjen. Rrugës e kuptuam se do të na shpinin në burgun e madh të qytetit. M'u kujtua Shpresa, që e kishte shtëpinë aty pranë burgut. Ndoshta ajo atë çast mund të gjendej në dritaren që shikonte nga burgu. Sa do të desha ta shikoja, qoftë dhe për një çast. Në shkollë e kisha parasysh gati çdo ditë, kurse tani po bëja njëzet ditë pa e parë. Ç'do të mendonte vallë ajo, kur të më shihte të lidhur me Petritin, me plaçka të hedhura mbi sup? Kur kaluam përpara shtëpisë së saj, vura re se dritarja që mbyllur me grila. Asgjë nuk pipëtinte. Njerëzit qenë strukur nëpër dhoma, larg rrugëve dhe ndoshta dëgjonin vetëm hapat e rëndë të karabinierëve që na shoqëronin të heshtur e të vrenjtur.

Në burg dryni i madh i derës së hekurt kërciti. Kapërcyem pragun. Brenda na hoqën prangat. Për herë të parë në jetën time po hyja në një burg të zymtë. Ngjitëm shkallët prej guri. Të burgosurit e tjerë politikë na pritën ngrohtë. Na përqaftuan, biseduan me ne, na pyetën si kishim kaluar në birucë. Në emrin tonë fliste Petriti, të cilin e njihnin fare mirë.

Një mëngjes në ushqimet që më dërgonte nëna më zuri syri një libër të vogël. I lexova titullin. Ishte «Baba Tomorri» i Çajupit. Kjo më gëzoi sikur të kisha gjetur kushedi se çfarë. Ia tregova Petritit. Ai e mori në duar dhe tërë atë ditë u mor me vjershat e Çajupit.

Të dënuarit politikë e kishin organizuar jetën në burg si s'ka më mirë. Dukej aty dora e fortë e një organizatori të zot. Çdo gjë bëhej me rregull dhe kolektive: shpërndarja e ushqimit, leximi i librave, informacioni politik, lidhjet me lëvizjen jashtë burgut. Edhe të burgosurit për gjëra të zakonshme kishin respekt të madh për të gjithë shokët. Në fillim ata sillleshin vrazhdë, fyenin njëri-tjetrin, ziheshin, por pas ca kohësh shtroheshin e zbuteshin si për çudi. Nëna më sillte bukën përditë dhe më jepte të fala nga shokët, nga Viktori. Ajo lodhej dhe mua më vinte keq për të. Një herë në javë takoheshim në dhomën e veçantë. Nëna nuk qante më. Ajo ishte bërë trimëreshë e më jepte kurajë edhe mua. Sa herë që vinte çasti i largimit, më pushtonte në krahët e saj të dobët, më puthte në të dy faqet dhe pastaj zhdukej prapa derës. E mjera nënë! Me gjithë hallet e saj, duhej të duronte dhe dëshpërimin e burgosjes sime.

Kur dola nga burgu pas disa muajsh, isha bërë tjetër njeri. Më dukej vetja një revolucionar i vërtetë. Puna e parë që bëra qe takimi me Viktorin. U përqaftuam gjatë. E pyeta për shokët. Dy nga ata kishin dalë partizanë. I shpjegova se ç'kisha ndër mend të bëja.

— Po në qytet kush do të punojë?, — tha ai.

— Unë kam vendosur.

Viktori më përqafoi.

— Për disa ditë do të të jap përgjigje.

Vajta në shkollë sa për të mos rënë në sy. Disa nxënës të klasave të larta nuk i pashë më. I kishin përjashtuar. Shokët më shtrengonin dorën, më pyesnin si e kisha kaluar në bīrucë. Unë ua tregoja ngjarjet ashtu si i kisha jetuar. Ata më shikonin me habi, sikur të isha një hero. Më jepnin shënimet dhe tregoheshin të gatshëm të më ndihmonin në mësim. Drejtori dhe mësuesi i gjuhës shqipe, ai burri i shkurtër e simpatik, më përgëzuan. Vetëm Cassinelli, «grera e zezë» dhe mësuesi i gjuhës shqipe i paraleles tjetër, bënë sikur nuk më vinin re. Po atë ditë, përpara klasës IV, u ndesha ballë për ballë me Shpresën. Mua sikur m'u drodh diçka dhe s'gjeja dot fjalë për të folur. Shpresa u skuq dhe heshte. Kjo gjendje zgjati vetëm disa sekonda, se pastaj e mora veten.

— Mirëmëngjes, Shpresa!

— Mirëmëngjes. Dole?

— Dola.

— Të kemi mbajtur në gojë.

— Ashtu?

— Si e kalove në burg?

Heshta për një çast:

— Burgu për burrat është, moj Shpresa, — i fola unë duke kujtuar fjalët e nënës.

Kisha dëshirë t'i tregoja asaj se vendosa të dilja në mal, tek partizanët dhe se ndoshta ai ishte takimi i fundit. Por asgjë nga këto nuk i thashë. Jo se s'kisha besim tek ajo, por se atëherë për këto gjëra mbahej konspiracioni i madh.

Viktori më solli lajmin se do të dilja partizan, me grupin e parë. Nuk e përmbaja dot gëzimin. Bisedova me nënën. Ajo do të vazhdonte të punonte në fabrikën e cigareve. Për të do të interesoheshin edhe shokët që të mos e ndiente mungesën time. Ajo më

shikonte me gojën pak të hapur dhe me fytyrë të ndehur. E gjora nënë! M'u duk se ajo ishte plakur gjatë asaj kohe që kisha ndenjur në burg. Ma pushtoi kokën, më mbështeti pranë gjirit të saj të tharë dhe dëgjova që tha:

— Shko bir, shko...



Në darkë u takova me mësuesin e gjuhës shqipe. U shkëputa nga shokët dhe e përshëndeta.

— Desha t'ju takoj, pasi nesër s'do të vij, në shkollë... Ju falemnderit për gjithçka...

Unë s'i thashë asgjë më tepër se kaq. Nuk di nëse mësuesi e kuptoi se ç'desha t'i thosha. Por edhe sikur t'ia kisha thënë, kisha besim të madh tek ai. Ne e ndienim se ai ishte mësuesi ynë.

Në mëngjes herët u veshja mirë dhe dola jashtë qytetit, te vendi i caktuar. Viktori i pat marrë të gjitha masat. U bëmë disa vetë.

Para se të nisesha, hodha një vështrim në drejtim të burgut, atje ku ndodheshin shokët dhe Petriti, mësuesi im. Pastaj hodha sytë atje ku mezi shquhej çatia e kuqe e shkollës, ku mësova vite me radhë, ku kisha shokët e mi, ku kisha dhe mësuesit që më deshën. Atje, nën atë çati, ndodhej dhe klasa ku mëson-te Shpresa, ajo vajzë që skuqej si një shegë. Buzëqesha. Kur doli dielli në majë të malit, ne kishim bërë goxha rrugë dhe i qemë afruar çetës partizane.

DRITA MË E MADHE

Do të gënjeja po të thosha se largimi nga qyteti s'më kishte bërë përshtypje. Madje më kishte turbulluar ca. Por dalngadalë, duke jetuar në gjirin e fshatarëve kooperativistë, po më lindnin ndjenja të reja, të çuditshme, që i ngjanin ndjenjës së dashurisë për njeriun, për jetën. Këto ndjenja më ledhatonin shpirtin e më jepnin guxim, paçka se një pjesë të fshatarëve që njihja i brenin paragjykimet dhe ndonjëri hidhte romuze për ne të qytetit. Edhe ata e kishin vështirë. Ekonomitë e copëtuara në të kaluarën patën lënë në shpirtin e tyre ndjenjën e të kënaqurit me pak, dëshirën për t'u interesuar për kopshtin personal e bagëtitë personale.

Mëngjesi që pak i ftohtë. Këmbët po më shpinin për në qendër të fshatit, te zyrat e kooperativës. Sekretari që fshatar denbabaden. Ai ka lerë dhe është rritur në fshat. Hallet e njerëzve i di mirë, ua njeh të gjitha huqet, të mirat e të këqijat. Edhe ata e duan, se është njeri i drejtë, parimor dhe ua thotë gjërat në sy, hapur e pa dredhur. Fshatari ynë e do njeriun e drejtë dhe e respekton.

E gjeta në dhomën pa tavan. Një tavolinë e vjetër e me këmbë të shtrembra qëndronte në mes. Në

dritare një copë xham qe thyer dhe në vend të tij kishin ngjitur një copë gazetë që kishte filluar të zverdhjej nga rrezet e djellit.

— Mirëmëngjes, shoku zooteknik, — më përshëndeti i pari.

— Mirëmëngjes!

— Si duken punët andej nga stallat?

— Jo dhe aq mirë.

— Mos u mërzit, çdo gjë do të rregullohet. Afrohu këtu, eja të shikojmë se çfarë projektesh kanë ardhur nga komiteti për ndërtimin e stallave të reja. Na, pa shih. . . Kur të sjellim dritën elektrike, atëherë do të jetë ç' do të jetë. Lëre mos e pyet! Sekretari ishte bërë në qejf. Ai fliste pareshtur, mundahej të më tregonte ndërtesat, rrugën e fshatit, ujësjellësin e ri, vatrën e kulturës.

— Dëgjo, — tha duke më prekur në sup, — i thashë dajë Metit një ditë; «Shtëpinë e ke në majë të kodrës, më mirë zbrit poshtë në fushë se do ta kesh më kollaj edhe për dritën elektrike». — A e di si m'u përgjigj? «Unë nga shtëpia nuk luaj, se atje më ka ndernjur plaku dhe, përsa i përket dritës, atë do të ma bini atje ku jam, në majë të kodrës. Këtë e ka thënë Partia dhe s'e luan as topi».

Ai qeshi. Qesha dhe unë bashkë me të. Sekretari kishte një cilësi që të afronte menjëherë, të bënte të flisje me të sikur ta kishe njohur prej kohe. Ai më dëgjoji me vëmendje për vërejtjet dhe kërkesat e mia që i bëra dhe i shënoi në bllokun e tij të vogël.

— Do të dalim nga kjo gjendje, i dashur, ke për të parë. Në mbledhjen e organizatës ne kemi marrë një seri vendimesh. Komunistët do t'i zbatojnë të gjitha. Ata vetë do t'i futen prodhimit, — më jepte shpresa.

— Po njerëz për stallën?, — insistoja në timen.

— Do të vijnë, madje edhe vajza të reja. Për këto çështje kritikua Hasanin, se nuk do të japë shembull, nuk dëshiron ta dërgojë vajzën e tij, Lulen. E njeh?

— Po.

— Ajo duket si e fjetur. Por besomë mua, ajo fsheh në veten e saj energji të pashtershme, vetëm duhet t'ia gjejmë kyçin.

— Ashtu është.

— Domethënë kjo punë ka marrë fund. Do të vijnë njerëz për stallat.

— Akoma ti?

— Të falemnderit!

U ngrita. Duke dalë nga zyra, sekretari më thirri:

— A e di ç'të bësh? Shko edhe ti njëherë nga Hasani, se nuk ta kthen fjalën.

Shtëpia e Hasan Lames që në krye të fshatit. Ai sapo e kishte mbaruar shtëpinë e re, me oxhak, me dritare të gjera. Kasollja e vjetër, ku pat banuar më parë, qëndronte atje tutje, e vogël, e zyrtë e ca e anuar. «Si kanë banuar njerëzit në këto plevica?», — mendova duke trokitur në portë. «Ja dhe pusi me kovë të re!».

Qeni plak i shtëpisë, me një fytyrë torollake, me ca sy të sëmurë me sklepa m'u afrua, më mori erë nëpër këmbë dhe pastaj u largua.

Nga brenda u dëgjuan këmbë. Dera kërciti dhe Hasani bëri ballë me kokën e tij tullace.

— Oh, ti qënke!

— A pret miq, o i zoti i shtëpisë?

— Urdhëro!...

Në korridor qenë vendosur disa trarë që mbanin erë rrëshirë e dru të njomë.

Drodha një cigare nga kutia prej teneqeje e të

zotit të shtëpisë. Nuk e zgjata shumë, por hyra drejt e në temë; i fola mirë për Lulen, se e kishte vajzë punëtore, të urtë. Hasani nuk përgjigjej, me sa dukej nuk i pëlqente t'ia lëvdoja vajzën. I thashë se në stallë ajo do ta ndiente veten mirë dhe kisha besim se do të bëhej një mjelëse e dalluar.

— Besoj se nuk do të ma kthesh fjalën për vajzën.

— Jo, tani kooperativa i përziën djem e vajza bashkë, — foli sikur të ma kishte kuptuar mendimin. — Kohët ndryshuan, por ke parë ti, sikur të gjitha gjërat nuk kuptohen menjëherë. Ashtu ndodhi dhe me mua.

— Po ti je komunist, Hasan.

— Po!

— Duket sikur nuk ke besim tek vajza jote.

Hasani u zu ngushtë. Thithi cigaren, lëshoi tymin e përhimë përpara vetes dhe hodhi vështrimin nga dritarja. Në katrorin e saj dukej një copë re, e cila qëndronte në qiell pa lëvizur. Një heshtje e rëndë mbretëroi dhe, nëpërmjet xhamit vështroi shtëpitë e vogla të fshatit që strukeshin si të tulatura në mes të bregores.

— Mua më kritikuan në mbledhje. Ç'është e vërteta mezi shkëputem nga e vjetra, ajo ka lëshuar rrënjë të thella te ne..., — murmuriti Hasani, i cili e kishte humbur dhe rrinte si i ngrirë pranë dritares. Duart, ato duar të zeza, të rënda, me gishtërinj të trashë e thonj të fortë, i mbante mbi parvaz, sikur donte të mbahej nga frika se mos rrëzohej.

Vjeshta erdhi pa u ndier fare. Koha po mbante mirë, pa erë, si një behar i vogël. Në mëngjes bënte pak fresk. Plepave, që kishim pranë stallës, dita ditës e më shumë po u binin gjethet e zverdhura, ndërsa kopshtet po humbisnin dalngadalë jeshillëkun e tyre,

sikur t'i kishte spërkatur njeri me ngjyrë të verdhë. Më pëlqente të dëgjoja fëshfërimën e butë të fletëve që binin ngadalë mbi tokën e punuar e të njomur nga vesa. Pikat e vesës shkëlqenin nëpër fijet e barit, kurse në stallë Trëndafilja pëlliste. Mjelëset e reja hynin e dilnin të veshura me bluza të bardha. Ato u jepnin lopëve kashtë misri për të ngrënë e hidhnin bajgat në plehërishte. Vajzat punonin si bletët dhe po ia merrnin dorën punës në stallë. Që të marrësh sa më shumë qumësht nga lopa, duhet t'ua bësh të gjitha shërbimet: që nga kashaisja, masazhi i gjirit me ujë të ngrohtë para mjeljes e deri te krijimi i një ambienti të përshtatshëm. Trëndafilja që një lopë e mirë, qimekuqe. Atë ia kisha dhënë Lules që të kujdesej, pasi ajo po bëhej mjelësja më e mirë e stallës së lopëve. Kisha besim se do të bëhej me të vërtetë një mjelëse e dalluar; ndonëse dukej si e ngadalshme, kishte durar të shkathëta. Vajza kishte sy të bukur e përkëdheles. Në sytë e saj të përhimë e pak të trishtuar lexohej një buzëqeshje e hollë e lehtë.

— Lule!, — i thirra.

— Urdhëroni!

Ajo m'u afrua.

— Si i ka punët Trëndafilja?

— Sot dha 10 kilogramë qumësht.

— Është pak.

— Lopët tona s'japin më shumë.

— A e di përse? Sepse ato brez pas brezi i kemi ushqyer keq, nuk i kemi mbajtur pastër, prandaj dhe nuk japin qumësht.

— Unë dhe shoqet e mia ua kemi bërë të gjitha...

Lulja që dashuruar pas punës. Ajo tani i shihte me një sy tjetër stallat, rrugicat e vogla të fermës, lopët, stallën e re të viçave. Ajo dhe shoqet e saj më dë-

gjonin me vëmendje kur u flisja për blegtorinë, për të ardhmen e fermës së kooperativës, për rritjen e vëçave ose për përbërjen kimike të qumështit.

Një ditë te ne në stallë erdhi sekretari i organizatës bazë të partisë. Ai u ul mbi një trug të vjetër e të kalbur, nga dilnin pa pushim miza dheu. Vjeshta që bërë më e bukur, ndërsa pylli atje larg dukej sikur kishte zënë ndryshk. Ajri ishte mbuluar me aromë gjethesh dhe rrënjësh të thata. Mullarët me bar kishin filluar të nxiheshin. Ai nuk po fliste. Ndoshta bukuria e natyrës e pat mahnitur dhe donte ta sodiste për një kohë të gjatë, në heshtje. «Për se mendon, vallë?». Pasi e thithi për herë të fundit cigaren, e hodhi në tokë dhe tha:

— Atje në pyll kemi dërguar një skuadër me burra. Do të presin shtylla për elektrifikimin e fshatit.

Pasi biseduam gjerë e gjatë, shfaqta mendimin se duhej të dërgonim një mjelëse në fermën shtetërore të rrethit për të mësuar për blegtorinë dhe të merrej edhe ajo me eksperimente në kooperativë.

— Mendim i mirë është ky. Kë të dërgojmë?

— Lulen, vajzën e Hasanit.

— S'e ke keq, — rregulloi kasketën me dorë, pastaj shtoi:

— Kjo gjë duhet përgjithësuar edhe për sektorët e tjerë. S'është keq të dërgojmë në fermë brigadierët që të shohin se si punojnë atje.

U ngrit nga trugu, shkundi nga pantallonat nja dy miza dheu, pasi e pa mirë stallën, pasi më dha edhe ca udhëzime, më përshëndeti dhe iku. Ecte me hapa të matur, me një dorë në xhep, pak i kërrusur.

Kur u kthye Lulja, shoqet iu mblodhën rreth e qark dhe e pyesnin çfarë kishte parë në fermë. Vajza

u tregonte mjelëseve për kopetë e mëdha, për mënyrën e re të rritjes së viçave, për pastërtinë e stallave, për punën e mjelëseve.

— Radhën tjetër do t'ju shpjegoj për mëmëzimin artificial të viçave, — u tha në fund ajo.

— Hi! Hi! Ç'është ky mëmëzim?, — u tall dikush.
— Na paske mësuar fjalë të mëdha, moj Lule!...

Po Lulja s'e bënte qejfin qeder. Talljet as që i bënëin përshtypje. Tani ajo qe bërë më e guximshme dhe i qe përveshur punës me vrull, nga mëngjesi në darkë, sipas përvojës që kishte fituar në fermë. Lopët filluan të jepnin qumësht më shumë, sidomos Trëndafilja. Po Lulen e shqetësonte rritja e viçave të vegjël. Ajo u mbante shënim peshën, sasinë e qumështit që pinin, i lante, i pastronte, i përkëdhelte, u thërriste me emra të bukur.

Një ditë erdhi tek unë e shqetësuar. Nxori duart nga bluza e bardhë, shtrëngoi shaminë nën mjekër dhe pastaj foli:

— Shoku përgjegjës, këtu na duhen kova të reja. Stalla duhet ndarë në bokse, ndryshe mëmëzimi artificial i viçave s'do të ketë sukses.

Më shikonte në sy e vendosur. Edhe unë po e shikoja me një farë habie. «Kjo s'është Lulja që njoh unë; tek ajo po lind një tjetër njeri; fshatarja e re, punëtore, kërkuese», — thashë me vete.

— Kryetari i kooperativës më ka premtuar se do t'i blejë, — iu përgjigja.

— Ata të kryesisë i zvarisin shumë punët e stallës, nuk e vlerësojnë sa duhet blegtorinë.

— Ndoshta dhe i zvarisin ca...

— Do t'u bëj një fletërrufe! E përse të mos e bëj?...

Vajza liroi pak nyjen e shamisë nën mjekër dhe i hipi një të kuq.

— Kanë për të parë po s'u vura fletërrufe!, — tha e vendosur dhe u largua.

Të nesërmen i gjithë fshati e mori vesh se Lulja i kishte vënë kryetarit të kooperativës një fletërrufe. Njerëzit qëndronin përpara tabelës së fletërrufeve dhe lexonin ato që kishte shkruar vajza e Hasanit me shkronja të mëdha.

Pas fletërrufesë u blenë menjëherë kovat. Kryetari dërgoi skuadrën e ndërtimit për të bërë bokset në stallë dhe i dha përgjigje fletërrufesë së Lules me autokritikë. Pak e nga pak stallat tona po merrnin pamjen e një ferme të vogël, rrëzë kodrës. Mjelëset e reja, me Lulen në krye, punonin si jo më mirë. Viçat e vegjël po rriteshin shpejt e më shpejt, sidomos viçi i Trëndafilës sa vinte e zbukurohej. Metodrat e reja të punës po jepnin rezultate. Për këto gjëra u shkrua dhe në gazetën e rrethit. Në fermën tonë filluan të vinin blegtorë, mjelëse nga kooperativat fqinje, për të parë se si i rrisnim viçat e vegjël dhe si kishim arritur të shtonim prodhimin e qumështit. Ajo nuk e kishte më zor t'u fliste për kushtet që patëm krijuar në stallë, ndarjet në bokse. Mjelëset e ardhura dëgjonin me vëmendje Lulen, vajzën e Hasanit dhe mbanin shënime në fletore me kuti të vogla. Hasani përdridhte mustaqet. Në sytë e Lules shndriste një shkëndijë gëzimi, që ajo mendohej ta fshihte me kujdes, një gëzim që i shpërthente nga një dashuri e trubullt për një jetë më të mirë, më të bukur. Sekretari i organizatës bazë të partisë buzëqeshte i kënaqur. Përse buzëqeshte vallë? Ç'mund të mendonte ai njeri duke e dëgjuar Lulen?

Shirat e vjeshtës filluan të zbrazeshin mbi fshat.

Nga dritarja e dhomës ku banoja shihja litarët e gjatë të shiut që vareshin nga qielli deri poshtë në tokën e punuar, duke rënë në pellgjet e vogla. Sapo binin, pëlcisnin si flluska: plluq, plluq! Fshatarët bridhnin me çizme nëpër baltën e fushës. Përroi u trubullua, era shtynte retë që nga jugu, ca re të ngarkuara ngjyrë plumbi të errët. Nga çatitë e shtëpive të reja kullonin ujëra pa pushim. Shtyllat e elektrikut, që përshkonin fshatin tejpertej, qenë bërë qull. Kulla e transformatorit, e ndërtuar me tulla të kuqe, sapo qe përfunduar. Së shpejti në fshat do të vinte drita.

Mbrëmja qe e zymtë dhe e trishtuar. Çdo gjë qe e zhytur në errësi dhe në qetësi. Qetësia paralajmëronte afrimin e ndonjë tufani. Më vajti mendja në stallë: te lopët, te viçat që Lulja i ushqente me qumësht në kovë e që po rriteshin për bukuri. «Po sikur?...», — thashë me vete i trembur. Më dukej sikur në dhomë bënte zagushi e s'ngopesha me ajër.

Filloi era. U dëgjuan bubullima të largëta, ndërsa shkrepëtimat çanin qiellin e nxirë me zigzage. Në atë çast pashë pemët që përkuleshin nën peshën e erës, me degët e hallakatura e të zhveshura. Rreth e përçark gjithçka dridhej, dridheshin pemët, shtëpitë, drizat nëpër rrugët e ngushta e tërë baltë të fshatit. Shkrepëtimat u dendësuan. Pas tyre shpërthenin bubullima të forta, të afërta, sikur pëlcisnin në oborrin e shtëpisë. Filloi shiu kokërrmadh; mbi çatitë, në rrugë, në ara.

Trokiti dera. Dajë Meti u duk në prag i mbuluar me një thes në kokë e me një fener kundër erës në dorë.

— Jashtë është kiamet, — tha ai e u drodh nga të ftohtët. Pikonte i tëri dhe ashtu i lagur siç ishte i

ngjante një dordoleci si ata që trembin zogjtë në mes të arave.

— Do të vemi në stallë!, — i thashë.

— Ku dilet në këtë rrebesh! Të presim të pushojë pakëz.

— Ndoshta kanë nevojë për ne. Vajzat me Lulen do të kenë dalë me siguri.

— Që kur filluan ato të komandojnë, po na venë punët së prapthi.

— E ke gabim, dajë Meti, — e shpova, — Lulja është punëtore e mirë. As shoqet e saj s'bien më poshtë.

Feneri ndriçonte zbetë dhomën e ftohtë. Hijet tona herë zgjateshin e herë strukeshin në faqet e murit të pasuvatuar. Poçi elektrikut qëndronte varur mbi kokën tonë, i shuajtur. Drita e dobët e fenerit mezi arrinte deri tek ai. Veshë çizmet, hodha mbi kokë një mushama të vjetër dhe dolëm jashtë. Atë çast qiellin e përshkoi një shkrepëtimë e fortë që u zgjat deri te stallat e viçave. Një bubullimë e tmerrshme, si plasja e një predhe artilerie, na shurdhoi veshët.

— O dajë Meti, më duket se ra rrufeja në stallë.

— Ashtu më ngjau.

U dhamë këmbëve më shpejt. Nëpër shtëpitë e fshatarëve po ndizeshin llambat me vajguri dhe bish-tukët. Njerëzit përplasnin dyert, dilnin në rrugë dhe thërrisnin fqinjët.

— O Halil, dil shpejt!...

— Na i mori shiu misrat nga ara.

— Vraponi!

— Në stallë ka rënë rrufeja.

— Oh! U rrëzova.

— Ma jep dorën.

Njerëzit vraponin në errësirë, binin nëpër kana-

le, çoheshin dhe vraponin përsëri. Shiu binte si me shtamba dhe lagte çdo gjë që gjente përpara. Mushamaja u bë qull. Çizmet më ngjiteshin në baltë. Pas meje vinte dajë Meti duke dihatur me vështirësi e duke mallëkuar kohën e keqe.

Në stallë vajzat kishin mbërritur përpara nesh. Ato i ishin përveshur punës: bënë kanale rreth ndërtesës, nxorën ujin nga brenda, qetësuan lopët që qenë çakëritur nga frika. Vetëm viçi i Trëndafiles nuk shpëtoi dot. Atë e kishte kapur rrufeja dhe e kishte rrëzuar mbi kashtën e lagur. Kafsha e vogël që shtrirë mbi ijën e djathtë, me kokën anuar pak nga pas, ashtu siç bënte kur përkëdhelej. Kur arrita unë, që ende i ngrohtë. Me gjithë ndihmën e shpejtë që i dhashë, viçi nuk shpëtoi dot. Lulja qëndronte pranë tij dhe dëneste. Me cepin e shamisë së bardhë ajo fshinte lotët dhe përkëdhelte kufomën e kafshës së gjorë që, nën dritën e fenerit, dukej sikur flinte, sikur dremiste...

Ditën që erdhi drita e elektrikut në kooperativë, u bë festë e madhe. Festë si ajo nuk më kishin zënë sytë: i madh e i vogël pritën me padurim mbrëmjen, çastin kur dritat do të ndizeshin.

Dajë Meti kishte blerë një radio vendi të markës «Durrësi» dhe mezi priste që ta ndizte. «Mos vdeksha pa parë dritat në shtëpi», — më thoshte hera-herës.

— Po bishtukun ç'do ta bësh, o dajë Meti?, — e ngacmoja.

— Do ta çoj atje ku ruhen..., — plaku mendohej. të gjente emrin por s'i kujtohej.

— Në muzeum, — e ndihmova unë duke qeshur.

— Ashtu de, në muzeum...

Në mbrëmje dritat u ndezën në të gjitha shtë-

pitë. Edhe radioja e dajë Metit buçiti nga këngët. Edhe stalla jonë llamburiti nga llampat elektrike. Sa bukur! Dajë Meti qe bërë si një çilimi dhe herë pas here fshinte sytë me cepin e peshqirit. Edhe kafshët sikur qenë gjallëruar atë mbrëmje. Lulja me shoqet e saj s'gjenin mënyrë si ta shprehnin gëzimin e tyre. Ato ishin veshur si për festë, u jepnin ushqim dhe i përkëdhelnin viçat; aty bisedonin e aty kërcenin nga gëzimi.

Vonë, pasi ikën të gjithë, zbrita në qendër të fshatit, atje ku ndodheshin zyrat e kooperativës. Duke zbritur poshtë, ktheja kokën pas nga stallat dhe shikoja se sa bukur vezullonin llampat elektrike.

Sekretarin e organizatës bazë të partisë e gjeta në zyrë. Ishte shend e verë.

— Erdhe?, — më pyeti.

— Erdha, shoku sekretar.

— Ç'kemi andej nga stallat?

— Dritë elektrike nga të katër anët, dritë elektrike edhe në stallat tona.

— Mirë e the! Dritë në të katër anët, dritë në stallat, dritë në shtëpitë dhe në mendjet tona. Po drita më e madhe janë mësimet e Partisë. — Kështu tha sekretari, dhe këto fjalë të tij ende sot e kësaj dite më kanë mbetur në mendje.

ÇANTA SANITARE

Një ditë na erdhi në kompani Ilia, një djalë i gjatë e qimekuq, që punonte si infermier në spitalin e qytetit. Unë e njihja se më kishte mjekuar disa herë plagët e duarve me ato melheme bojra-bojra, kur punoja si çirak te një hekurpunues. Në shpinë mbante një çantë plot me shishka të mbushura me lloj-lloj hapkash të bardha e të zeza, lëngje e pluhura të ndryshme, përdorimin e të cilave vetëm ai e dinte. Kur erdhi te ne solli me vete shumë barna për nevojat e partizanëve barna që ia patën dhënë shokët e spitalit të qytetit për ne që luftonim në mal.

Më të shumtën e herës në kompani ai rrinte me mua dhe bisedonim për shumë gjëra: për politikë, për luftën e ashpër që bënim për çlirimin e afërt të Shqipërisë. Dendur ai fliste dhe për punën e tij si infermier. Fliste me dashuri dhe mudohej të mësonte edhe shokë të tjerë.

Në çantë mbante dhe një pagure italiane me ujë dhe së cilës shuante etjen e të plagosurve. Me sa kujdes Iloja vrojtonte fushën e luftimit, shokët nëpër pozicione, ndiqte plasjen e predhave dhe me zemër të ngrirë priste se mos i bënin shenjë që të shkonte në vendin e të plagosurit. Njëherë në një luftim që patëm

me fashistët u ndodha në një llogore me të. Ai luf-
tonte dhe vrojtonte fushën e betejës.

Artileria e armiqve filloi të qiste në drejtim të
forcave tona. Predhat binin herë përpara herë prapa
pozicioneve, duke ngritur përtpjetë dhë e gurë. Iloja
u shqetësua për shokët e krahut të djathtë, ku binin
më tepër predha.

— Ti qëndro këtu, — më tha mua, — unë do të
vete të shoh se mos është plagosur ndonjë shok.

— More do të vritesh.

— Ika...

E vura re tek doli nga pozicioni dhe ia mori me
vrap.

— Ilo, o Ilo...

Veç kur e pashë më vonë me çantën sanitare në
krahë, duke mjekuar shokët e plagosur nga plumbat
dhe nga ciflat e shkëmbinjve. Këtë punë e bënte me
aq dashuri dhe pasion, sa unë mbetesha gojëhapur,
duke e vështruar, ashtu trupmadh siç qe.

Ndonjëherë e ndihmoja dhe unë, megjithëse nuk
shikoja dot gjak me sy.

— Do të mësohesh, — më thoshte ai duke më rënë
supeve.

— Pse, o? Ç'ke ndër mend ti, të më bësh infer-
mier?

Duart e tij qenë të stërvitura. Ai kontrollonte më
parë se mos qe thyer ndonjë koskë dhe, pasi sigu-
rohej se këmba apo dora e partizanit të plagosur s'qe
në gjendje të rëndë, merrte garzë, jod dhe fillonte
mjekimin.

— Durim të madh ke, o Ilo!, — i thosha duke i
mbajtur çantën.

— Kujdesi duhet gjithnjë, që të mos infektohen
plagët, se pastaj shokët mezi shërohen.

— Ku e di ti?, — e pyesja.

— Si ku e di? Me këtë zanat merrem.

Dhe unë habitesha me tërë ato gjëra që dinte Iloja nga mjekësia.

«Helbete, ka punuar me doktorë» — thosha me vete.

E vërteta është se Iloja s'kishte shkollë. I ati që lopçar në fshat dhe punonte nëpër dyert e të pasurve për të mbajtur fëmijët me bukë.

Ai ishte fukara dhe nuk kishte si mësonte. Por në mal, me partizanët po bëhej tjetër njeri. Në radhë të parë filloi të mësonte pushkën, e zbërthente dhe e mbërthente gati me sy mbyllur. Edhe granatën e mësoi mirë. Fjalët e komisarit i linin mbresa të thella. Që të dy me Ilon, ulur pranë njëri-tjetrit, e dëgjonim atë me vëmendje tek fliste për padrejtësitë e mëdha që u bëheshin të varfërve. Duke dëgjuar komisarin, neve na grumbullohej në shpirt një urrejtje e madhe për të gjitha padrejtësitë.

— Mirë e ka komisarit, — më thoshte Iloja, — vetëm lufta i lan këto hesape.

Një ditë, papritur ai më pyeti:

— A e di ti ç'është ndihma e shpejtë?

Ngrita supet.

Iloja e kuptoi se u nxitua dhe se nuk duhej të ma bënte pyetjen në atë mënyrë. Qeshi dhe më ra singërisht mbi sup.

— Dëgjo, Maqo. Ta zëmë se jemi duke marshuar për në aksion kundër armikut dhe në befasi ndeshemi me të. Një shok yni plagoset. Ti e di ç'do të thotë të të plagoset një shok. Me të pesë minuta më parë flisje, qeshje, bisedoje për gjithçka, luftoje, kurse tani e sheh shtrirë mbi tokë, me një njollë gjaku në xhaketë. Fy-tyrën e ka të zbetë, rënkton, djersë të ftohta i kanë

mbuluar ballin. Ka etje dhe herë pas here kërkon ujë. Kjo është një gjendje e rëndë. Mua më kanë ngjarë disa herë skena të këtilla dhe them se nuk ka çaste më të vështira se ato në jetë. Ç'do të bësh pra në një situatë si kjo? Ë?

— Duhet menjëherë ta mjekosh, — fola unë.

— Ja, bre, kjo është ndihma e shpejtë: fillon ta mjekosh shokun tënd. Hap çantën sanitare, merr gërshtëren dhe i gris xhaketën deri sa arrin te plaga, pastaj ia lidh. Ndërkohë shokët kanë bërë një vig dhe e shpien në spitalin partizan. Por ndodh që spitali është larg dhe duhet të kalosh nëpër zona të vështira e ndonjëherë fare pranë armikut, me kokën në torbë.

Njëherë Iloja u largua nga kompania jonë për në shtabin e brigadës për disa ditë. Para se të ikte erdhi tek unë.

— Maqo, — më tha me zërin e tij të trashë, — do të vete në shtab për ca ditë, por çantën sanitare do të ta lë ty se mund të të duhet.

— Ik ore, ku di unë të mjekoj.

— Ti më ke parë, bre.

— Ndryshe është të shohësh dhe ndryshe të bësh.

— Hajde të të them ca gjëra...

— S'e bëj dot.

— Po si thua ti, të mos ia lë njeriu? Po sikur të ndodhë gjë dhe të keni nevojë për çantën? Ku do ta gjeni?

— Jepja ndonjë tjetri, — i thashë.

Por bëri si bëri dhe çantën sanitare ma la që ma la.

Me gjithë mend e ndjeva veten në një telash të madh. Para se të ikte më dha ca udhëzime mbi mënyrën e mjekimit të plagëve, po të nesërmen i ngatë-

rrova që të gjitha në mendjen time. Harrova kur duhej përdorur melhemi i zi, kur i bardhi dhe kur ai tjetri me ngjyrë të verdhë.

Po atë darkë erdhi tek unë Kiçoja, një partizan i imtë në fytyrë, për të mjekuar një plagë në këmbë. Hapa çantën dhe po vrisja mendjen se me çfarë ta mjekojta po s'më binte që s'më binte ndër mend ndonjë gjë nga ato që më kishte thënë Iloja.

— Hë, o derëzi, mjaft u mendove, vëri një ilaç aty, — më tha me zërin e tij të pakët.

I vura mbi plagë melhem të verdhë dhe ia lidha sipas mënyrës sime. Të nesërmen Kiçoja m'u ankua se gjithë natën këmba i kishte dhembur shumë. Ia hapa plagën. Kur ç'të shoh! E gjithë lëkura që skuqur, që mbushur me flluska dhe kullonte një si lëng i trubullt. E kuptova menjëherë se nuk e kisha mjekuar mirë.

— Ky ilaçi i verdhë ma bëri këmbën më keq, — më tha Kiçoja pak i zemëruar.

— Ndoshta të është infektuar, — murmurita nëpër dhëmbë.

— Ç'ne, o.

E ndjeva veten keq. «Ç'm'u desh që ia mora Ilos çantën sanitare? Ku marr vesh unë nga doktorllëku».

Ditën që Iloja u kthye nga shtabi i brigadës i tregova për çka më ngjau. I dorëzova çantën dhe e ndjeva veten të lehtësuar. Por ai nuk m'u nda.

— Kam urdhër nga komisar i brigadës që t'i mësoj edhe të tjerët që ta përdorin çantën, — më tha me një ton serioz. — Së shpejti spitali partizan do të hapë një kurs për infermierë, të cilët do të shpërndahen në repartet partizane.

E filloi të më tregonte se ku kisha bërë gabim në mjekimin e plagës së Kiços.

Fashistët po tërhiqeshin gjithnjë e më tepër nën presionin e sulmeve të partizanëve. Armiqtë s'kishin nga t'ia mbanin, veçse mbylleshin nëpër qytete të rrethuar nga djemtë e popullit.

Në një nga sulmet që bëri kompania, Iloja u plagos rëndë. Plumbi e kishte marrë në gjoks. Gjendja ishte e rëndë. Iloja duhej dërguar medoemos në spitalin partizan, përndryshe... Duhej patjetër ndërhyrja e mjekut.

Me urdhër të komandantit, e vendosëm mbi një vig dhe u nisëm. Vigun e mbaja unë dhe një partizan nga devolli. Një i tretë vinte pas nesh. Gjatë rrugës fashat u skuqën dhe iu bënë qull, ndërsa më vonë gjaku filloi të pikonte mbi tokë. Fytyra iu bë e zbetë, gati e bardhë.

— Ujë... ujë...

I dhamë pak sa për të shuar etjen, por ai nuk ngopej. Çfarë etje që kishte!

— Ilo, o Ilo...

Infermieri rënkoi.

— Ilo!

— Hë?

— Si je?

I plagosuri më mbërtheu sytë.

— Keq... më lini këtu... Maqo, çantën sanitare...

— Këtu e kam, ja..., — i thashë.

Iloja e vështroi dhe buzëqeshi.

— Mirë..., — mori frymë thellë, — mbaje ti, Maqo!

Deshi të thoshte prapë diçka, po nuk mundi. Një fjollë gjaku i plasi nga goja dhe ia mbyti zërin.

Pak më vonë ai vdiq. Me zemër të copëtuar e varrosëm nën një bredh. Unë s'i mbaja dot lotët. Më vinte zor nga shokët, por s'kisha ç'bëja. Qaja dhe sikur lehtësohesha nga dhembja që më shkakttoi vdekja e

shokut të dashur. Ato nuk qenë shenja dobësie. Përkundrazi.

Para varrit të Ilos ne u betuam se do t'ia merrnim hakun.

Të nesërmen që në mëngjes herët kompania që rreshtuar dhe po bëhej gati për marshim. Komandanti po na jepte udhëzimet e rastit. Në dorë ai mbante çantën sanitare.

— Po këtë kush do ta marrë?, — tha më në fund.

Asnjë nuk foli. Të gjithë sillnin ndër mend Ilon me çantën sanitare në krahë...

— Kush do ta marrë, pra?, — pyeti sërish komandanti duke më hedhur një vështrim të shpejtë.

Përsëri nuk foli njeri.

— Merre ti, Shpresa, — iu drejtua ai një shoqeje që qëndronte në rreshtin e parë të kompanisë.

Partizania u zu ngushtë.

— Unë jo se nuk e marr, por nuk di t'i përdor, shoku komandant.

— Po atëherë kush do të na mjekojë? Ne vemi në luftë, ku ndonjëri edhe mund të plagoset. Ne nuk mund t'i lëmë shokët pa mjekuar e të na vdesin nga plagë të parëndësishme. Dikush nga ne duhet ta japë ndihmën e parë.

Heshtja pllakosi të gjithë kompaninë. Fytyrat e partizanëve dukeshin të menduara. Fjalët e komandantit ishin të drejta dhe të gjithë e pranonin se dikush duhej të merrej me këtë punë. Por cili? Ne mjek nuk kishim. Iloja, që ishte njeri i zanatit, kishte rënë në fushën e luftës si trimat. Kush do ta merrte pra çantën sanitare?

— Le ta marrë Maqoja, — thirri dikush nga fundi i kompanisë.

— Ai ka ndenjtur mjaft kohë me Ilon dhe diçka do të ketë mësuar, — shtoi një tjetër.

«Pse, kaq kollaj u bëka njeriu infermier?», — mendova duke kujtuar rastin e Kìços. Aty për aty m'u kujtuan dhe fjalët e fundit të Ilos. «Mbaje ti, Maqo!».

— Më mirë se Maqoja asnjëri s'ia del mbanë kësaj pune, — tha një partizan.

— Merre, o Maqo!

— Maqos i vjen ndoresh!

Kiçoja nuk fliste. Ai qëndronte në rresht me pushkën në krah dhe më vështronte duke buzëqeshur. Po sikur t'ua tregojta shokëve se ç'më kishte ndodhur me Kìçon? Më mirë t'ua thosha hapur, ta dinin dhe ata se nuk i meritoja ato fjalë që thoshin për mua.

Komandanti i kompanisë më qe afruar. Në dorë kishte çantën sanitare.

— Si thua, o Maqo?

— Unë... njëherë...

Komandanti nuk më la të mendoja gjatë. Më zgjati çantën dhe ma vuri mbi sup.

— Shokët ty të duan!

— Po unë...

— Së shpejti do të të shpiem në një kurs për infermier që ka hapur spitali partizan i qarkut tonë. Atëherë do të quhesh tamam doktor.

Partizanët qeshën. Qesha dhe unë.

Kompania u nis për në luftë. Bashkë me shokët ecja dhe unë, me çantën sanitare mbi sup. Gjatë marshimit ajo tundej andej-kënde, ndërsa unë dëgjoja zhurmën që bënin shishet me ilaçe tek fërkoheshin njëra me tjetrën. Tani, veç detyrës që kisha për të luftuar armikun, shokët më ngarkuan dhe një tjetër: atë të dhënies së ndihmës së parë në fushën e luftës. Duke ecur më kujtoheshin mësimet e Ilos për detyrat

e infermierit në kohën e marshimit të kompanisë. Ai më thoshte: «partizanëve gjatë ecjes u vriten këmbët, prandaj gjatë pushimeve t'u bëhen mjekime, të këshillohen të mos pinë ujë menjëherë, se u ftohen zorrët dhe sëmuren. Është mirë që në fillim të shpëlahen gojën me ujë për të shuar etjen. Para se të nisen, pas pushimit të pijnë ujë sa ta ndiejnë veten të ngopur...»

Pushimin e parë kompania e bëri rrëzë një pylli me pisha. Tek çlodhesha, vura re se Kiçoja po vinte tek unë. U ul pranë meje dhe drodhëm nga një cigare në heshtje. Prisja që Kiçoja të më fliste për këmbën e tij, po ai nuk foli dhe kjo gjë më rëndoi në zemër, pse e ndieja veten fajtor përpara tij.

Kompania u bë gati për të marshuar. Shuam cigaret dhe u përgatitëm të hynim në rresht.

Para se të largohesh, Kiçoja më tha:

— Maqo, bëre mirë që e more çantën, të paktën më mirë se ti askush tjetër nga ne nuk di t'i përdorë ilaçet.

Unë heshta.

Ai më dha zemër.

U R A

Shefi u ngrit në këmbë, u largua pak nga tavolina e punës, hodhi një vështrim nga dritarja e gjerë e zyrës dhe pastaj foli me zërin e tij pak të lodhur.

— Shoku Pali, besoj se u kuptuam. Tani ka ardhur koha të vëmë në jetë zbatimin e projektit, të cilin e mbrojte me kaq këmbëngulje.

Oficer Pali nuk u përgjigj, por tundi kokën në shenjë pohimi. Ai e kishte të qartë se tani, pas kaq diskutimesh rreth projektit, s'mbetej tjetër veç të fillonte nga puna. Shefi kishte të drejtë kur thoshte se atë projekt Pali e pati mbrojtur me gjithë shpirt. Rreth projektit të urës qenë bërë diskutime shumë interesante. Inxhinierët kishin shprehur mjaft mendime e argumentonin në mënyrën e tyre, por, kur vinte puna tek afati i përfundimit të objektit, ata nuk binin dakord. Shumica qenë të mendimit se për ta mbaruar urën së ndërtuari duheshin disa muaj, ndoshta edhe gjashtë, për të mos thënë më tepër. Kurse Pali dhe shefi mbronin tezën se objekti mund të përfundohej për një muaj e gjysmë. Njerëzit ngritën supet duke shfaqur në këtë mënyrë një farë habie.

— Mund të largohem, shoku shef?, — kërkoi lejë inxhinier Pali.

— Ju uroj sukses!

Pali nderoi dhe u drejtua nga dera.

— Shoku Pali, — e ndali përsëri shefi kur ai qe duke dalë, — në fund të javës do të më raportoni për ngritjen e kantierit në afërsi të urës.

— Si urdhëroni!

Shefi u përkul mbi tavolinë dhe diçka shënoi në bllokun e tij të vogël, me kopertinë të kuqe.

«Mban shënim datën në të cilën duhet të raportoj», — mendoi Pali me vete.

Atë bllok të vogël xhepi Pali e njihte mirë. Aty shefi shënonte çdo gjë të nevojshme: normat e punimeve të ndryshme xheniere, tonazhin e makinave, formulat e ngatërruara dhe datat e raportimit. Kjo korrektësi ushtarake e shefit, Palit i pat pëlqyer gjithnjë.

Duke dalë nga ndërtesa e komandës së njësisë, Pali u drejtua për nga objekti. Ai qe mjaft larg, por megjithatë një pjesë të rrugës e bëri në këmbë.

Flladī i freskët i asaj dite ia kthjelloi mendimet. Pali nisi të mendonte më me gjakftohtësi rreth objektit. Sidomos rreth kohës në të cilën duhej përfunduar. Ai e dinte se ndërtimi i urës qe një punë mjaft e vështirë. Dhe më parë ai kishte ndërtuar objekte të ndryshme ushtarake, por ato qenë më të vogla në krahasim me këtë të fundit. Këtë radhë ai po ndërmerre një objekt të madh për ta ndërtuar në një kohë rekord. A do t'ia dilte në krye kësaj pune? Mos qe nxituar në llogaritë e bëra? Mos ndoshta qe nisur vetëm nga dëshira e mirë që objekti të mbaronte sa më shpejt?


Ai qe i bindur se në ndërtimin e objektit do ta ndihmonin të gjithë; komanda dhe, ushtarët që kishte në vartësi. Midis këtyre të fundit ai kujtoi ushtar

Shpëtim Gjergjin, një djalosh të shkurtër, me ca sy të kaltër e duar të arta. Atë do ta linte të punonte poshtë në lumë me motopompën. Pali u kujtua se Shpëtimi i kishte kërkuar një ditë lejë për të vajtur tek e fejuara. Në rastin më të parë do ta lejonte. Ai meritonte dhe më tepër, por, tani për tani, Pali s'e kishte atë mundësi. Me të vënë punët në vijë, Shpëtimi do të shkonte në qytet të takohej me të fejuarën. Për një çast ai e pati zili ushtarin me duar të arta. Vetë ishte beqar, dhe herë pas here ndiente nevojën të dëgjonte fjalë të ëmbla dashurie. Para syve i doli fytyra e lezetshme e mësueses flokëverdhe që jepte mësim në shkollën aty pranë. Por ai ende nuk e njih-te mirë. Ata që të dy shkëmbenin disa vështrime, por edhe ato që nga larg. Kjo, sipas Palit, s'mund të quhej akoma dashuri.

... Kantieri i ndërtimit po merrte formë pak e nga pak. Çdo ditë grumbulloheshin makineri të ndryshme: betoniera, vinça, transportierë, automjete transporti me targat e gjata U.P. Tek shikonte ushtarët e repartit me gjithë atë teknikë nëpër duar, Palit sikur i largohej ajo pasiguri që kishte ndonjëherë. Me ata njerëz dhe me ato makineri, inxhinieri do ta krynte në afatin e caktuar objektin. Kur diskutonte në grupin e inxhinierëve për çështjen e afatit, një specialist me syze të erëta e kishte pyetur:

- Ju, shoku inxhinier, ku bazoheni kur thoni se mund ta përfundoni objektin për një muaj e gjysmë? Pali ishte ngritur në këmbë dhe kishte thënë:
- Në hovin revolucionar të ushtarëve!

Tani, përpara syve të tij kantieri rritej e zmadhohej çdo ditë. Makinat sillnin pa pushim zhavorr nga lumi dhe e grumbullonin në të dy anët e urës, ndërsa ushtarët, veshur me rrobat e punës, përzienin



betonin me ujin që dërgonte Shpëtim Gjergji me anë të motopompës dhe e hidhnin në objekt. Kjo punë bëhej edhe ditën, edhe natën. Betoni qe gjithçka. Ai kërkonte kujdes të madh në zbatimin e normave teknike, përndryshe...

Zhurma e punimeve të kantierit përhapej rreth e qark, në kooperativën bujqësore, në xhade e deri te shkolla tetëvjeçare ku mësueset e reja mësonin me durim nxënësit e vegjël. Atje, midis atyre mësuesve, një bjondinë e brishtë i pati tërhequr vëmendjen inxhinier Palit. Ajo vinte përditë nga qyte-

ti me makina të rastit, zbriste në xhade dhe pasi hidhte një vështrim nga objekti, merrte në të majtë, nëpër një rrugicë që e çonte drejt e në shkollë. Pali e kishte takuar disa herë në xhade. . . Duke bërë kontroll nëpër kantier në orët e vona të natës, ai mendonte edhe për atë bjondinë që mbante në dorë një çantë të mbushur me fletore bukurshkrimi.

Pali bëri disa hapa nëpër zhavorr. Ktheu kokën pas dhe dalloi në errësirën e natës siluetën e një njeriu pak të kërrusur, me një pushkë të gjatë mbi sup. Një qen i madh e ndiqte pas.

— Mirëmbërëma e punë të mbarë, shoku inxhinier!

— Mirë se erdhe, xha Rremë!

— Sonte s'paske fjetur fare.

— As ju s'po flini.

Xha Rrema, me ca dhëmbë të rënë, iu afrua Palit edhe më tepër.

— Unë jam plak. Tri-katër orë gjumë boll i kam. Pastaj roja e kooperativës nuk duhet të flejë.

— Ashtu është, vërtet, — pranoi Pali, më tepër për t'i bërë qejfin.

— Fshatarët e kooperativës nuk ju heqin nga goja. «Rroftë ushtria, — thonë, — pa ndihmën e tyre ne nuk e bënim dot një gjë të tillë.».

Pali qeshi. Për të që një kënaqësi e madhe të dëgjonte nga goja e një kooperativisti të thjeshtë se ura që po ndërtonte reparti, veç rëndësisë taktike, u shërbente dhe kooperativistëve.

— Po lodheni boll, — shtoi roja.

Betonierat bënin zhurmë të madhe.

— Si?, — pyeti Pali, duke vënë njërin dorë te veshi i djathtë.

— Po lodheni. . .

— Në jemi të rinj, xha Rremë, dhe nuk dimë se ç'është lodhja. Pastaj ne vendin e punës e quajmë si fushën e stërvitjes.

Plaku tundi kokën.

— Në këtë vend këtu unë kam punuar sot e njëzet e pesë vjet më parë, si argat, tek italianët. Inxhinieri që një italian me mjekër, që jepte e merrte në gjuhën e tij, por që ne nuk e kuptonim fare. Punonim me kazma e lopata tërë ditën e ditës. Lekët nuk na i jepte në rregull.

Atëherë ca punëtorë që vinin nga qyteti na thanë të bënim grevë së bashku mu aty përpara barra-kës së inxhinierit. Në fillim pata ca frikë. Thosha me vete: Ç'më duhet mua të ngatërrohem me qeverinë e huaj». — Por ata, punëtorët, sidomos njëri me ca flokë të dredhur ma mbushi mendjen. Lamë punën dhe i vajtëm inxhinierit përpara zyrës: «Duam paratë në rregull», — i thamë.

Italiani dha e mori, na kërcënoi me xhandarët, mori në telefon kuesturën e ku di unë se çfarë tjetër. Ama lekët ia morëm që ia morëm. Veçse ai punëtori me flokë të dredhur nuk u paraqit më në punë. Na thanë se e kishin arrestuar.

Rrema e ndërpreu tregimin për një çast, ofshani dhe pastaj tha:

— Ishin kohë të këqija atëherë. Ju tani punoni me gjithë këto makina e i përdorni me kaq lehtësi, sa unë habitem me gjithë mend. Njëse. E zgjata ca muhabetin, por tani bëfsh natën e mirë.

U kthye nga qeni dhe i foli sikur kafsha të merrte vesh.

— Hajde Murro, të dalim njëherë nga hangarët e duhanit.

Qeni u ngrit, tundi kokën disa herë, pastaj e ndoqi pas.

Aty nga dreka Pali thirri në barrakë ushtar Shpëtim Gjergjin dhe i zgjati fletëlejën.

— Merreni, ushtar Gjergji.

— Ju falem nderit, shoku komandant! Po motopompën kujt t'ia dorëzoj?

— Lërja ushtar Markut!

— Si urdhëroni!

Djaloshi e përshëndeti oficerin e tij tërë gëzim dhe u largua nga zyra me vrap. Pali e ndoqi me sy deri sa doli jashtë.

«Djalë punëtor, — mendoi, — e ka hak liridaljen».

Një natë më parë e kishte gjetur Shpëtimin tek flinte mbi zhavorr me krahun nën kokë. S'kishte lënë vend pa e kërkuar. Motopompa kishte pësuar një defekt dhe nuk dërgonte më ujë nëpër betonierat. Makinat pushuan së punuari dhe në errësirën e natës dukeshin si kafka të stërmëdha kafshësh prehistorike që kishin hapur gojën, gati për të gëlltitur ndonjë gjah.

— Ku është ushtar Shpëtim Gjergji?, — kishte pyetur ushtarët e turnit të natës.

— Në kapanon.

— Dërgoni njeri për ta thirrur!

U nis një ushtar. Pas pak u kthye dhe raportoi se Shpëtimi nuk gjendej në asnjë vend. Shtrati i tij qe i paprekur.

— Kërkojeni edhe një herë!

Ushtar Shpëtim Gjergji nuk gjendej. Për një çast Pali mendoi se ai do të kishte ikur në qytet për të takuar të fejuarën. Si ishte e mundur që të linte postin luftarak? A nuk ishte për të objekti që ndërto-

hej një pozicion lufte nga nuk mund të largohet pa lejen e komandantit? Sigurisht që po. Këto gjëra rregullorja i shpreh shumë qartë. Mos që fajtor ndoshta dhe vetë Pali? «Një komandant i mirë duhet të jetë njëkohësisht edhe një pedagog i mirë», — mendoj. Ai i njihnte pothuajse të gjithë ushtarët e kantierit që merreshin me ndërtimin e objektit. Pali u qëndronte pranë, jetonte me gëzimet dhe shqetësimet e tyre. Të jetuarit e të punuarit me ushtarët e kishin mësuar Palin që të kuptonte se secili prej tyre ishte një botë më vete. Ndërsa ushtar Shpëtim Gjergji ishte njeri i qetë, i qëndrueshëm dhe dallohej për qartësi mendimi e veprimi; ushtar Marku ishte i rrëmbyer dhe i kryente punët me nxitim. Duke u nisur nga këto veçori, Pali bënte me secilin punë të diferencuar.

Mos vallë kishte gabuar në përcaktimin e karakterit të Shpëtimit? I mërzitur, u vu vetë ta kërkonte. Por ushtari nuk gjendej. Atëherë vendosi të zbriste në lumë dhe të merrej me riparimin e motopompës. Duke kaluar pranë barrakës iu bë sikur pa një hije mbi zhavorr. Ndezi elektrikun e dorës: një ushtar që shtrirë përtokë. U afrua i shqetësuar. Kur ç'të shikonte! Ushtar Shpëtim Gjergji flinte me kokën mbështetur në krahun e djathtë mbi zhavorr. Doli se ai kishte dy net që nuk flinte, duke ndenjur rojë pranë motopompës, që ajo të mos fikej. Ushtari kishte ndenjur mbi zhavorr për t'u çlodhur dhe siç dukej e kishte zënë gjumi.

Ja, kështu i ndodhi Palit një natë më parë me ushtarin me duar të arta. Tani, ai me biletën e liri-daljes në xhep, i veshur me uniformë të re, do të vraponte në xhade, do t'i hipte ndonjë Skode apo Zisi dhe do të fluturonte në drejtim të qytetit tek e fejuara.

Po ai vetë, si i kishte punët me mësuesen lesh-verdhë që i pat hyrë aq shumë në zemër kohët e fundit? Ai kishte pyetur për të. I kishin thënë fjalët më të mira për familjen dhe për vajzën. Babai i saj kishte qenë oficer, ndërsa tani që në pension dhe merrej me punë shoqërore në lagje. Pali hodhi sytë nga dritarja dhe që andej pa shkollën, nxënësit tek luanin në kohën e pushimit, duke ndjekur njëri-tjetrin. Pranë derës së shkollës qëndronte mësuesja flokëverdhe, veshur me një triko të kuqe lesh deveje që i rrinte aq mirë. Pali pati përshtypjen se dhe mësuesja herë pas here lëshonte vështrimin nga barrakja. Cilin kërkonin të shihnin ata sy? Ndoshta atë? Pali nuk dinte si t'i përgjigjej kësaj pyetjeje. Sa do të donte ta mësonte sekretin e atij vështrimit të ëmbël! Përditë ai merrte zotim se do të shkonte në shkollë të njëhej me arsimtarët, të njëhej edhe me mësuesen leshverdhë, vajzën e oficerit pensionist. Por çdo ditë e shtynte zotimin për të nesërmen, ndërsa dashuria ndizej në zemër si një zjarr që rritej e rritej...

Atë pasdite që ushtar Shpëtim Gjergji u nis për në qytet, qielli u mbush me re. Ato vinin nga jug-perëndimi të shtyra nga një erë e ngrohtë. Shpëtimi zbriti nga makina në qendër të qytetit, përshëndeti ushtarakisht një oficer që i kaloi pranë dhe pastaj u nis për tek e fejuara. Sapo hyri në shtëpi të saj, filluan të binin disa pika shi: herë pas here shkrepë-tinte dhe gjëmonte. Shpëtimi shikonte shiun tek bin-te mbi çatitë, mbi xhade, njerëzit ecnin me nxitim, ose mbroheshin nga uji duke qëndruar nën ballkonet e apartamenteve të rreshtuara gjatë rrugës.

Djaloshi i hidhte sytë vajzës dhe buzëqeshte.

— A vemi në kinema?, — i tha ajo.

— Mirë, — ia ktheu ai i kënaqur.

...Duke parë filmin, Shpëtimi lëmonte flokët e së fejuarës dhe mendonte: «Sa të butë që i ka?». Kur doli nga shtëpia djaloshi qëndroi mjaft kohë në rrugë për të gjetur makinë. Si këtë radhë nuk i kishte ndodhur ndonjëherë. I pat qëlluar që, me të dalë në rrugë, makina e parë që kalonte andej e merrte për ta çuar në drejtim të objektit ushtarak. Ndoshta Shpëtimi nuk do të shqetësohej kaq shumë për makinat sikur të mos kishte merakun e motopompës. Ç'ndodhte vallë me lumin? Atëherë me siguri që motopompa do të dëmtohej. Por ja, më në fund u dëgjua një zhurmë motori. Shpëtimi e njohu se automjeti që po afrohej ishte Skodë. Ngriti dorën. Makina ndali disa metra më tutje. Hipi në kabinën e ngrohtë. Teshtiu nja dy herë. Shoferi i hodhi vështrimin dhe i uroi shëndet. Djaloshi e falënderoi dhe nuk foli më. Ai nuk kishte qejf të bisedonte. Mendja i vrapoi buzë lumit, atje ku gjendej motopompa e kantierit.

Në afërsi të objektit zbriti nga makina, falënderoi shoferin dhe u zhduk me vrap nëpër errësirë, në drejtim të buzës së lumit. Për një çast shtangu. Iu bë sikur një dorë e fortë dhe e padukshme e shtrëngoi në fyt. Në vendin e motopompës, një grumbull i madh ushtarësh e fshatarësh jepnin e merrnin njëri me tjetrin.

— Ç'ka ngjarë?, — pyeti ushtar Markun.

— Ti je, Shpëtim? Lëre. Motopompën e mori lumi.

— Mos, more!

Ushtar Shpëtim Gjergji çau grumbullin e njerzve me bërryla dhe doli në krye. Atje gjeti inxhinier Palin të bërë qull tek jepte udhëzime dhe xha Rremën, rojën e kooperativës.

- Sillni litarin!
- Po vjen!
- Fenerët kundra erës, a erdhën?
- Si urdhëron!

Vendi u ndriçua nga dritat e zbeta të fenerëve.

— Ta lidhim motopompën me litar, pastaj ta tërheqim, — tha xha Rrema.

Shpëtimi iu drejtua inxhinier Palit:

- Shoku inxhinier, të futem unë në lumë?
- Jo ti. Ku është Petriti? Ai është notar i mirë.
- S'është këtu.
- Kjo gjë më takon mua!, — nguli këmbë Shpëtimi.

— Ti nuk di not mirë!

Ushtar Shpëtimi nuk i dëgjoi fjalët e tjera që tha Pali. Ai u gjend në ujërat e ftohta të lumit, me litarin në dorë.

- Ushtar Shpëtim Gjergji, ju...
 - U hodh!
 - Ai nuk është në vete.
- Pali thirri me zë të fortë:

— Pushoni! Ndhimoheni! Afroni fenerët!

Shpëtimi po luftonte me valët e tërbuara të lumit, duke kërkuar me duar motopompën. Nuk e gjeti në vendin e saj. Atëherë shkoi më tutje. Një dallgë e goditi në fytyrë duke i marrë për pak frymën. Ndjeu se piu mjaft ujë të trubullt me shijen e dheut. Megjithatë, duke mbajtur litarin me dorë, zbriti më në thellësi. Krahët i qenë rënduar dhe mezi çante ujin. Bëri një zhytje me kokën poshtë e me duart përpara... Dora i ndeshi në një send të fortë. Ç'që ai send? Hekur apo dru? U zhyt dhe një herë. Ishte hekur. Pra që matopompa. Tani i duhej ta lidhte me litar, në mënyrë që shokët të mund ta tërhiqnin. Duhej zhytur për-

sëri. Por e kuptoi se nuk kishte më forca. E ndiente veten tmerrësisht të lodhur, të rraskapitur. Si të bënte? Të ikte që andej në drejtim të buzës së ujit? Ai i kishte bërë të gjitha përpjekjet dhe mund të kthehej ballëhapur tek inxhinier Pali, te shokët e tij. Dhe askush nuk do t'i thoshte një gjysmë fjale. Po pse të mos provonte të zhytej edhe një herë? Mblodhi të gjitha forcat, u dha këmbëve përpara dhe ndjeu se po zhytej në thellësi të lumit me litarin në dorë, drejt motopompës. Ja tek e preku, u përpoq të bënte lidhjen, po fryma po i merrej dhe veshët i buçisnin, i buçisnin...

Inxhinier Pali që nga bregu ndiqte lëvizjet e ushtarit që luftonte me dallgët e tërbuara. Kur vuri re se ai nuk po dilte në sipërfaqe, u hodh në lumë duke thirrur:

— Shpëtimi është në rrezik!

E kapi Shpëtimin për krahu dhe e tërhoqi për nga buza e lumit, por s'kishte çikur akoma këmbët në tokë, kur ndjeu një goditje nga një kërcu i madh, që uji i lumit e kishte sjellë me vete.

Kur u përmendën, ata u gjendën në një dhomë të vogël të spitalit të qytetit. Pranë Shpëtimit qëndronte një vajzë e re. Pali e mori me mend se ajo duhej të ishte e fejuara e ushtarit me duar të arta... Po ai? Patjetër kur të dilte nga spitali do të njihej me vajzën e tij, me mësuesen leshverdhë, vajzën e oficerit pensionist dhe së bashku me të do të kalonin mbi urën e ndërtuar.

PESEQIND METRA LARG SHTEPISË

Nënreparti marshonte i ngjeshur, me armë, me kundragaz e me çantat e shpinës në errësirën e natës. Nata qe pisë e zezë dhe retë e dendura e të ngarkuara e bënin edhe më të errët. Shiu nuk donte të pushonte. Binte shtruar, pa zhurmë dhe lagte tokën, rrugët, pemët e ushtarët që marshonin. Herë pas here shkrepëtimat me zigzage çanin për pak sekonda perden e zezë të natës dhe vinin në dukje ata njerëz të armatosur që ngjiteshin në qafë në kolonë për një.

Sipas urdhrit të komandës, nënreparti në orën 3 të mëngjesit duhej të gjendej te baxhoja e kooperativës nja pesëqind metra larg fshatit. Aty do të bëhej një pushim më i gjatë dhe me të zbardhur drita ai do të nisej përsëri për marshim.

Ushtarët ecnin njëri pas tjetrit. Ushtar Veseli dëgjonte frymëmarrjet e tyre ritmike. Asnjëri nuk fliste. Sa më pak energji të kota të harxhoheshin, aq më lehtë do të përballohej marshimi.

Një shkrepëtimë gjarpëroi në qiell. Vetëtima qe e fortë dhe u duk sikur e dëboi errësirën nga qafa.

«Ja fshati, ja dhe baxhoja», — murmuriti ushtar Veseli.

Pas vetëtimës i erdhi radha bubullimës. Lugina dhe malet u tundën për një kohë të gjatë. Ajo bubu-

llimë i shembëllente Veselit me gjëmimin e fortë të artilerisë së rëndë në çastet e qitjes.

— Pushimi të bëhet te baxhoja!

Këtë urdhër e lëshoi komandanti i nënrepartit, që ecte në krye të kolonës. Urdhri u transmetua gojë më gojë deri tek ushtari i fundit. U dëgjuan çapa të nxituar nëpër lluc dhe copa urdhrash. Ushtar Veseli nxitoi hapin. Këmbët i kishte të lagura, kapota i qe rënduar nga uji, ndërsa duart i mbërdhinin. Herë pas here e ngiste një kollë e lehtë. Po nuk e jepte veten. Atë rrugë fshati ku po marshonte bashkë me shokët e tij e njihte si në pëllëmbë të dorës. Jo vetëm ditën, por edhe natën. Bile, dhe në një kohë si kjo me shi, me baltë dhe me errësirën e natës, që i ngjante një perdeje të zezë. Ai, ushtar Veseli, kishte lindur në atë fshat 20 vjet më parë. Atje kishte mësuar fjalët e para, atje mbaroi shkollën dhe pastaj punoi në kooperativë. Kur mbushi moshën për të vajtur ushtar me shokët e tjerë, zbriti një mëngjes herët në degën ushtarake të qytetit, ia hipi një makine të mbuluar me mushama dhe u nis për në repartin ku e kishin caktuar për të kryer shërbimin ushtarak.

«Kur kaloi një vit?!», — u habit ushtari.

Muret e baxhos ia prenë vrullin thellimit. Nën strehën e ndërtesës ushtarët e ndien veten më ngrohtë. Shiu nuk po i lagte më për një copë herë dhe gjymtyrët po u çlodheshin. Prej aty, shtëpia e re e ushtar Veselit nuk ishte larg. Ajo qe një shtëpi e bukur, me katër dhoma të mëdha, me një korridor të ngushtë e të gjatë që e kishin përfunduar dy vjet më parë. Në muret e korridorit i ati vendoste vargjet me qepë ndërsa prapa shtëpisë, në mur, ca vargje me duhan të thatë. Plaku, siç e thërriste Veseli të atin, kish-

te blerë dyshekë, radio dhe një tavolinë për të ngrënë bukë.

«Ata tani me siguri flenë», — mendoj ushtari.

Mesnata kishte kaluar. Të gjithë njerëzit në fshat bënë gjumë të thellë. Me përjashtim të rojeve të kooperativës.

«Ndoshta dhe Baloja nuk fle. Ai rri zgjuar në kolibën e tij mbështetur mbi dy këmbët e para».

Një vetëtimë dredha-dredha ndriçoi vendin. Fill pas saj u dëgjua bubullima. Veselit iu duk sikur retë në qiell po ndesheshin në një luftë të rreptë për jetë a vdekje. Nën dritën e vetëtimës ushtari dalloj si në një vegim të shkurtër shtëpitë e fshatit të tulatura njëra pas tjetrës, të mbështjella si në një tis të hollë mjegulle. Mjegulle dhe lagështie. Ja dhe çatia e shtëpisë së tij, oxhaku, dritaret! Ca më tutje dukej lëndina, shkolla tetëvjeçare dhe zyrat e kryesisë së kooperativës. Ndanë lëndinës ushtar Veseli mori me mend lapidarin e dy partizanëve të vrarë për çlirimin e fshatit.

«Ku ta dinë të mitë se unë ndodhem tani fare pranë tyre!», — mendoj Veseli duke u strukur pranë ushtar Naimit.

Ushtarët e skuadrës së Veselit qenë ulur mbi disa kërcunj njëri pranë tjetrit. Në errësirë dalloheshin vetëm cigaret e ndezura. Dëgjoheshin pikat e shiut që binin mbi pellgjet, duke krijuar me mijëra flluska jetëshkurtra.

— Kemi marshuar mirë!, — tha ushtar Naimi.

— Do të kishim ardhur edhe më shpejt po të mos na kishte penguar shiu, — u përgjigj ushtar Leka.

— Ushtari nuk do t'ia dijë nga moti. Marshimi mund të bëhet në kohë të mirë dhe në kohë të keqe. Armiku nuk pyet për kohën...

— Ujku mjegull kërkon!, — tha Veseli.

Një vetëtimë e fortë e shqeu prapë më dysh errësirën e natës. Pastaj ushtoi bubullima e llahtarshme si ortiqet kur rrokullisen teposhtë një maje të lartë.

— Në fshat ra rrufeja!, — tha ushtar Leka.

— Qepe të shkretën!, — foli Naimi i nxehur.

— Ashtu m'u duk...

Veseli nuk foli. Ai u mbështet më mirë në kurri-
zin e Naimit. U koll nja dy herë dhe një si lëmsh iu
mblodh në fyt.

«Vërtet të ketë rënë rrufeja?», — pyeti veten.

Shiu vazhdonte të binte. Ushtari ndjeu ca si të
ngjethura në trup. Çdo gjë e kishte të lagur, kapotën,
këpucët, pecet.

— O Vesel!

— Urdhëro, Lekë!

— Ti sikur je nga ky fshat, hë?

— Këndeje jam, — u përgjigj Veseli.

Ushtar Leka u habit. Thithi cigaren. Veseli mezi
dalloi në errësirë fytyrën e lagur të shokut.

— Nuk do vesh t'i takosh?

Atë çast një bubullimë tjetër e potershme plasi
në qiellin e nxirë.

— Çfarë the?, — pyeti Naimi.

— Veseli e ka shtëpinë pesëqind metra larg që
këndeje dhe nuk shkon të shohë njerëzit e tij!

— Nuk lejohet, s'ka si të thyejë rregullat.

— Po ne në stërvitje jemi, — tha një ushtar tje-
tër që s'kishte folur deri atëherë.

— Sidoqoftë është situatë luftarake!, — shtoi Ve-
seli, — nuk bën.

Ushtar Veselin e zuri pak kolla.

— A derëzi! Se mos jemi me të vërtetë në luftë, —

u dëgjua zëri i Lekës në errësirë. — Ti je edhe pak i ftohur. Pi një çaj, merr një të ngrohtë dhe eja...

— Po stërvitja është fushë beteje për ne!, — ia pat Naimi aty për aty.

Nga qielli u dëgjuan një varg gjëmimesh si të shtëna artilerie. Ushtarët heshtën, ndërsa shiu vazhdoi të binte. Dëgjoheshin pikat e ujit që përplaseshin nëpër pellgje.

Veseli që strukur pas murit, ngjitur me ushtar Naimin. Pranë vetes mbante armën. I dhembte pak koka. Ndoshta kishte dhe pak të nxehtë, megjithëse nuk e kuptonte. Atë natë i qe qepur edhe një farë kolle e s'po e linte të qetë. Tek rrinte midis ushtarëve, mendja i vajti në shtëpi, te prindët, pesëqind metra larg nga baxhoja e kooperativës. Sa ngrohtë do të ishte tani atje në shtëpi! Atij i dukej sikur shikonte gjithçka. Ja, qepët e thata të varura nëpër muret e korridorit dhe radioja e markës «Durrësi». Ja tavolina ku mblidheshin e hanin babai, nëna, motrat, vëllezërit. Plaku ishte ca i heshtur e fjalëpakë, por zemrën e kishte të mirë. Po të shkonte ai, me siguri do ta pyeste nëse kishte marrë lejë nga komandanti. Çfarë do t'i thoshte Veseli? Balli i plakut do të vrenjtej, sytë do t'i merrnin një pamje të egër: «Djalë, — do të thoshte, — s'të kemi dërguar në ushtri që të na turpërosh».

— Ec i thuaj komandantit, mbase të jep lejë!

Zëri i ushtar Lekës iu ngul në kokë si një turjelë. Atë ende s'e kishte zënë gjumi.

— Dëgjon, Vesel?

— Lëmë, o Lekë! Të thashë një herë, nuk vete.

— Epo ky! Të vijë njeriu pesëqind metra larg shtëpisë dhe të mos kthehet një hop t'i shohë!

— Leka, mos llo motit shumë!, — ia preu Naimi.

Atij po i vinte inat me ushtar Lekën. Veseli deshi të ndërhynte e t'i jepte një kthesë tjetër bisedës. E njih- te mirë Naimin, komandantin e skuadrës së tyre. Ai nuk t'i falte gabimet, ai të kritikonte flakë për flakë.

Atë çast qielli dhe fshati u ndriçuan nga një shkrepëtimë e fortë.

Krisma e bubullimës përsëri vazhdoi për një ko- hë të gjatë. Veselit iu kujtua se kur ishte i vogël gjyshja ia shpjegonte bubullimën si një zhurmë që e shkaktonte një karrocë e madhe e ngarkuar me gurë që kalonte përmbi re me vrap të çmendur.

Ushtari qeshi me shpjegimin naiv të gjyshes pla- kë. Ndjeu prapë pak të ftohtë. U struk edhe më pranë Naimit.

«Po Naimi vallë nuk mbërdhin? Po komandanti? Të gjithë janë lagur, të gjithë mbërdhijnë. Jemi në stërvitje. Nënreparti ynë marshon me një detyrë të caktuar. Nuk bën piknik këndeje. Askush nuk ka të drejtë të ikë. Askush. As unë që e kam shtëpinë kaq afër».

Zëri gërvishës i Lekës u dëgjua përsëri:

— Eh! Ç'do të desha tani të isha në një dhomë të ngrohtë, pranë zjarrit bubulak e të thahesha!

Naimi thithi cigaren me nervozizëm.

— Ushtria është ushtri. Të ikësh nga rreshti është njësoj sikur të lësh pozicionin. Mos harro se gjatë Luftës Nacionalçlirimtare partizanët kanë qenë në si- tuata shumë më të vështira dhe prapëseprapë nuk u thyen.

— Ti, Leka, je liberal!, — tha ushtari që fliste në të rrallë. — Jeta ushtarake kërkon disiplinë. Ç'do të ndodhte sikur të gjithë ta braktisnin shërbimin? Ë? Ç'do të ndodhte?, — zëri i Naimit vinte duke u ngritur. — Do të dobësohej gatishmëria luftarake.

— Kush largohet pa lejë thoni ju?, — tha ushtari që fliste rrallë. — Kush del i çrregullt? Ai që nuk e do disiplinën.

Veseli ishte fare i qetë. Midis shokëve ai e ndiente veten mirë, të sigurtë dhe ngrohtë. Kush tjetër, veç kolektivit ushtarak, mund t'ia jepte atë ndjenjë sigurie dhe qetësie shpirtërore? Vërtet ishte lagur, mbërdhinte, marshimi e kishte lodhur, por, duke qenë efektiv i nënrepartit, duke u gjendur pranë shokëve ushtarë, as që i ndiente më të ftohtët dhe lodhjen.

«Sa do të jetë, vallë, ora?», — mendoi me vete.

Shiu sapo kishte pushuar. Ushtarët në pjesën më të madhe dremisnin. Vetëm Veseli nuk flinte. Ai donte të shikonte atë çast të bukur të muzgut në fshatin e tij, kur nata tërhiqet pa e kuptuar për t'ia lënë vendin ditës së re. Ushtari sapo nisi të dallonte konturet e maleve e të kodrave. Një gjel këndoi nga lartësia e një peme. Pastaj një tjetër.

Një raketë ngjyrë jeshile u duk përtej kodrave të fshatit. Ajo u ngjit përpjetë drejt qiellit deri në një pikë dhe pastaj u var poshtë, duke ndriçuar bukur faqet e kodrave.

— Është sinjali!, — tha Veseli.

— Nënreparti, çohu! Gati për marshim!

Urdhri i komandantit i vuri të gjithë në lëvizje. Marshimi filloi përsëri.

ZBULUESIT

Atë ditë bënte vapë e madhe. Në drejtim të kufirit tonë vinin re të zeza, që sillnin me vete erë baruti. Armiku atë ditë kishte marrë një mësim që do ta mbante mend për një kohë të gjatë. Nënoficer Agimi dhe unë ndiqnim këmba-këmbës komandantin e nënrepartit një mesoburrë me ca mustaqe të holla. Duke ecur pas tij, i shihja shpinën pak të kërrusur, shpatullat e gjera, çantën krahaqafë dhe pistoletën në këllëfin prej lëkure. Pylli ku kalonim qe i dendur, me pisha të larta që të mahnisnin me bukurinë e tyre.

«Ç'vende të rralla ka atdheu ynë!», — mendova me vete.

Ne po shkonim për zbulim. Do të përmbushnim një detyrë luftarake sa të rëndësishme aq edhe të rrezikshme. Unë ndieja krenari që një detyrë e tillë më qe besuar edhe mua. Ndoshta krenar e ndiente veten edhe Agimi.

Komandanti i nënrepartit qëndroi.

— Të çlodhemi pak!, — tha ai dhe ndenji mbi një kaçubë. Balli i qe mbushur me djersë. Hoqi helmetën nga koka dhe fshiu djersën me shami.

— A u lodhët?, — pyeti.

— Jo, nuk u lodhëm, — iu përgjigj Agimi duke më parë në sy. Unë nuk fola. Nënër atë pyll të dendur, tërë hije, me ajër të freskët, me aromë rrëshire e midis pishave të gjata, vërtet nuk e kisha ndier lodhjen. Komandanti ndoshta dhe mund të qe lodhur. Ai ishte më i madh se ne në moshë, megjithëse i mbajtur dhe i shkathët. Atë ditë kishte veshur uniformë fushore të vjetër, por të pastër. Çdo gjë tek ai qe e bukur. Duke e parë, e kuptoje se atij njeriu i pëlqenin rregulli dhe përpikmëria.

Agimin e kisha komandant skuadre. Qe një djalë i zgjuar dhe serioz. Ne, të skuadrës, e dëgjonim dhe i zbatonim urdhrat e tij.

Përpara nesh shtriheshin transhetë e armikut. Andej matanë qe një botë tjetër. Ajo e atyre që donin të gllabëronin qoftë edhe një copë nga toka jonë e shtrenjtë.

Arritëm te vendi ku disa orë më parë ishte zhvilluar një betejë e vërtetë e ku sulmi armik qe thyer nga nënreparti ynë. Ne pushtuam dhe përforcuam lartësinë dominuese. Fusha e betejës qe mbushur me gropa të mëdha e të vogla. Kishte aq shumë gropa të shkaktuara nga predhat, sa që nuk gjeje një copë vend të sheshtë për të vënë këmbën.

Mbi ca tela me gjemba dukej një kufomë armiku që kishte mbetur në një pozicion të çuditshëm, me sy të zgurdulluar e të ngrirë nga tmerri.

— Fillojmë nga puna!, — urdhëroi komandanti, duke nxjerrë nga çanta një hartë ushtarake. — Shikoni! Në drejtim të orientuesit nr. 1. ndodhet një mitraloz, i cili hap zjarr në çdo dyzet minuta. Pak më tutje, tek ajo kaçuba e zhveshur, gjendet një pikëmbështetje toge fanterie.

Detyra na u bë edhe më e qartë. Tek armiqtë

diçka po ndodhte. Vinin forca të reja, teknikë e rëndë, lëviznin makina. Ato vinin natën, në errësirën më të madhe. Ç'ishin ato forca? Kujt njësie i takonin? Ç'qëllime kishin?



Ne nuk duhej të ndesheshim me armikun. Neve na duhej vetëm të shikonim se ç'bëhej në radhët e tij. Ky ishte qëllimi ynë.

Dalja për zbulim në anën e armikut ngjall emo-

cione të çuditshme. Agimi kishte marrë pjesë edhe herë të tjera në zbulime të tilla, kurse unë e kisha për herë të parë. Frikë nuk kisha. Më tepër më hante merakun se nuk dija nëse isha në gjendje ta kryeja mirë detyrën. Ja, vetëm këtë shqetësim kisha, asgjë tjetër.

Në mbrëmje iu afruam vendit të caktuar. Kaluam pozicionet e nënrepartit pranë pyllit. Pastaj pritëm sa u err. Agimi rrinte i heshtur dhe sytë i mbante të mbërthyer në drejtim të shtegut. Gjakftohtësia e tij ndikonte për mirë tek unë. Mundohesha të isha i duruar si ai, zbuluesi më i mirë i nënrepartit tonë.

— Tani do të kalojmë!..., — tha Agimi dhe eci përpara. — Numëro njëqind hapa dhe pastaj merr djathtas!

Komandanti i skuadrës i shqiptoi këto fjalë fare thjeshtë, sikur të thoshte: «A po vjen të dalim shëtitje?». E ndoqa pas duke i qëndruar dhjetë hapa larg.

Errësira qe e madhe. Për një çast e humba Agimin nga sytë; duhej të ecja me kujdesin më të madh, sidomos në pyll. Kur hidhja hapin, në fillim vendosja mbi tokë thembrën pastaj gjithë shputën. Vetëm kështu mund të mënjanohej zhurma e gjetheve të thata. Në çdo hap që bëja, ruheshja nga të papriturat. Armiku është i pabesë dhe të ngre kurthe të çuditshme. Mund të vendosë roje të maskuara, ushtarë mbi pemë që të të kapin në befasi, duke të ngulur një thikë në bark apo në shpinë.

«Po Agimi ç'u bë, vallë? Ku është ai?» Fillova të numëroja hapat me mendje. «Tridhjetë... pesëdhjetë; tetëdhjetë... nëntëdhjetë. Nëntëdhjetë e nëntë, njëqind. Tani duhet të marr djathtas!».

Silueta e komandantit të skuadrës më doli menjëherë përpara. Ai ngriti dorën lart dhe ma bëri me

shenjë që t'i afrohesha. Ne merreshim vesh vetëm me shenja. Asnjë fjalë s'thoshim. Në çdo hap vinim në zbatim udhëzimet e komandantit të nënrepartit. Ai më dukej sikur na ndiqte pas, veshur me uniformën fushore dhe me pistoletën në këllëf, i rregullt e i përpiktë, me atë fytyrë burrërore dhe me mustaqet e zeza, që i shkonin aq mirë.

Tutje dëgjoheshin të shtëna artilerie. Në çdo dyzet minuta mitralozi armik bënte qitje në drejtim të frontit tonë. Shokët rrinin në pozicione, nëpër tran-she, me syrin në shtjegëz, për t'i dhënë armikut në çdo kohë një mësim të ri.

Agimi dhe unë u futëm në zonën armike. Ecnim mengadalë. Vende-vende rrezet e hënës binin mbi pyll si ca njolla të zbета. Në një gropë të hapur nga predhat e artilerisë sonë qenë shtrirë tri kufoma ushtarësh armiq. Vazhdonim rrugën me zig-zage, duke shfrytëzuar vendet me hije. Gjithnjë e më tepër largoheshin nga rajoni ku luftonte nënreparti ynë, por zemrën e kishim atje, te shokët, në tran-she, te pika e vrojtimit ku qëndronte komandanti. Mendja më bridhte edhe më larg, te njerëzit e mi, në fshat. Ne luftonim edhe për ata. Sa më kishte marrë malli për nënën, babanë, vëllezërit! Ishte vonë. Në atë orë ata flinin. Çdo gjë në shtëpi dhe rreth saj ishte kredhur në qetësi të ëmbël: pusi, gardhi, koteci, fiku i madh. Gjithçka ishte në vendin e vet, ashtu siç e kisha lënë atë ditë që erdha në ushtri. Më tutje ishin zyrat e kooperativës, pastaj stallat e gjata e të mëdha ku punonte Lumtoja, ime motër.

Agimi ma bëri me shenjë që t'i afrohesha. Siç dukej po i afroheshim burimit ku ushtarët armiq vinin të mbushnin ujë. Sa kohë do të rrinim aty? Një orë? Dy? Ndoshta më shumë. Burimi ishte tamam nën

këmbët tona. Dëgjonim rrjedhën e tij në pellgun me ujë. Qëndronim pa lëvizur e pa folur afër njëri-tjetrit. Papritur komandanti i skuadrës dëgjoji një zhurmë të lehtë. Ai qëndroi për një kohë të gjatë me kokën të kthyer anej prej nga iu duk se erdhi zhurma e dyshimtë. Çfarë të ishte vallë? Pëshpëritje? Zhurmë e lehtë armësh?

— A dëgjon gjë?, — më pyeti Agimi duke lëvizur buzët lehtë.

— Jo.

Vërtet nuk dëgjoja asgjë. Në drejtim të orientuesit nr. 1 në çdo dyzet minuta mitralozi armik hapte zjarr. Ndieja breshërinë e tij dhe mendoja: «Asgjë, nuk do t'u pijë ujë». Nga larg vinin zhurma të çuditshme si oshëtima të mbytura. Ato ishin makina që sillnin forcat, afronin teknikën dhe që grumbulloheshin përballë nesh me drita të errësuar. Këto, po, i dëgjoja. Po zhurmën për të cilën më pyeti Agimi, nuk e kapja dot. Ishte e kjartë që nuk i kisha aftësitë e një zbuluesi me përvojë.

Kisha dëshirë të flisja me Agimin, të shkëmbeja ndonjë fjalë, apo ndonjë shaka. Por atje në pyll, në prapavijën e armikut, kjo ishte e pamundur. Çdo zhurmë që bënim, sado e vogël, dukej sikur kumbonte me një tingull të çuditshëm, si kërcitja e gjetheve që shkelnim me këmbët tona, apo ndonjë degë e thatë që thyhej mbi tokë nën peshën e trupit. Vazhdonim të ishim gjithmonë të kujdesshëm e të vëmendshëm ndaj çdo gjëje, njëlloj si në fillim. Kishim arritur te burimi. Më tutje nuk shkonim dot. Detyra jonë ishte të hynim në prapavijat e armikut pa u diktuar, të kapnim një ushtar dhe të kalonim shëndoshë e mirë në anën tonë. Nga kryerja me sukses e kësaj detyre

luftarake varej suksemi i luftimeve në ditët e ardhshme.

Ndoshta kishim më shumë se dy orë që prisnim fshehur në shkurret pranë burimit. Të mbështetur me bërrylat në tokë dhe me kokën pak të ngritur, shikonim me vëmendje andej nga kishte ardhur ajo zhurma e pakjartë.

— Dëgjon?

Kësaj radhe diçka po dëgjoja. Ishte një zhurmë e pakuptueshme, që i ngjante më tepër zhurmës së hapave dhe fërkimit pas shkurreve.

«Çfarë të jenë? Hapa njeriu apo zhurmë që bën ndonjë kafshë pylli?», — thosha me vete.

Përtej burimit duhej të ishte me siguri ndonjë repart ushtarak, ose ndonjë shtab. Që andej mund të vinte ndonjë ushtar apo ordianca e ndonjë oficeri për të mbushur ujë. Duhej pritur me durim.

A mund të qëndronim më gjatë në atë vend? Ndoshta pas një ore ose dy orësh do të gdhinte dhe atëherë do ta kishim më vështirë qëndrimin. Do të na duhej të prisnim gjithë ditën e ditës fshehur nëpër shkurre derisa të vinte prapë nata.

Agimi lëvizi kokën duke e shpënë përpara. Lëvizja që e lehtë, por shprehte një shqetësim të madh. E kuptova se ai diçka kishte dalluar në errësirë.

— Dikush po vjen, — tha duke pëshpëritur.

Nga shkurret doli një armik me disa pagure në duar. Ne, me nuhatjen tonë prej zbuluesi, e kuptuam se ai kishte pirë. Vinte në burim për të mbushur ujë. Ecte i shkujdesur. Atij as që i shkonte ndër mend se disa hapa më tutje unë me Agimin po e ndiqnim me vëmendje e të gëzuar. Distanca midis nesh e atij bëhej përherë e më e vogël, deri sa më në fund armiku u gjend fare pranë nesh. Ai, duke u lëkundur, u ul ga-

liç dhe nisi të mbushte paguret me ujin e burimit, duke murmuritur nëpër dhëmbë refrenin e një kënge të panjohur. Pastaj, pasi fshiu buzët me mëngën e xhaketës, u nis për andej nga erdhi. Tani ai nuk gjen-dej veçse një ose dy hapa larg nesh. Ne, qëndronim në pritje, pa bërë as lëvizjen më të vogël. Po sikur të na ikte? Pse Agimi nuk po vepronte?

— Gati!, — murmuriti ai.

Me një lëvizje të shpejtë dhe të stërvitur iu hodhëm sipër dhe e lidhëm si një pako, që priste vetëm për t'u transportuar.

Tani ne po ktheheshim në pozicionet tona duke mbajtur mbi supë peshën e njeriut që kërkonim. Ai qe i rëndë, por unë dhe Agimi gati nuk e ndienim. Nxitonim që të arrinim sa më parë te shokët tanë, pranë komandantit, që na priste me ankth dhe ndoshta i shqetësuar. Mëngjesi po binte. Kur arritëm në pozicionet tona, nisën të dalloheshin konturet e maleve.

NJË RADIOGRAM

Natën vonë autoambulanca doli nga reparti dhe u nis në drejtim të garnizonit të largët. Qielli qe mbuluar me re të dendura, të nxira pisë, prej nga binte një shi i rrëmbyer, si me shtamba. Fshirëset e xhamit lëvizin ritmiksht, me një zhurmë monotone, duke bërë një copë vend të pastër e pa ujë, prej nga shoferi shikonte xhadenë e lagur dhe pemët e bëra qull.

«Ç'kohë e keqe, — tha me vete Alekoja, mjeku i repartit duke mbuluar gjunjët me kapotën ushtarake, — duhet të arrij sa më shpejt tek ushtari i sëmurë».

Kishte dy ditë që binte shi. Herë pas here qielli çahet mëdysh nga shkrepëtimat gjithë dredha e me shkëlqim verbues. Por Alekos nuk i bënin përshtypje.

Një orë më parë se të nisej, një radiogram i shkurtër qe vendosur mbi tryezën e operativit të repartit. Në të thuhej shkurt: «Një ushtar shumë i sëmurë, dërgoni mjekun!». Korrieri i shtabit trokiti në derën e shtëpisë së Alekos dhe lajmëroi se e kërkonin në komandë. Mjeku u çua, mbylli librin që lexonte, u vesh dhe u nis për në repart.

Pas pak u gjend në komandë dhe trokiti në zyrën e shefit operativ.

Ata biseduan së bashku. U përpoqën të merrnin

në telefon garnizonin e largët, për të marrë vesh më mirë gjendjen e të sëmurit. Po zëri vinte i dobët ose herë-herë nuk dëgjohej fare... Nga ato pak fjalë që mundi të kapte nëpërmjet kufjes së telefonit, kuptoi se ishte fjala për një ushtar të sëmurë, me temperaturë të lartë, që merrte frymë me vështirësi, që villte dhe që kishte shqetësuar efektivin e garnizonit të vogël...

Shiu s'kujtohej të pushonte. Rruga e largët dhe balta e ngjeshur e bënë të vështirë vajtjen pranë të sëmurit. Autoambulanca rrëshqiste mbi asfaltin e lagur. Dritat e makinës binin mbi xhade, mbi pemët e qullura, mbi shtyllat e telefonave, të cilat zhdukeshin pas, në errësirë, me një shpejtësi të çuditshme.

Pikat e shiut, duke rënë përpara dritave të makinës që gumëzhinte, dukeshin si litarë që vareshin nga qielli i nxirë.

— Kohë e keqe!, — foli shoferi duke i hedhur mjekut një vështrim.

— Vërtet kohë shumë e keqe, — u përgjigj Alekoja.

— Edhe rruga nga do të vemi është e keqe.

— Është e vështirë ditën e jo më natën, — ia pat mjeku i menduar.

— Po sikur të mbetemi?, — pyeti shoferi i autoambulancës me keqardhje...

— Ne do të vemi njëherë deri atje ku mund të shkojë makina, pastaj...

Shoferi nuk e ngau më tutje bisedën. Kur ora shënoi mesnatën, autoambulanca la xhadenë dhe u fut nëpër rrugën tërë gropa e të mbushura me ujë. Një erë e ftohtë dhe e lagësht lëkundte degët e holla pa një gjethe të plepave buzë rrugës. Duke u lëkundur orë e çast mbi ndenjësë, mjeku sillte ndër mend

përpjekjet që bënte oficeri i shërbimit operativ për t'u ndërlidhur me garnizonin e largët dhe për t'i njoftuar se mjeku i repartit ishte nisur në drejtim të tyre.

— Sa është ora?, — pyeti shoferi duke vështruar me kujdes përpara.

— Dy!

Motori i makinës rënkonte nga sforcimi. Rrotat mezi shqiteshin nga balta e trashë. Vende-vende autoambulanca kalonte nëpër mjegull. Shoferi e ngiste me kujdes, duke afruar kokën pas xhamit, me sytë e skuqur nga pagjumësia. Një pakujdesi e vogël dhe...

Mjeku kishte përshtypjen se errësira e natës i deformonte gjërat. Nëpër këtë rrugë malore, që gjarpëronte midis pyllit, ai kishte kaluar disa herë: njihte fshatrat me emër, dinte vendet e lapidareve, barrakën e rojtarit të pyllit. Po tani, në errësirën e natës, e kishte të vështirë të orientohej. Vendet ku po kalonte i dukeshin sikur s'i kishte parë kurrë.

I hodhi një vështrim shoferit.

— Ku jemi?, — e pyeti atë.

— As unë s'po e marr vesh, — u përgjigj shoferi.

Fenerët e makinës shponin erësirën si një tyrjelë duke nxjerrë në dritë shtëpitë e kooperativistëve, arat e punuara apo ndonjë shkollë në trajtë U-je.

Sanitari, ushtar Zenuni, zbriti nga makina.

— O roje!, — thirri.

— Kush je ti?, — e pyeti një zë që nga errësira.

— Jam një ushtar.

— Çfarë kërkon?

— Ku jemi këtu?

Zëri tha emrin e fshatit. Mjeku dhe shoferi e kuptojnë se janë akoma larg nga garnizoni i veçuar. Ata dëgjojnë ushtar Zenunin që po afrohet.

Autoambulanca vihet prapë në lëvizje. Përsëri baltë, kthesa të forta dhe mjegull. Shtyllat e telefonave e të elektrikut gjithnjë mbeten pas. Makina merr një kthesë dhe gjendet papritur përpara një pengese: një karrocë e mbushur jashtë mase me kashtë misri ngrihet në mes të rrugës si një mullar. Shoferi lëshon një të sharë. Mjeku shqetësohet.

— Edhe kjo na duhej tani!, — shfryu ai tërë inat.

Dalin nga makina që të tre. Vështrojnë karrocën dhe mendohen.

— Ta hedhim poshtë!, — foli shoferi i zemëruar.

— Ndoshta e lëvizim, — tha mjeku i mërzitur.

Provuan se mos e lëviznin, por s'qe e mundur.

— Ka rënë në gropë, — tha ushtari.

— Ta rimorkiojmë, — foli shoferi dhe u nis të nxirrte kavon prej teli të fortë.

Rrotat e karrocës kërkëllinë. Kavoja u tendos, thujse po këputej nga forca tërheqëse e makinës. Karroca lëvizi nga vendi.

Nata ishte e errët si një pus i thellë. Shiu binte i përzier me dëborën, si llohë. Bënte ftohtë. Një gjel këndoi diku aty afër. Të tjerët e pasuan.

— Nisemi!

— Nisemi, — tha shoferi duke fërkuar duart e ngrira.

Makina rënkoi nëpër të përpjetat e kodrave që vinin njëra pas tjetrës. Motori ishte nxehur dhe në kabinë bënte ngrohtë. Rrotat mezi shqiteshin nga balta e trashë si tutkall. Vende-vende kaluan nëpër një mjegull të hollë që, nën ndriçimin e dritës, dukej si tymi kaltërosh i duhanit. Shoferi fshinte xhamin vazhdimisht me një leckë të bardhë për të larguar avullin që i pengonte shikimin. Atje ku rruga dukej më mirë, ai ia shkelte gazit. Bërrylat i dhembnin nga

lëvizjet e vazhdueshme të timonit, që në atë baltë kërkonin mundim të dyfishtë. I vinte të mbyllte sytë, goftë dhe për një çast, se i bëhej që ashtu do të rimernte forca.

— U lodhe?, — e pyeti mjeku.

— Jo.

— Po të duash, fli pak!...

— Do të fle më vonë, pasi të arrijmë.

Oficerit i erdhi mirë për vendosmërinë e shoferit. Ai pa atë as që mund të vinte aq shpejt aty ku kishte ardhur. Ata kishin pothuaj gjithë natën që po udhëtonin në drejtim të garnizonit të vogël, ku dergjej i sëmuri.

Makina ishte nxehur për së tepërmi. Rruga sa vinte bëhej më e vështirë, me të përpjeta dhe të ta-tëpjeta. Shoferi mendohej t'i vinte rrotat nëpër tragat e thella të karrove të fshatit.

— Më duket se mbetëm!, — tha mjeku me keqardhje. — Makina nuk ecën më.

Shoferi nuk u përgjigj. Ai jepte e merrte me marshin dhe me gazin. Makina lëkundej herë përpara, herë mbrapa por pa sukses. Nata filloi të thyhej. Mezi dukeshin siluetat e kodrave, deti dhe një anije peshkimi që ishte mbrojtur nga erërat e natës në gjirin e qetë.

Përpjekjet e shoferit për ta nxjerrë autoambulancën nga gropa nuk patën sukses. Atëherë Alekoja mori çantën në dorë dhe zbriti poshtë, duke u zhytur në baltë.

— Unë po nisem bashkë me ushtarin, — i tha shoferit. — Po lajmëroj në fshat që të të ndihmojnë për të nxjerrë makinën.

— Nisuni, doktor, në fshat do vete vetë, ja tek është, shkoni shpejt tek i sëmuri.

— Mirupafshim!

Bashkë me ushtarin u nisën në këmbë duke kaluar nëpër monopate, duke kapërcyer kaçuba, duke shkarë nëpër baltë e në gropa. Sipas llogarisë, duheshin akoma dhe nja tri orë për të arritur në garnizonin e largët.

I sëmuri ishte në fjetinë. Digjej nga ethet. Kolla e ngacmonte vazhdimisht. Shokët vinin herë pas here për ta parë dhe për të dëgjuar mendimin e sanitarit, që nuk i ndahej. Kur panë mjekun midis tyre, ata sikur u lehtësuan nga një barrë që u rëndonte mbi supet.

Mjeku e vizitoi gjatë të sëmurin.

— Është rëndë. Duhet shpënë në spital por... ai nuk mund të ecë në këmbë deri tek autoambulanca.

— E shpiem me barrelë ose me ndonjë karrocë nga të kooperativës, — u hodh përnjëherësh komandanti.

— Po që nevoja, e marrim edhe në shpinë, — thanë ushtarët që u ndodhën pranë.

— Do të laget, pasi rruga është e gjatë. Kjo do t'ia rëndonte më shumë sëmundjen.

Në kapanon pllakosi heshtja. I sëmuri duhej çuar në spital, por gjatë rrugës nuk duhej të lagej, nuk duhej të rraskapitej. Organizmi i tij që dobësuar nga temperatura e lartë, nga infeksioni që kishte. Njerëzit heshtnin dhe mendoheshin.

Heshtjen e theu zëri i mjekut:

— Ku e keni telefonin?

— Në dhomën tjetër.

— Dua të lidhem me komandën. Do të kërkoj të vijë helikopteri... një helikopter për të marrë të sëmurin.

Fytyrat e ushtarëve dhe oficerëve shprehën një

gëzim dhe lehtësim të natyrshëm. Shoku i tyre do të shpëtonte me siguri. Ai do të mjekohej në spital nga mjekë specialistë dhe pas disa ditësh do të kthehej shëndoshë e mirë në gjirin e shokëve të nënrepartit.

Mjeku dhe infermieri u morën me mjekimin e të sëmurit. Sapo mbaruan, një zhurmë motori filloi të dëgjohej. Zhurma afrohej gjithnjë e më tepër.

«Është helikopteri», — mendoj mjeku dhe doli nga fjetorja.

Pas pak mjeti ajror, si një shpend i madh, qëndronte në ajër, mbi fushën e stërvitjes, me helikat e gjata që rrotulloheshin. Nga poshtë mezi shquanin fytyrat e aviatorëve, që përpiqeshin ta ulnin në mes të fushës së stërvitjes.

Një aviator i veshur i tëri me kostum lëkure doli nga kabina. U takua me oficerin dhe me mjekun.

— Ku është i sëmuri?

— Këtu.

— Nisemi!

— Gati!

Ushtarët shikonin të emocionuar helikopterin, aviatorin dhe shokun e tyre të sëmurë. Edhe mjeku e ndiente veten të mallëngjyer. Deshi ta mposhte atë njëqë që i qe mbështjellë në grykë. Po që e kotë. Helikopteri filloi të ngjitej në ajër me një zhurmë shurdhuese. Njerëzit nga fusha e stërvitjes e përslëndesnin me grushtat përtpjetë.

AUTOKOLONA NUK DO TË KALOJË!

Komandanti i batalionit qe një burrë i shkurtër, me ca këmbë të shëndosha që i mbante gjithnjë pak të hapura. Në mbledhje ai nuk dinte të fliste bukur, por i binte çështjes drejt e në mënyrë të prerë. Natyrën e kishte të heshtur e pak të vrazhdë, megjithëse nga shpirti qe i butë.

Një mbrëmje një korrier solli në shtabin e batalionit në copë letër, me anën e së cilës njoftonte komandën se ato ditë do të kalonte në sektorin tonë një autokolonë naziste. Kjo autokolonë duhej të pengohej, që të mos arrinte në destinacionin e duhur.

Komandanti më thirri më vonë dhe më sqaroi se ç'duhej të bëja.

— Po të godasin ballistët nga prapa, si do të vep-rosh?, — më pyeti duke më parë në bebe të syrit. — E? Si do të bësh?

— Do të lë një mitraloz në majë të kodrës. Që andej, si në pëllëmbë të dorës shikohet çdo gjë.

— Mirë e ke!

Në këtë aksion qe ngarkuar të merrte pjesë skuadra që komandoja unë. Komandanti i batalionit u af-rua pranë meje.

— Nisuni në katër të mëngjesit! Një orë rrugë besoj se ju arrin.

— Dhe unë ashtu them, — iu përgjigja.

— Atëherë vëri njerëzit të flenë; bjer edhe vetë!

Të nesërmen, kur u nisëm, ishte akoma natë. Qie-lli pa re, me yje të panumërta. Më tepër nga të gjithë ndriçonte Ylli i Mëngjesit. Ne ecnim njëri pas tjetrit, të zhytur në mugëtirën e ftohtë të natës. Shkonim drejt urës, me urdhër që ta hidhnim atë në erë, që autokolona naziste të mos kalonte andej. Komandanti na e kishte thënë prerë se ushtarët dhe municionet armike nuk duhej të shkonin në destinacionin e tyre.

Ato ditë gjermanët, të ndihmuar nga ballistët, kishin bërë masakra në fshatrat rreth e përçark. Agjentët e tyre përhapnin fjalë se partizanët qenë shfarosur gjatë operacionit dhe tani nuk u dukej as nami e as nishani. Kuptohej vetvetiu se aksioni që do të bënim kishte rëndësi të madhe politike. Njerëzit do të thoshin: «Ne nuk jemi vetëm, ja tek erdhën partizanët».

Ecja në krye të skuadrës dhe kisha ftohtë. Por nuk e jepja veten. Edhe të tjerët me siguri mbërdhnin, por asnjëri nuk bënte zë. Të gjithë mendonim për aksion. Ecnim për një mbi kurrizin e një kodre të lartë nëpër të cilën kisha kaluar kaq herë, kur shërbeja si hyzmeqar në sarajet e Azis beut. Unë i njihja me sy mbyllur ato vende të rrezikshme. Nazistët ne i godisnim nga malet dhe gërçhet. Ato male qenë për ne si kështjella të pamposhtura, që na mbronin orë e çast nga armiku. Ai ndodhej gjithnjë përpara të papriturave, përpara kurtheve që i ngrenim, duke i hequr epërsinë teknike. Ne i detyronim nazistët të luftonin atje ku ishte e favorshme për ne dhe e disfavorshme për ata.

Pas meje vinte Sotiri, ose Tirka, siç e thërrisnim në kompani, një fshatar i ri që nuk kishte shumë kohë që pat ardhur në batalion.

Ngadalësova hapin dhe e prita.

— Tirkë!, — i fola me zë të ulët.

— Urdhëro!

— Ke ftohtë?

— Jo.

Tirka qe veshur me një pallto të vjetër e tërë arna. Maliheri i rrinte mbi sup me grykën lart.

Një qen lehu nga larg; një tjetër iu përgjigj me një të lehur të ngjirur. Poshtë, nën këmbët tona, rridhte lumi i rrëmbyer e me shkumë. «Si ky lumë i rrëmbyer po shkojmë edhe ne në aksion për të ndaluar autokolonën armike të kalojë në këto anë», — thashë me vete.

Duke shkuar në drejtim të urës, skuadra jonë mund të ndeshej me nazistët që e ruanin. Ata rrinin në një bunker, fare afër urës, të armatosur deri në dhëmbë, me mitralozin që shikonte ftohtë nga xhadeja, nga lumi. Frëngjia ishte e thellë dhe e ngushtë, si një sy përbindshë, që të kallte datën. Mbrapa asaj frëngjie rrinin njerëz të huaj, të trembur, të strukur. Ndoshta ndonjëri prej tyre në atë çast i binte sazes së gojës, ndërsa tjetri këndote me zë të ashpër «Lili Marlenin». Ne shkonim drejt tyre të hidhnim urën në erë, duke qenë shumë të qartë përse luftonim. Dhe pikërisht kjo ndjenjë na ngrëhte zemrat, na bënte të mos e ndienim të ftohtët e shkurtit.

— Kujdes, kalojmë lumin!, — u dëgjua zëri i një partizani.

Fjalët u përsëritën gojë më gojë. Armiku që nga ura kontrollonte rrugën, lumin dhe tërë grykën me anë të një projektori të fuqishëm që ishte mbi par-

makët e urës. Shiriti i gjerë i dritës që lëshonte projektori kalonte si një vetëtimë nëpër faqet e kodrës, zbriste nëpër ara dhe pastaj rrëshqiste mbi shtratin e lumit. Ai shponte si një turjelë errësirën e natës e ndriçonte çatitë prej kashte të kasolleve të varfra.

Këmbët na u zhytën në ujë. Ndjeva ujin e ftohtë që u ngjit deri në gju dhe më rrëqethi tërë trupin. Që nga mesi i lumit dalluam harqet e urës, ndërsa në njërin anë të saj nxinte si një xhungë e errët bun-keri me frengjinë e ngushtë.

— «Kini mendjen nga ajo djallo dritë, kur të kaloni lumin», — na porositi komandanti i batalionit para se të niseshim.

Atë çast u duk shiriti i dritës së projektorit duke ndriçuar shumë qartë ullinjtë në faqen e kodrës, një rrugë të ngushtë hajvanësh, ferrat dhe çdo gjë tjetër që zinte përpara.

— Tani do të na zbulojnë, — tha një partizan.

— Mbylle gojën ti atje!, — dëgjova që thirri Tirka me inat.

— Shokë, mbani gjakftohtësinë!, — u fola me zë të qetë.

Drita e fortë e projektorit u ul nga faqja e kodrës, zbriti në fushë duke ndriçuar kasollet e heshtura me çati prej kashte, plepat e gjatë e të zhveshur. Ai shiriti i shndritshëm po na afrohej ngadalë, kërcënues. Mund të qemë larg nga ura jo më tepër se pesëqind a gjashtëqind metra. Po sikur të na zbulonin në mes të ujit, duke kapërcyer lumin? Drita vazhdimisht i afrohej buzës së lumit. Ja tek e preku. Tani ajo po përparonte drejt nesh, centimetër për centimetër, duke shqyer errësirën e natës. Ç'të bëja? Ç'urdhër të jepja në ato çaste të vështira? Koha nuk priste. Zemra më rrihte fort, sikur donte të më dilte nga kraharori.

— Shokë! Zhytuni deri në fyt! Tirkë ki kujdes mos laget fitili!

Kaq munda të them. Pastaj çdo gjë u bë e bardhë. Një bardhësi verbuese na mbështolli të tërë. Nuk shihja asgjë. Prita që në drejtimin tonë të vinte një breshëri predhash. Ndoshta që nga frëngjia, sy të zemëruar nazistësh na vështronin e na tregonin me gisht. Sa kohë zgjati pritja? Një sekondë apo më tepër? Pastaj pllakosi errësira. Si më parë, shiriti i dritës lëvizti pas nesh, kapërceu lumin dhe iu ngjiti së përjetës nga ana tjetër e luginës.

— Tirkë! Tirkë ore!

— Urdhëro!

— Më duket se e hodhëm.

— Ashtu më ngjan dhe mua.

Pastaj ngrita zërin që të dëgjonin dhe të tjerët:

— O burrani të nxitojmë dhe të dalim shpejt nga lumi...

— Shoku komandant!

— Tirkë, ti je?

— Të nisemi për nënë urë me Ismailin?

— Nisuni!...

Mitralierin e dërgova në majë të kodrës. Le të rrinte atje për çdo të papritur.

Tirka dhe Ismaili iu afruan xhadesë dhe urës këmba-doras, pa zhurmë. Roja naziste vazhdonte të ecte me jakën e kapotës së murme ngritur lart, duke përplasur këmbët nga të ftohtët. Koka gati e tëra i qe futur nën helmetë. A do ta kapërcenin dot rrugën, pa u diktuar nga roja, të dy partizanët? Në kohën që roja i ktheu shpinën urës, një siluetë kapërceu shpejt rrugën dhe u hodhë matanë. Ishte Tirka. Mora frymë lirisht. Po Ismaili pse nuk vepronte? A do të kalonte dhe ai me kaq shkathtësi sa Tirka? Një gur u rroku-

llis poshtë me zhurmë. Roja naziste u kthye me rrëmbim dhe qëndroi në vend, me automatikun gati për qitje. Heshtje. Ne e morëm rojen në shenjë dhe prisnim. Ismaili ishte shtrirë mbi xhade, rrafsh me tokën. Çastet ishin plot ankth. Gishtat i mbanim te këmbëza, gati për të shtënë. Roja priste se mos zhurma përsëritej edhe një herë, por era nuk e linte të dëgjonte mirë. Atëherë, i mërzhitur u kthye nga bunkeri dhe nisi të ecte. Atë çast Ismaili, duke u zvarisur, kapërceu në anën tjetër të rrugës. Përsëri morëm frymë lirisht.

Nata sapo nisi të thyhej.

Në fshat këndesat filluan të këndonin njëri pas tjetrit. Vumë re se dy siluetat u larguan. Ne prisnim, me vështrimin ngulur tek ura. Po ura nuk po hidhej në erë. Çfarë kishtë ndodhur? Ç'po bënin Tirka me Ismailin atje poshtë? Mos vallë nuk u ndizej fitili? «Dreq o punë, — thashë me vete, — edhe kjo na duhej».

Pa e mbaruar mirë mendimin, u dëgjua një gjëmim i tmerrshëm që tronditi tërë luginën. Ura u këput në mes, sikur të ishte një lojë prej kartoni, dhe u shemb në lumë me një potere të llahtarshme. Pastaj një re pluhuri si në të bardhë u ngrit përpjetë, drejt qiellit.

— A më ju lumtë, o shokë, — thirrën partizanët pa u përmbajtur dot nga gëzimi.

Autokolona armike nuk do të kalonte. Ura që këputur në mes sikur t'i kishte rënë njeri me një sëpatë gjigante. Roja naziste që përmbysur në njërin anë i vdekur. Disa hapa më tutje qëndronte helmata si një gojë e çapëlyer. Përtej, në anën tjetër të bregut, ku ishte bunkeri, gjermanët vazhdonin të shtinin. Mbi parmakët e shtrembëruar e të këputur të urës varej projektori me xhamin të bërë copë-copë.

ATO DITË LUFTE

Ishtë ditë vere kur dola nga burgu. Dielli me rrezet e tij të arta digjte tokën që avullonte. Ai qe ngritur në horizont, ku rrëshqisnin lehtë disa re të bardha, të shndritshme si argjendi, aq sa nuk mund t'i vështroje dot. Më kishte marrë malli për vendin ku isha rritur e qeshë bërë burrë: për malet, për pyllin e madh me pisha dhe për shtëpitë e fshatit. Po bëja gjashtë muaj që isha larguar nga njerëzit e shtëpisë: nga gruaja, nga nëna dhe nga dy fëmijët e vegjël që prisnin vetëm për të ngrënë. Po si kisha rënë në burg? Kjo kishte ndodhur në prag të dimrit . . .

. . . Era frynte si e marrë. Kopshti i zhveshur dukej sikur qante. Nga pemët dhe nga çatia e kasolles rridhnin pikat e shiut si lotë të trishtuar. Degët e lagura të kumbullës përplaseshin pas kanateve të dritares dhe ndillnin pikëllim. Në të rrallë dëgjohej së largu ndonjë gjëmim që mezi arrinte në kasolle.

Shpirtin ma kishte mbytur dëshpërimi. Bereqeti qe mbaruar. Ndieja vështrimin e nënës, të gruas dhe të fëmijëve që më përcëllonte si prush. Të gjithë donin të hanin. Po ç'të bëja? Fqinjët ishin të rraskapitur më keq se ne. E përse ta humbisja fjalën kot te Resuli,

fqinji ynë? Ndoshta ai do të qe edhe më keq. Mendova ta shisja dhinë e vetme. Vajta në katua. Ajo rrinte shtrirë mbi barin e përzier me baltë dhe përtypej e qetë. Pa luajtur nga vendi më hodhi një vështrim me ata sytë e njomur dhe dukej sikur më thoshte: «E di që i ke punët si mos më keq, por të paktën unë të jap qumësht për fëmijët». Dola me nxitim nga katoi dhe zbrita tatëpjetë për në qendër të fshatit. Këmbët sikur ecnin vetë. Kur u ndala e kuptova se kisha qëndruar përpara shtëpisë së Malo agait.. Kapërceva oborrin e mbushur me rosa dhe ndalova te shkallët prej guri.

Që nga vendi dëgjova zërin e agait tek bërtiste me të madhe:

— Je edepsëz, o Lame. Ma bërë punën me hile. Sa kisha nevojë m'u lute për një copë bukë dhe unë të dhashë. Kurse tani më kërkon dhe para...

— Nuk do të më paguash për punën që të kam bërë?, — pyeste një zë i revoltuar.

— Oj! Pa shiko! Do dhe para, se pak i dhashë dy shinikë me misër. Thyej qafën!

— Do të vete të ankohe me kryetari i komunës...

Plasi një e qeshur. Malo agai s'mbahej dot.

— Do të vesh në komunë? Ec, ec, o i gjorë, se do të ta qajë hallin kryetari...

— Haram të qoftë djersa ime, o Malo!

U përplas një derë. Pas pak zbriti nëpër shkallë xha Lamja, një burrë i dobët e i gjatë, me nofullo të dala. Edhe ai ishte njeri i këputur në fshatin tonë, me një qerre kalamanj, që mezi i mbante me bukë thatë. Zbriti shkallët me nxitim me këmbët e tij të holla e të palara që mezi i mbulohehin nga një palë shallvare të çara vende-vende. Fshatari më hodhi një

vështrim të dëshpëruar dhe, duke sharë nëpër gojë
soj e sorrollopin e Malo agait, u largua me çapa të
mëdhenj. Opingat e tij të çara shkelnin pa kujdes
pellgjet e ujit në mes të oborrit dhe glasat e rosave
përtace. Në fyt m'u mbloodh një lëmsh. Ngjita shkallët
dhe u gjenda përpara Malo agait:

— Ah! Ti qenke, o Petrit?

— Unë jam, aga.

— Ç'të solli këndeje nga shtëpia ime?

Maloja më shpoi me vështrimin e tij të egër. Po-
shtë syve i qenë fryrë dy qeska të vogla sikur t'i kish-
te mbushur me ujë.

— Përse ke ardhur?, — më pyeti përsëri.

— Nevoja më solli, zoti Malo.

— Ti vetëm për nevojë vjen.

— Nga e keqja.

— Fol!

Përcolla pështymën dhe pasi u qetësova fola:

— Zoti Malo, më jep ca misër për nja tre muaj.

— Pse, të kam borxh?

— Larg qoftë! I kam fëmijët pa bukë.

— Kështu më the dhe vjet.

— Ta lava borxhin, aga.

— Me pesëqind belara . . .

S'dija çfarë t'i thosha Malo agait. Ai më shponte
gjithnjë me atë vështrimin e tij të rreptë, sikur don-
te të lexonte mendimet e mia brenda në kokë.

— Je njeri naiv ti, Petrit. Kam dëgjuar se je plek-
sur me ata të Nacionalçlirimtares. Ama, kur mbetesh
pa misër, vjen tek unë.

— Por . . .

— Çfarë, por?

U mata të flisja, po Maloja s'më la.

— More dëgjomë mua: ti thua të të ushqej që të

ngrihesh një ditë kundër meje. Pse, ç'më bëre ti mua? Tutkun? Njeri që s'kam haber nga politika?

Të dy cepat e buzëve i kishin zënë një cipë të bardhë e të hollë Ai u koll me forcë, mblodhi buzët e me një lëvizje të kokës pështyu nga dritarja.

— Të thirra një ditë ty, Dalipin, Resulin dhe ca të tjerë që të prisnim kuestorin dhe prefektin kur erdhën në fshat, po nuk u dukët. Tani hip këtu të shohësh Stambollin!

Maloja më tregoi gishin e madh të dorës së djathtë, një gisht të shtrembër e gjithë xhunga.

— Ik tani! S'kam kohë të merrem me ty tërë ditën.

— Po të duash vij, punoj një ditë në javë si argat te ti.

— Ashtu më tha dhe Lamja, pastaj e ktheu pllakën, deshi para.

Sytë e Malos u bënë më të rreptë. Qeskat nën sy sikur iu frynë edhe më nga ligësia.

— Keni hapur fjalë që të mos paguhen të dhjetat, taksat. Këto gjëra ju mëson ai çuni me pardesy që vjen nga qyteti, apo jo? Ti pandeh se unë nuk di gjë.

Si u ngrit në këmbë, dhe duke më treguar derën me dorën që i dridhej nga zemërimi, bërtiti:

— Qërohu!

— Nuk iki!, — iu përgjigja nga inati.

— Pa shiko! Edhe në shtëpinë time kërkon të mos më bindesh!

— Je i lig, Malo aga.

— Ik, të them, se do të lajmëroj postëkomandën!

Njëra faqe i dridhej sikur t'ia përshkonte korenti. Maloja m'u afrua dhe më shtyu me duar. M'u errën

sytë. Ai po më dëbonte si një qen të ngordhur. Nuk mbaj mend se ç'bëra. Vetëm pak më vonë kuptova se e kisha zënë Malon për fyti dhe ia përplasa kokën pas murit. Ai zgurdullonte sytë dhe thërriste:

— I poshtër! Do të ma paguash!

E shemba mbi dysHEME dhe ika me vrap përmes pyllit. Por të nesërmen xhandarët e postëkomandës më zunë dhe më futën në burg. Atje vërtet bëra gjashtë muaj, por mësova shumë gjëra. Nga një punëtor, të cilit i thërrisnin shoku Miti, mora vesh se në botë të shfrytëzuarit punojnë për një pakicë, se toka nuk u takon bejlerëve dhe agallarëve, por atyre që e punojnë. Po të gjitha këto padrejtësira rregullohen kur ne fshatarët e varfër të bashkohemi me punëtorët në luftë kundër fashizmit dhe shfrytëzuesve. Në vendin tonë, me krijimin e Partisë Komuniste, lufta do të zhvillohej nga dita në ditë.

Po i afrohesha shtëpisë, një kasolleje të anuar në një krah, gati për t'u shembur. Zemra më rrahu fort. Murroja, qeni i shtëpisë, filloi të lihte. Më kishte njuhur dhe s'përmbahej nga gëzimi kafsha e gjorë. Më hidhte të dyja këmbët e para mbi gjoks, mundohej të më lëpinte me gjuhën e saj të hollë e të lagur, pastaj më vërtitej nëpër këmbë duke tundur bishtin.

Ime shoqe doli në prag të derës dhe shtangu. Me sa dukej nuk po u besonte syve. Pastaj thirri, gati si e trembur:

— Nëno, po vjen Petriti!

— Kush moj?, — u dëgjua zëri i nënës që brenda.

— Dil, se erdhi Petriti.

Nëna më mori kokën në gji, ma shtrëngonte dhe ndieja buzët e saj nëpër flokët e mi të ashpër e të palarë. Ime shoqe, Teuta, qëndronte në këmbë pranë

meje dhe s'dinte ç'të bënte me përparësen e arnuar: herë e mbliidhte shuk ndër duar, herë e lëshonte të binte deri nën gju. Fëmijët i qenë ngjitur pas fundit dhe nuk i shqiteshin. Me sytë e tyre të vegjël e të pajshëm më shikonin shtrembër, pak si të trembur, sikur të isha ndonjë i huaj që po u prishja qetësinë ashtu papritur.

— Babi, mor bir, — i thoshte ajo më të madhit, Skënderit, duke e shtyrë nga unë. — Puthe babin!

Po djali s'më afrohej.

— Yt atë, mor shpirt, — i fliste ime shoqe e ngashëryer.

Fëmija nuk i ndahej.

— Të kanë harruar, more bir.

— Do të afrohen ca e nga ca, nëno.

E mora më të voglin në krah dhe e putha në kokë, në sy e në faqe me kujdes se mos e shpoja me qimet e mjekrës sime të parruar prej disa ditësh. Era e foshnjes më gudulisi hundën e më qetësoi deri diku.

— Nga erdhe? — më pyeti nëna

— Vajta u paraqita në postkomandë.

— Pse?

— Ashtu është rregull.

— Mos të të dënojnë prapë?

— Një herë e hëngra unë atë tek...

— Me qeverinë, me ujin e me zjarrin nuk bëhet shaka, mor bir.

— Janë të tjera kohë tani, moj nënë.

— Kohët janë të vështira, i huaji është gjithnjë i lig.

— Ne fakir fukaraja për taksirafte jemi, — foli ime shoqe. — Po të mos ishte zënë me Malo aganë, s'do të kishte pësuar gjë e ne s'do të kishim vuajtur.

Nëna u koll.

— Hoqëm të zitë e ullirit, po njeriu qenkerka më i fortë se hekuri. Kush e dëgjon fjalën tonë? Edhe drejtësia gjithmonë andej është, nga të pasurit...

Teuta më hodhi një vështrim dhe foli duke rregulluar përparësen:

— Neve s'na mbetet gjë tjetër veçse të ulim kokën si më të vegjël që jemi.

— S'është ashtu!, — ia preva fjalën.

Të dyja gratë më vështruan me kureshtje.

— Këtu është e keqja, — vazhdova unë, — se ne gjithmonë kemi kërrusur kokën.

— Do të na prishin, mor bir.

— Këtë e thotë Malo agai me shokët e tij.

— Po ti si thua? Nuk mund ta djegin fshatin njerëzit e Duçes?

U mendova pak, pastaj u përgjigja:

— Edhe mundet, nënë; fashistëve u vjen për dore çdo gjë. Veçse ne do të luftojmë.

— Kush ne?

— Ne, fakir fukaraja.

— Korba!

— Te ne është krijuar Partia Komuniste.

— Nga i di të gjitha këto?

— I mësova në burg.

Që të nesërmen fillova të punoja tokën. Parmenda çante dheun e butë të arës dhe aroma e plisave që përmbyseshin anash më futej thellë në mushkëri. Një gëzim i çuditshëm ma përshkonte qenien tej e përtej tek bridhja pas qeve në arë. Një gëzim të këtillë mund ta kuptojë vetëm fshatari që punon tokën. Nga pas më ndiqte gruaja me një shportë në dorë, duke hedhur në brazdë farën, ndërsa nën hijen e kumbullës gjatore, buzë arës, Skënderi luante me Murron

leshator. Ditët qenë të vakëta, bari qe tharë dhe po nxihej në mullar. Natyra rreth e përçark dukej e për-hime. Tek po pushoja nën hije, vura re se Resuli, fqinji ynë, po kapërcente gardhin dhe po vinte drejt meje.

— Mirë se të gjeta, Petrit!

— Mirë se vjen, Resul!

U përshëndetëm sipas zakonit fshatar. I vura përpara kutinë e duhanit dhe filluam të dridhnim nga një cigare. Ke parë ti që ky duhani megjithëse helm, i jep vrull muhabetit?

Me Resulin na lidhte shoqëria që në fëmijni. Ai qe nja dy vjet më i madh se unë, qe njeri i guximshëm, që nuk i nënshtrohej kollaj njeriu. Folëm bashkë për hallet e jetës, që bëhej çdo ditë më e rëndë, për tagrambledhësit që s'na linin rehat dhe për ushtarët e Duçes që kishin hapur fushimin nën hijen e një ullishte pranë fshatit tonë dhe nuk i linin gratë të mbushnin ujë në krua.

— Si e kam Malo aganë?, — e pyeta Resulin.

— Po ngjallet si një derrkuc. Mirë ia bëre qerratait, por ç'e do që s'e vrave shushunjën.

Buzëqesha. Thitha cigaren. Dhe mora fjalën përsëri:

— Kur qeshë në burg, njoha një punëtor. Nga ai mësova shumë gjëra, Resul. Bisedoja me të pothuajse përditë. Një herë i thashë dhe unë kështu si ti. E di ç'më tha? «Nuk është ajo rruga që duhet të ndjekim. Ne duhet të bashkohemi, të organizohemi dhe të kemi në krye një parti që të na udhëheqë. Po të qëndrojmë një e nga një, të veçuar, ata, borgjezët, na thyejnë. Me ta janë xhandarmëria ushtria, fashizmi».

Resuli më dëgjonte me vëmendje.

— Mirë të ka thënë.

— Po, se po të jemi bashkë, do të jemi më të fortë dhe do t'u bëjmë ballë pa frikë.

— Përse e kishin vënë në burg atë?

— E quanin njeri të rrezikshëm, pse kishte mendime të këtilla.

Resuli u mendua, pastaj tha me bindje sikur të qe i sigurtë:

— Do të ketë qenë komunist.

E përcolla Resulin deri te gardhi. Ai qëndroi përballë meje dhe më vuri një dorë mbi sup:

— Në darkë do të mblidhemi në shtëpinë e Namikut; më thanë të vish dhe ti.

— Kush të tha?

— Një shok i Partisë...

— Ç'do të bëjmë atje?

— Do të ngremë këshillin nacionalçlirimtar të fshatit.

— Do të vij.

Shtrënguam duart dhe u ndamë.

Nata kishte pllakosur nga të katër anët e fshatit, kur arritëm në shtëpinë e Namikut. Dhoma qe mbushur plot me njerëz. Tymi i duhanit qe aq i dendur, sa të jepte përshtypjen e një mjegulle të hollë që ka qëndruar rrëzë një kodre. Aty gjeta Namikun, Resulin, Lamën dhe disa fshatarë të varfër sa dhe unë. Por aty pashë edhe dyqanxhiun e fshatit me Malo aganë. Ky qe ngjallur akoma më shumë, ndërsa qeskat nën sy sikur i qenë fryrë edhe më tepër. «Po ky ç'kërkon këtu?», — mendova me vete. Mbi të gjitha më tërhoqi vëmendjen një djalë i ri, me mustaqe të holla e me një kasketë në kokë që bisedonte me Resulin dhe me Namikun. Dukej që atje tutje se ishte nga qyteti. Ai

e mori fjalën i pari, duke na bërë një përshkrim të situatës politike të brendshme e të jashtme.

Pasi u koll, vazhdoi përsëri:

— Ka ardhur koha të krijojmë Frontin e përbashkët Nacionalçlirimtar. Në këtë mbledhje do të formojmë këshillin nacionalçlirimtar të fshatit, ku duhet të marrin pjesë përfaqësuesit më luftarakë të të gjitha rrymave politike në popull dhe në radhë të parë punëtorët e fshatarët që janë për luftën vendimtare kundër okupatorit. Me anën e këtyre organeve do të mobilizohet i tërë populli në kryengritjen e përgjithshme nacionalçlirimtare. Të gjithë duhet të ngrihemi në këmbë për të luftuar fashizmin. Si mund të durojmë ne të shohim nënat, motrat dhe vajzat tona të mos kenë guxim të mbushin ujë në kroin e fshatit, sepse i ngacmojnë këmishëzinjtë e Duçes? Ne nuk jemi vetëm. Me ne janë të gjithë popujt e shtypur. Kemi një Parti të fortë në krye dhe një popull trim. A mund të frikësohemi ne nga milicët dhe nga një grusht tradhtarësh?

Fjalët e tij më vinin pas zemrës. Ai fliste shumë qartë dhe me një gjuhë që e kuptoja për bukuri. Afrova fytyrën pranë veshit të Resultit dhe e pyeta ngadalë:

— Kush është ky?

— Është ai shoku i Partisë.

Në dhomë pllakosi heshtja. Njerëzit pinin duhan e mendoheshin. I shikoja me vëmendje gjithë ato fytyra që i njihja mirë. Më të vjetërve rrudhat në ballë u qenë bërë më të thella, kurse Malo agai rrinte si mbi gjemba. Po dyqanxhiu me kokën tullace e me vështrim prej budallai ç'mendonte vallë?

Në dyqanin e tij ai mbante raki dhe verë. Fshatarët, të lodhur e të rraskapitur nga punët e bujqë-

sisë, të dëshpëruar, ktheheshin në dyqanin e tij dhe mbysnin zemërimin në gotat e rakisë. Në darkë ata vinin në shtëpi të trullosur e të dehur.

Për çudinë time, fjalën e mori dyqanxhiu. Në fillim u koll pak, pastaj tha me gjysmë zëri:

— Unë kujtova se më kishit thirrur në ndonjë davet, se ta dija që ishte mbledhje për të bërë politikë, — dyqanxhiu u koll përsëri, — as që do të vija. Kam grua dhe fëmijë, prandaj mos më ngatërroni në këto punë!

Pastaj e kërkoi fjalën Resuli.

— Ne do të veprojmë ashtu si tha shoku që foli tani. Do ta ngremë këshillin nacionalçlirimtar. Ne e urrejmë pushtuesin, fashizmin, por që të luftojmë duhet të bashkojmë tërë popullin.

Namiku, si më i vjetër, foli ngadalë por shkoqur:

— Mor shok, si do të jetë qeveria që do të ngreni ju? A do të fitojnë gjë njerëzit e varfër? Këtë na thuaj. Ne s'i trembemi fashizmit dhe do të rrëmbejmë armët kur të jetë nevoja, por ama do patur kujdes se mos na tradhtojnë njerëzit e parisë. Gjithnjë kemi luftuar, por asnjëherë nuk kemi fituar.

Djali i ri me mustaqe të holla buzëqeshi:

— Luftën tonë, xha Namik, nuk e udhëheq paria, por Partia jonë. Sa për qeverinë, atë do ta zgjedhë populli në mënyrë demokratike. Ne sot këtu do të zgjedhim këshillin nacionalçlirimtar që do të ndihmojë luftën e popullit, fukarenjtë dhe nuk jemi mbledhur për të zgjidhur kryepleqësinë, që janë vegla të bejlerëve dhe agallarëve në fshat.

Malo agai nuk u përmbajt dot nga zemërimi. Në atë çast m'u duk sikur qeskat nën sy iu frynë më tepër, gati të pëlçisnin.

— Ç'janë këto vendime që merrka kjo partia juaj,

more djalë?, — foli ai me zërin e tij të ngjirur. — Ju doni të luftoni kundër një fuqie të madhe me ca dyfeqe të ndryshkura. Ç'mund të bëjmë ne me një popull fukara kundër Italisë? Apo doni të na djegin shtëpitë, mallin dhe gjënë e gjallë e të mbetemi me gisht në gojë, si ky Lamja që është këtu. Ne duhet të presim; kur të ngrihen gjithë të tjerët, atëherë do të çohemi dhe ne.

Kur dëgjova Malo aganë që fliste kështu, më hipi gjaku në kokë. Do të desha ta zija atë gjarpër për gryke e ta flakja jashtë nga dritarja. Por ç'e do se nuk ishte vendi.

— Ne nuk do të presim, zoti Malo, — fola me zemërim. — Duhet ta kemi për turp që të rrimë nën zgjedhën e të huajve. Në vitin 1920 Italinë e hodhëm në det, dhe ata që luftuan atëherë nuk qenë më shumë se ne, kurse tani ne jemi më shumë, dhe në krye kemi Partinë. Ata që do të luftojnë kundër nesh janë fashistë, xhandarë e milicë, pa një farë ideali, kurse ne luftojmë për lirinë e Shqipërisë. Në qoftë se duam të shpëtojmë popullin nga turpi e çnderimi, ka vetëm një rrugë: të luftojmë. Vërtet ne jemi fukarenj, por kurrë nuk do të pranojmë t'ia shtrojmë kurrizin armikut.

Shoku i Partisë më shikonte në sy dhe tundte kokën herë pas here në shenjë aprovimi. Malo agai vrenjti vetullat dhe shikonte poshtë në dysheme. Njëra faqe i dridhej nga nervozizmi, ashtu si atëherë kur e kisha zënë për fyti e ia përplasa kokën pas murit.

Xha Nikoja nuk kishte folur akoma. Ndoshta s'kishte ndër mend të thoshte ndonjë gjë, megjithëse ne e mbanim në fshat për njeriun më të urtë e më të mençur. E vështrova në sy atë plak me flokë e vetulla të thinjura. Ç'mendonte vallë? Nga do të anonte

ai? Nga ne, apo nga armiqtë? Më në fund kërkoi fjalën:

— Ç'janë këto gjëra që dëgjoj këtu në mbledhje? Mos na digjet shtëpia, malli, apo gjëja e gjallë. Nderi i atdheut nuk zëvendësohet me mall e me flori. Ata që kanë frikë le ta thonë hapur, si burrat, dhe do të bëjnë mirë të largohen nga radhët tona. Ne të gjithë do të bëjmë ashtu siç thotë ky djali këtu në mbledhje.

U larguam vonë nga shtëpia e Namikut. Atë natë mezi më zuri gjumi. Më patën zgjedhur anëtar të këshillit dhe ndieja se kisha marrë mbi vete një barrë të rëndë.

Disa muaj më vonë dola partizan.

Çeta partizane e krahinës sonë u rrit nga dita në ditë. Në radhët e saj erdhën punëtorë nga qyteti, fshatarë, studentë. Populli na donte, na përkrahte, duke hequr edhe bukën e gojës për të na mbajtur. Atje mësova të përdorja mavzerin, pushkën e shkurtër italiane që bënte flakë të madhe. Në mal gjithashtu mësova, nga një 'student shkolle, të lexoja dhe të shkruaja. Dalngadalë mendja po më ndriçohej nga errësira e padija.

Ato ditë kishin ardhur mjaft forca armike e tradhtare në zonën tonë. Mjaft agjentë u shpërndanë nëpër fshatra, duke kërcënuar njerëzit që të mos na strehonin dhe të mos na jepnin ushqime ne «rebelëve» dhe «ngatërrestarëve». Ata që do të kapeshin do të internoheshin nëpër kampe, do të burgoseshin ose do t'u sekuestrohej pasuria.

Lufta u ndez në afërsi të fshatit tim. Shikoja fashistët se si rrëshqisnin nëpër faqet e kodrës duke u fshehur midis gurëve. Ata thërrisnin dhe shanin në gjuhën e tyre. Mitralozi filloi të qiste në drejtimin to-

në. Mbi faqet e kodrës u ngrit një shirit i gjatë pluhuri. Së bashku me Resulin u shtrimë barkas dhe u zvarisëm deri te një shkëmb. Fletët e pemëve u shkundën me forcë, sikur të kishte ndonjë erë të madhe. Plumbat fishkëllenin në ajër, ndërsa jehona përsëriste në fund të luginës rrapëllimën shurdhuese të mitra-lozit fashist.

Të shtënat pushuan. Ngrita kokën dhe pashë se në fshat po digjeshin shtëpitë.

— Resul! Shiko se çfarë po bëjnë?

— Të poshtrit! Po na djegin!

Nga thellësia filloi të gjuante artileria fashiste. Pylli gumëzhinte, delet e trembura blegërinin si të hallakatura nga tmerri i shpërthimeve. Vështrova dhe një herë në drejtim të fshatit. Zemra më theri.

Gjatë natës bëmë pozicionet dhe u përgatitëm për kundërsulm. Kur feksi drita mbi pozicionet tona, dëgjova zërin e komisarit të çetës që dha kushtrimin:

— Përpara partizanë!

— T'i zemë të gjallë!


Të thirrurat përziheshin me të shtënat e pushkëve, të bombave të dorës dhe të mitra-lozit.

— Resul, ua punuam bukur!

Por nuk mora përgjigje.

— Resul, armiku po tërhiqet, — i fola përsëri.

Shoku im kishte rënë me kokën mbi pushkë dhe nuk lëvizte. Plumbi e kishte marrë mu në ballë. Die-lli majë malit dërgonte rrezet plot shkëlqim mbi kryet e tij. Me zor të madh mbajta lotët, që më përcëllonin sytë. Poshtë në rrugë dukeshin akoma disa ushtarë fashistë që vraponin me të katra për të shpëtuar kokën. Po atë ditë u dëbuan nga komuna me sulm të gjitha mbeturinat fashiste e balliste. Një pjesë i zumë robër.



Në luftë e sipër vajta nga shtëpia ime që po digjej. Tymi dilte nga dritaret e nxira, nga çatia. Në oborr qenë flakur ca stola të vjetër, sofa e bukës, dhe djepi i fëmijëve i rrokullisur në një krahë.

Sheshi në qendër të komunës që mbushur me njerëz të ardhur nga fshatrat aty pranë. Këngët partizane buçisnin nga të katër anët. Disku i madh i diearit që ngritur mbi malet dhe derdhte mbi ne ngroh-

tësinë e tij. Mbi ndërtesën e komunës valonte krenar flamuri ynë i kuq.

Në një cep të sheshit qenë strukur të trembur robërit fashistë dhe disa ballistë. Midis tyre dallova fytyrën çehreverdhe të Malo agait, me ato fluckat e fryra nën sy. U vërsula tek ai.

— Qen, — i thirra me sa fuqi pata.

Ngrita kondakun e pushkës për ta qëlluar në kokë. Ai qëndronte poshtë nën këmbët e mia si një mi i ngordhur.

Dikush më zuri armën.

— Lëre kërmën! Do të japë llogari përpara popullit.

Ishte shoku i Partisë, komisari i çetës sonë.

MIDIS SHOKËSH

Me të marrë urdhër nga komandant Besniku, ushtar Luan Sota, u përgatit për të shkuar në shtabin e repartit. Rregulloi uniformën dhe, kur u bind se nuk i mungonte gjë, u nis menjëherë. Luani që fshatar. Para çlirimit, familja e tij punonte e robtohej në tokën e agait të fshatit. Aty ku shgërryeshin bagëtitë e agait, nëna i këndoi ninananat e para. Më vonë, në kasollen gjysmë të rënuar, nëna e tij filloi t'u lidhte plagët partizanëve me yllin e kuq në ballë, me të cilët u bashkua edhe i ati. Pas çlirimit, kur u bë Reforma Agrare, në shtëpinë e tij njerëzit thanë: «Kjo është toka jonë, tani do të punojmë për vete dhe për fëmijët tanë».

Në ushtri Luani e ndiente veten mirë! Javët e para e pati ca vështirë, po pastaj nisi të mësohej. U afrua me shokët, me oficerët dhe nënoficerët.

Ditët dhe muajt rrodhën shpejt. Druajtja e ditëve të para pothuaj se u zhduk plotësisht. Nuk ishte më Luani i parë, pak i ngathët e që mezi zbërthente pjesët e karabinës. Ai tanimë ecte me hapin e tij prej ushtari të mësuar në fushën e stërvitjes, në poligonin e qitjes, në alarmet e netve pus të zeza, edhe kur shiu binte me shtambë, kur kapota e ngrirë përplasej pas

kërcinjve të lodhur dhe dëbora mbulonte gjithë natyrën.

Ndokush mendon se ushtari mund të bëjë heroizëm vetëm në kohë lufte, ndërsa në stërvitje ai kryen vetëm detyrën. Dhe asgjë më tepër. Por ushtar Luani mendonte ndryshe. Ai thoshte se gjithmonë ka vend për trimëri, në qitje, në marshim, në zbatimin e çdo urdhri.

Ai e ndien veten krenar që është artilier. Tani Luani ia njeh të gjitha të fshehtat armës së tij të dashur. Është numëror në topin e parë dhe mund të kryejë deri në tri detyra, numëror, shenjues dhe prurës. Të gjithë ushtarët e topit të parë të komanduar nga nënoficer Agroni janë në gjendje të kryejnë disa detyra. Edhe topi që komandohet nga agronomi i kooperativës nuk është më pas tyre.

Besnik Lela atë mbrëmje nuk bëri gjumë të qetë. Ai u çua dy tri herë dhe u afrua te dritarja. Dëbora kishte filluar të binte me flokë të mëdhenj e qe shtruar në tokë si një çarçaf i bardhë i madh pa anë e pa fund. Oficeri u shqetësua, jo për veten e tij, po për ushtarët, për teknikën. Nata bëhej gjithmonë më e ftohtë, kurse dëbora as që kishte ndër mend të pushonte. Pak më tutje nga ndërtesat e garnizonit, ngrihej shpati i malit shkëmbor, i prerë si me thikë. Ai qe ngarkuar rëndë me dëborë.

«Po sikur të shkasë tërë ajo dëborë e të na bjerë sipër si ortek?». Ky mendim i lindi menjëherë. Besniku u shqetësua edhe më tepër. Telefoni nuk punonte. Ai nuk kishte lidhje me komandën e repartit. As me kooperativën. Pesha e dëborës, me sa dukej, do të kishte këputur linjën në ndonjë vend.

Garnizoni i vogël izolohej shpeshherë në dimër. Komanda e repartit e kishte furnizuar me kohë me të gjitha sendet e nevojshme. Besniku thirri kujdestarin.

— Duhet t'u japim edhe një batanije tjetër ushtarëve. Natën bën ftohtë, — tha ai.

Kujdestar Astriti doli për të zbatuar urdhrin. Besniku mbeti vetëm në dhomë. Nga dritarja shikonte shpatin e malit të ngarkuar me dëborë dhe mendimet shqetësuese nuk i ndaheshin.

Po ushtar Luan Sota si i kishte punët? Sa mirë sikur të mos qe nisur! Nga ta merrte në telefon e t'ia thoshte këtë? Komandant Besniku e njihte mirë ushtarin. Ai nuk do ta thyente urdhrin dhe urdhri që i kishte dhënë ishte që Luani të kthehej me të marrë letrën e komandës, shtypin dhe letrat e ushtarëve.

Urdhrin ushtar Luani e kuptonte drejt, si ligj dhe bëhej copë deri sa e zbatonte. Ndryshe ishte me Nani. Në jetë Nani nuk kishte pasur ndonjë vështirësi. Qe rritur, kur i thonë fjalës, si bima në serë. Besniku e dinte nga përvoja se periudha fillestare e shërbimit ushtarak është një nga periudhat më delikate e që ndikon së tepërmi te të rinjtë. Ata vijnë nga jeta civile në repart me të mira dhe të meta, por në repart, në këtë familje të madhe, kaliten edhe më mirë. Jo më kot populli e quan ushttrinë shkollë të madhe. Ja këto mendime i vinin Besnikut kur sillte në mendje udhën që kishin bërë të dy ushtarët e rinj, Luani e Nani, kur kujtonte bisedën me babanë e Luanit që kishte ardhur disa kohë më parë në garnizon.

Dikush trokiti në derë. Nënoficer Agroni hyri brenda dhe nderoi.

— Kemi ndonjë lajm nga Luani?

— Jo, shoku komandant!

Besniku bëri disa hapa nëpër dhomë.

— Jam shumë i shqetësuar për të, — tha ai.

— Ndoshta qëndron në fshat, — tha Agroni.

— Do të bënte mirë sikur të qëndronte atje, por...

— Si e mori urdhrin?

— Të kthehet. Nuk ma mori mendja që do të prishej koha aq shpejt. E di çfarë? Mendoj të nisim tre vetë në drejtim të fshatit për t'i dalë përpara. Ti, Nani dhe Hyseni. Unë me Astritin dhe ushtarët do të lëvizim teknikën, do të marrim, masa për të rivendosur ndërlidhjen.

Më vonë pllakosi heshtja. Jashtë, dëborë vazhonte të binte pa pushim. Shpati i malit kishte marrë një pamje akoma më kërcënuese. Nën të qëndronte si i tulatur parku i repartit.

— Nuk më pëlqen dëborë mbi shpatin e malit, — e theu heshtjen Agroni.

— Mendon se mos...

— Nuk i dihet.

— Eja të fillojmë nga puna.

Agroni hyri në fjetore me automatikun mbi sup.

— Ushtar Nani dhe ushtar Hyseni, pregatituni!

— Çfarë ka ngjarë?, — pyeti Nani.

— Zbato urdhrin!

Nani lëvizi nga vendi me përtesë.

Hyseni filloi të vishej. Në fjetore bënte ftohtë. Në dritare shihej dëborë që kishte rënë mbi parmakë. Atë çast hyri Astriti dhe thirri me zë të fuqishëm:

— Çohu! Alarm!

Ushtarët u çuan të gjithë nga krevetet dhe filluan të visheshin me shpejtësi.

— Po ne ku do të vemi?, — pyeti Nani.

— Ushtari nuk pyet ku do të vejë. Ai vete ku e dërgojnë. Kjo është çështje disipline, — tha Agroni.

— Eja të ikim!, — i foli Hyseni Nanit.

Hyseni qe shoku tij më i ngushtë. Ai qe mësuar me të dhe nuk i mbante mëri. Madje e njihte po aq mirë sa edhe veten. Por ata kishin karaktere të ndryshme. Ai e kishte zili natyrën e qetë të Hysenit, mendimin e tij të thellë e bindës, përpara të cilit detyrohej të jepej. Hyseni nuk ia falte askujt gabimin dhe aq më pak atij, Nanit, megjithëse e kishte shok. . .

Ata ecën pa folur.

Kishin futur në mes Agronin dhe çanin dëborën e bardhë në errësirë. Flokët e bardhë binin mbi supë, mbi bustinë, mbi gjoks. Ushtarët shtrëngonin armët dhe ecnin drejt fshatit.

Vetëm atëherë kur arriti në zyrat e kooperativës, ushtar Luan Sota ndjeu se qe lodhur. Agronomi Kujtim Pali, komandanti rezervist i topit të dytë, sa e pa i thirri:

— Ej, artilier, për ku kështu?

— Për në garnizon.

Agronomi qëndroi në këmbë përpara derës së zyrës pa e fshehur habinë.

— Në këtë kohë do të shkosh në bateri?

— Ushtari në çdo kohë duhet të vejë në repart.

— Hyr këtu brenda njëherë, të ngrohesh ca, pastaj shohim e bëjmë.

Ushtari shkundi dëborën nga trupi dhe iu afrua sobës.

— Sa ngrohtë!

— A je lodhur?

— E po edhe u lodha ca.

— Rri këtu tani të marrësh veten. Nesër i them unë komandantit si është puna.

— Nuk kam urdhër të qëndroj, o shoku Kujtim.

— Po ti ç'ke? i them unë Besnikut. Ka shumë dëborë dhe ka rrezik të humbasësh gjatë rrugës. Pastaj, ndonjë ujk. . .

— Pse e kam armën me vete?

Agronomi i vuri dorën në sup.

— Mirë, o Luan. Ngrohu njëherë.

Aty në zyrën e kooperativës, ushtari e ndjeu veten më mirë. Soba lëshonte nxehtësi dhe nga rrobat e lagura të ushtarit filloi të ngrihej një avull i lehtë, duke përhapur një erë karakteristike teshash të lagura. Ai që nisur që në mëngjes herët dhe mezi kishte arritur në orën 14.00 në zyrat e kooperativës. Në dimër erret shpejt. Kështu që Luani mendonte të nisej sa më herët me shpresë se mos arrinte në repart aty në orët e para të mbrëmjes. Po rruga që mbushur me dëborë. Të ftohtët të thante dhe ecja ishte e vështirë.

— A ke ngrënë bukë?, — e pyeti agronomi.

— Oj, të ngrënë!

— Mos ki turp. Mensën e kooperativës e kemi këtu pranë. Eja me mua të vemi të hamë.

— Të falemnderit!

— Dy herë bukë mund të hash, — ia priti Kujtimi, — kurse dy herë dru është mirë të mos marrësh.

Ata qeshën të dy. Luani e njihte mirë Kujtim Palin. Sa herë kishin bërë stërvitje së bashku. Shqipëria ushtarake i njohu e i lidhi me miqësi të fortë.

— Po andej a binte dëborë?, — e pyeti agronomi ushtarin.

— Binte.

— Koha ka marrë ters.

— Do të bjerë sa do të bjerë, prapë do të pushojë.

— Në garnizonin tonë kushedi si i kanë punët!

— Jam larguar që në mëngjes. Paska ndodhur ndonjë gjë?

— Jo, jo, pyeta ashtu kot, — tha agronomi.

— E di çfarë?, — foli përsëri Kujtimi. — Më shqetëson shpati i malit. Dëbora ka mundësi të rrëshqasë dhe të zërë poshtë teknikën, ndoshta edhe fjetinën.

— Jo, more!, — u habit Luani dhe u ngrit i shqetësuar.

— Ç'pate?

— Do të nisem.

— Ku?

— Në nënrepart.

— Je në vete? Sonte do të rrish këtu. Do të flesh në shtëpinë time. Nesër nisur që me natë, si thua?

— Kam urdhër të kthehem. Ti e di ç'do të thotë urdhër.

— E di.

Luani veshi kapotën, hodhi çantën në shpinë, mori armën në sup dhe doli te dera.

— Të falemnderit, shoku agronom!

— Rruga e mbarë të qoftë!

— Mirëupafshim!

— Mirëupafshim! Të fala m'i bëj komandant Besnikut dhe ushtarëve!

Zëri i agronomit arriti me vështirësi në veshët e ushtarit.

— Çdo gjë rreth e qark që zbardhur. Dëbora binde pa pushim. Bardhësia e pafund të vriste sytë, ndër-
sa të ftohtët të thante majën e hundës, veshët, faqet.

Besniku pa orën. Agroni me të dy ushtarët po bënte gjysmë ore që ishte nisur. A do ta gjenin vallë Luanin rrugës? Ndoshta e takonin në fshat. Atëherë çdo gjë do të qe në rregull. Edhe aty makinat s'po dëgjonin të ndizeshin. Njerëzit ishin të gjithë në park, ndërsa mbi ta ngrihej kërcënues shpati i malit me dëborën e bardhë. Po sikur dëborë të shkëputej ato gaste?

— Ti shtyjmë me duar, shoku komandant, — tha dikush.

Ideja ishte e mirë.

Besniku e aprovoi dhe urdhëroi që vetëm shoferi i topit të parë të merrej me ndezjen e makinës.

Ushtarët filluan të shtynin topin e parë.

— Hop, hop!

— Jepi!

— Më djathtas!

— Sillni një fener!

— Merre!

Topi eci përpara, i rëndë, me grykën e ftohtë të drejtuar lart. Ushtarët u frynin duarve herë pas here. Dëborë binte pa pushim. Era frynte me tërbim. Ngrentë nga toka dëborën dhe vraponte si e marrë për nga shpati i malit.

— U ndez makina, — thirri Astriti.

— Fitore!

— Tani puna do të ecë shpejt.

— Kujdes, shokë!

Fusha e garnizonit qe mbushur e tëra me dëborë. Rrugicat e vogla e të ngushta nuk dalloheshin fare. Çatitë e ndërtesave qenë mbuluar dhe dukeshin sikur rënkonin nën peshën e dëborës.

Sa kohë kishte Luani që ecte në dëborë? Nuk e

dinte me saktësi. Dinte vetëm që kishte kaluar shumë kohë duke ecur në atë shkretëtirë të bardhë. Këmbët i qenë lagur dhe rënduar. Deri sa qe ditë, qe orientuar mirë, po tani që ecte vetëm në mes të errësirës së natës dhe dëborës, e kishte më të vështirë. Komandanti dhe shokët e prisnin me siguri.

Dëborë nuk kishte ndër mend të pushonte. Por, në fund të fundit, dëborë bënte punën e saj, ndërsa Luani të tijën. Megjithatë, ajo ia vështirësonte rrugën, sikur donte ta pengonte të mos arrinte në repart, të thyente urdhrin, ta turpëronte përpara komandant Besnikut, përpara Agronit dhe shokëve. Sa do të donte Luani të ishte midis tyre, në rresht me ta! Sa mirë e ndiente veten në një rresht me shokët! Sa herë në ditë futej në rresht? Dhjetë, pesëmbëdhjetë herë? Po, atje, midis tyre, e ndiente veten të fortë, të sigurtë, të aftë t'u bënte ballë edhe vështirësive më të mëdha.

Luani çante me vështirësi përpara, ndërsa në mëndje sillte shokët, kujtonte bisedat, fjalët e kujdestar Astritit, i cili në një mbledhje e kishte kritikuar se nuk e kopsiste pullën e sipërme të kapotës, kurse Nani e kishte bërë për ujë të ftohtë, si i thonë fjalës, se kishte shkurtuar kapotën: «Kapota është çatia e ushtarit», — kishte thënë Astriti: «Eh, Nani, Nani! S'vure mend, që s'vure mend».

Luani qëndroi pranë një peme. U mbështet dhe mori frymë thellë. Këmbët dhe duart po i mbërdhinin së tepërmi. «Sonte do të rrih këtu. Do të flesh në shtëpinë time. Nesër nisur që me natë». Si të bënte, të kthehej pas, në fshat? Atje e priste zjarri i ngrohtë, biseda e këndshme me agronomin. Kurse këtu bënte vetëm ftohtë. Forcat e kishin lënë dhe ushtari i ndiente se nuk ishte më në gjendje të ecte përpara.

«Ç'u bë gjithë ajo fuqi që kisha në mëngjes, para se të nisesha? Ku vajti? Po sikur ai shoferi trim të ishte gjallë, vallë, ç'do të bënte tani?», — foli gati si me vete Luani.

Dikur në një libër kishte lexuar për një ngjarje nga provokacionet në kufi. Ajo pjesë i kishte lënë mbresa të thella:... Në një sektor të frontit qenë mbaruar predhat e topave. Artilierët kërkonin municion. Komanda e repartit i nisi me një kamion. Shoferi ia kishte shkelur gazin makinës në fund, që të arrinte sa më shpejt tek artilierët. Armiqtë që përtej kufirit e qëlluan me artileri. Asgjë? Pastaj iu qep nga lart një aeroplan armik i cili e qëllonte në çdo metër. Predhat pëlcisnin majtas, djathtas, përpara fare, afër makinës, po shoferi nuk qëndroi asnjë çast. Ai pothuajse fluturonte. Shoferi mund t'i fshihej syrit të pilotit duke lënë makinën në mes të rrugës dhe vetë të qëndronte poshtë ndonjë peme a guve, por nuk e bëri. Vendosi që ai të vdiste në timon, dhe predhat të arrinin te topat e artilierëve. Aeroplani nuk iu nda, e qëllonte vazhdimisht me mitraloz. Në një çast shoferi ndjeu se si kabina u shpua në disa vende. Ai nuk e hoqi këmbën nga gazi. Pozicionet e artilerisë tani ishin afër. Një predhë e goditi në shpatull. Ju morën mendtë nga dhe mbja. Fuqitë nisën ta lëshonin. Po prapë ai nuk e la timonin. As këmbën nuk e hoqi nga gazi. Sediljet dhe çizmet u mbushën me gjak. Shoferi shtrëngoi dhëmbët. Edhe pak, edhe pak... dhe do të mbërrinte. Artilierët e gjetën me kokën mbështetur në timon, pa ndjenja. . .

— Ec përpara, Luan, — i thirri vetes me zë të lartë.

Këmbët mezi lëvizën. Ato qenë bërë të ftohta si

dru. Ushtarit iu duk se në vend të këmbëve kishte vë-
në proteza prej druri dhe mezi çapitej.

«Po sikur të shtrihem pak këtu mbi dëborë e të
çlodhem?», — mendoi.

«Do të të zërë gjumi, — i tha një zë. — Do të të
mbulojë dëborë dhe pastaj...».

Ç'ishte ky zë? Mos i foli njeri? Apo kishte folur
me veten e tij? E mori me mend se nuk duhej të ishte
larg nga repartit, prandaj duhej të mblidhte forcat dhe
të ecte, të bënte ashtu siç bëri shoferi. Përshkoi edhe
disa metra. Pastaj, që larg pa një dritë të vogël si
flakë qiriri.

— Hej! Hej! — thirri.

Zëri mezi i doli. Iu morën mendtë dhe u rrëzua
mbi dëborë. Gjithçka i sillej përqark. Mos ishte në
ëndërr? Jo, nuk po shikonte ëndërr. Ra mbi dëborë
dhe nuk kishte fuqi të ngrihej... .

— Ç'është ajo gjë e zezë atje?, — foli Nani.

— Ku?

— Ja!

Ushtarët iu afruan asaj gjëje që nxinte mbi dë-
borë.

— Ky është Luani, — thirri Agroni.

— Shpejt, ta marrim në krahë dhe të kthehemi në
repartit.

Flaka e disa të shtënave çau errësirën e natës
ndonja dyqind metra më tutje. Pastaj dikush foli.

— A ka njerëz aty?

— Më duket si zëri i komisarit të repartit, — tha
Hyseni.

— Kanë ardhur për ndihmë!

— Këtu jemi, shoku komisar. Gjetëm ushtar Luanin.

Drita elektrike sa vinte bëhej më e madhe, deri sa u afrua fare. Komisari i repartit, agronomi me disa fshatarë të tjerë u takuan me ushtarët, morën Luanin pa ndjenja dhe u nisën për në garnizon.

Parku ishte boshatisur. Ushtarët u frynin duarve dhe vështronin shpatin e malit. Astriti mblodhi fenerët dhe i vendosi mbi tavolinën e mensës në një rresht të drejtë. Besniku shikonte shpatin e malit. Ushtarët dhe teknika qenë jashtë çdo rreziku. Ai i kishte marrë të gjitha masat. Mendja i punonte vetëm për ushtar Luanin.

Atë çast nga shpati i malit u shkëput një masë e madhe dëbore. Ajo u var poshtë me një zhurmë të llahtarshme dhe mbuloi pjesën më të madhe të parkut.

— Makinat dhe topat janë në vend të sigurtë, — foli Besniku dhe mori frymë lirisht. Ata kishin fituar.

Te dera e hekurt e nënrepartit bëri ballë një grumbull i madh njerëzish, ushtarakë dhe fshatarë. Besniku njohu midis tyre komisarin e repartit, agronomin, Agronin dhe plot ushtarë të tjerë.

— Shoku komisar, në nënrepart. . .

— Qetësohu! Si jeni?

— Ju uroj shëndet!

— Si i ke ushtarët?

— Janë të gjithë mirë, shoku komisar, vetëm një. . .

— Ne u bëmë merak dhe u nisëm për te ju. Me thënë të drejtën nuk na pëlqeu koha. Në fshat takuam agronomin. Ky mori me vete të gjithë efektivin

e topit të tij dhe u nisëm. Rrugës takuam ushtarët e baterisë dhe Luanin që kishte rënë mbi dëborë, po mos u shqetësoni, Luani është mirë, — tha komisari.

Dalngadalë ushtari erdhi në vete, po nuk e kuptonte përse ishin grumbulluar afër tij shumë njerëz. Po komisari i repartit dhe agronomi si kishin ardhur vallë? Mblodhi forcat dhe pyeti:

— Ku jam?

— Në bateri, midis shokësh!, — i tha komisari.

PËR DRITËN E SYVE...

Mjeku ishte me lejën e zakonshme. Kur erdhi ambulanca e spitalit për ta marrë për një urgjencë, u ndodh në shtëpi. Qëndronte pranë tavolinës me temën e disertacionit përpara, temë që do ta mbronte në këshillin shkencor të spitalit për të marrë titullin Kandidat i Shkencave Mjekësore. Në atë material që shkruirë puna e pesëmbëdhjetë vjetve. Kur kishte ardhur në fillim, reparti okulistik as që ekzistonte. Iu desh të punonte me këmbëngulje, të përgatiste njerëzit, të studjonte e të thellohej më tej për ngritjen e tij teknikoprofesionale. Por të gjitha këto nuk qenë kaq të lehta. Gjatë kësaj kohe ai shëroi kushedi sa ushtarë, punëtorë e fshatarë.

Mjeku i lexonte të gjitha ato faqe që kishte shkruar dhe ndonjëherë nuk i bëhej të besonte: «Vërtet unë i kam operuar gjithë këta ushtarë e punonjës? Si kaluan pesëmbëdhjetë vjet?». Por pasqyrat, shifrat, diagramet flisnin të vërtetën. Me gjithë përvojën e madhe që kishte fituar në operacionet e syrit, prapë ditën që mbrojti disertacionin përpara shokëve të katedrës së kirurgjisë e ndjeu veten si një nxënës fillestar. Ata e vështronin dhe e dëgjonin me kujdes. Foli rreth dyzet minuta, projektoi diafilma në një perde

të bardhë, demonstroi disa teknika operatore nga më të rejat. Duke u futur thellë në problemet e temës së disertacionit, ai i kaloi emocionet e para dhe e ndjeu veten zot të situatës. Në rreshtin e parë qëndronte profesori plak, i thinjur e pak i kërrusur nga pesha e viteve, i cili e kishte ndihmuar vazhdimisht me këshilla dhe me literaturë.

Së shpejti mjeku do ta mbronte temën përpara këshillit shkencor. Merrej me korrigjimin dhe plotësimin e punës së tij shkencore. Hodhi sytë nga dritarja e dhomës dhe pa një qiell të bukur të tejdukshëm.

«Vjeshtë...», murmuriti, «vjeshtë e bukur shqiptare.»

Pemët i kishin lëshuar gjethet përtokë. Era luan-te me to, i ngrente lart, i përplaste pas mureve të pallateve ose i tërhiqte rrëshqanthi në asfaltin e rrugës.

Pastaj shkëputi vështrimin nga dritarja dhe u përqëndrua përsëri në leximin e disertacionit: «Me bindje të plotë shpreh mendimin se ky punim nuk i përket një individi, por është fryt i punës së gjatë dhe plot devotshmëri të të gjithë kolektivit të klinikës për të vënë në jetë mësimet e Partisë e të udhëheqësit tonë të dashur, shokut Enver Hoxha...».

Në këtë çast një bori makine u dëgjua poshtë, në rrugë, me ndërprerje të shkurtra shqetësuese. U ngrit dhe vështroi nga dritarja. Një autoambulancë e bardhë qëndronte përpara hyrjes së pallatit.

«Do të ketë ardhur ndonjë urgjencë...», — mendoi.

Zbriti shkallët me nxitim, hipi me nxitim në makinë dhe pas disa minutash u ndodh në sallën e operacionit të klinikës okulistike. Mbi tavolinën e operacionit e priste një urgjencë.

Ushtar Resuli rinte shtrirë në krevat, kur mjeku hyri në dhomë për të bërë vizitën. I sëmuri që lidhur me garzë të bardhë në të dy sytë rreth e përçark kokës dhe dukej si një qenie e çuditshme, e zhytur në atë bardhësi ku shkëlqente pastërtia e rregulli.

— Si jeni?, — e pyeti mjeku duke iu afruar shtrahur.

Resuli nuk u përgjigj.

Mjeku i mati pulsën dhe u hodhi një sy plagëve të sipërfaqshme të mjekrës dhe të duarve.

— A ka qenë i qetë gjatë natës?, — pyeti të sëmurët.

— Jo, doktor, — u përgjigj Naimi, një oficer i vjetër që e kishte shtratin pranë Resultit.

Mjeku hapi kartelën dhe përqëndroi vështrimin te fletëtemperatura.

— 40 gradë, — murmuriti me vete.

«Po me sytë si do t'i vejë puna? A do t'i kthehet vallë shikimi? Po sikur të mos...».

Ai nuk e përfundoi mendimin. Mendimi i mbeti përgjysmë dhe nuk deshë ta çonte deri në fund. Vërtet që ai gjatë operacionit bëri gjithçka, nxori të gjitha trupat e huaj që qenë futur në sytë e ushtarit, por konjuktivat qenë të gjakosura, kornetë vende vende paraqisnin të çara. Mjeku e kuptonte mirë se ç'donte të thoshte të dëmtohej korneja. Kjo ishte një lloj sikur të vije përpara syve një perde të trashë, e cila nuk do të përshkohej dot nga rrezet e diellit.

Mjeku doli nga dhoma pasi vizitoi edhe të sëmurët e tjerë. Pas vizitave u mbyll në dhomën e tij, hapi çantën dhe nisi korrigjimin. Lexoi një faqe, por e kuptoi se nuk e kishte mendjen. Si do t'ia bënte ushtar Resultit? Për atë interesoheshin të gjithë: organizata e partisë, komanda, drejtorja, të sëmurët, ai vetë.

Një ditë pati një bisedë me nënën e Resultit, e cila sapo kishte ardhur nga fshati. Gruaja rrinte përpara mjekut, e dëshpëruar dhe me lotë në sy.

— Si thua, doktor?

— Do të bëjmë çmos që ta shpëtojmë, nënë. Mos u bëni merak. Por ju duhet ta dini se dëmtimet janë serioze. . .

Gruaja që mbledhur nga dhembja sa një grusht dhe e vështronte mjekun me vëmendje.

— Të paktën të shikojë me një sy, mos mbetet fare.

— Ne do të bëjmë gjithçka është e mundur.

— Doktor, — tha ajo, duke iu afruar, — unë mund të jap edhe syrin tim po që nevoja. Ma hiq një sy dhe vërja djalit, të keqen nëna!

Kjo ishte diçka e papritur. Mjekut iu bë një nyjë që po e mundonte. Nëna që afruar fare pranë dhe e shikonte në sy.

Ushtar Resuli ishte qetësuar. Ai rrinte shtrirë dhe fliste më të rrallë. Qetësia e tij ishte vetëm në dukje, se përbrenda jepte e merrte me vetveten. Mendohej se si do të bëhej me të. A do ta shikonte më diellin me sy, kur të dilte nga spitali? Do të qëndronte në shtëpi dhe që andej do ta dëgjonte zhurmën e traktorit që u binte arave lart e poshtë duke hapur me mijëra brazda. Do ta merrte me mend se si usta Hasani lëvishte levat e rënda të traktorit, se si merrte kthesat qosheve të arave dhe fillonte të hapte brazda të reja. Sa bukur! Kurse Resuli nuk do të shikonte asgjë. Ai vetëm do të dëgjonte kollitjen e motorit dhe të tjerat duhej t'i merrte me mend.

Ky mendim po e mundonte jashtëzakonisht. Jo vetëm ditën, por edhe natën. Në fakt ushtar Resuli

nuk merrte vesh se kur ishte natë e kur bëhej ditë. Ai qe zhytur në errësirë dhe nuk shihte asgjë, as të sëmurët, as mjekun, as infermieren, as dritaren, nga ku mund të dukeshin qielli, pemët, njerëzit që ecnin, makinat që lëviznin. Jo, nuk shikonte asgjë nga këto.

— Ushtar Resuli!

Ai i njihte tani njerëzit vetëm nga zëri. Ai që fliste ishte fqinji i tij, oficeri i vjetër, Naimi.

— Urdhëro, shoku Naim!

— Si dukesh sot?

— Diçka më mirë.

— Të lumtë! Ashtu të dua. Njeriu në jetë duhet të jetë kurajoz dhe guximtar. Kur çliruam Oroshin dhe dogjëm kullat e tradhtarit Gjon Marka Gjoni, na u plagos në këmbë një shok partizan. E morëm në vig dhe e shpunë në spital. Mjeku e operoi pa narkozë.

— Vërtet?, — pyeti Resuli.

— Po!

— Si është e mundur? Pa narkozë duhet të çmendesh nga dhembjet. . .

— Në jetë çdo gjë është e mundur po të kesh vullnet. I plagosuri këndonte, mjeku këndonte, komisari këndonte, duke mbajtur llampën me vajguri për të bërë ndriçim.

— Shpëtoi?, — pyeti ushtari.

— Po.

— Me një këmbë bëhet si bëhet. . .

— Prapë fillove?, — i tha Naimi duke ngritur pak zërin.

— Kurse unë. . .

— Ti je djalë i ri, gjithë shëndet. . .

Resuli nuk foli. Ai e dinte se të gjithë shokët e repartit që vinin për ta parë, komandanti i togës, të

sëmuret e dhomës, nëna, mjeku, i thoshin kështu që të mos dëshpërohej, që t'i bënin qejfin. Por ai nuk ishte fëmijë dhe e kuptonte se gjendja e syve qe serioze. Sa herë futej në dhomën e errët mjeku ia hiqte garzat, po Resuli nuk shihte asgjë. Nuk shihte ndoshta ngaqë dhoma qe e errët, si një natë dimri. Mjeku e merrte, e vendoste pranë biomikroskopit dhe ia kontrollonte pamjen me kujdesin më të madh.

— Hapi sytë!

— Doktor, unë nuk shoh asgjë!

Mjeku nuk fliste.

— Përse nuk më nxirrni në dritë?

— Është herët akoma.

Në heshtje ia lidhte sytë me garza dhe infermierja e merrte për dore për ta shpënë në krevat. Këtë dialog Resuli e bënte gati 3 herë në javë në dhomën e errët me mjekun që e kuronte.

Çdo ditë në sallën e mbledhjes së mëngjesit mjekët e rojës raportnin mbi gjendjen shëndetësore të ushtar Resulit. Resuli qe bërë i njohur në të gjithë spitalin. E njihnin mjekët, infermieret dhe shumë të sëmurë të tjerë. Edhe bisedën e nënës me mjekun e kishin marrë vesh të gjithë. Në këtë bisedë të shkurtër midis nënës dhe mjekut kishte diçka sublime. «Ma hiq një sy dhe vërja djalit, të keqen nëna!».

Mjeku së shpejti do të mbronte disertacionin. Tema që ai punonte kishte lidhje të ngushtë me dëmtimin e syve të ushtar Resulit. Vazhdimisht ai kërkonte literaturë të re, metoda të reja mjekimi. Natën vonë, i afrohej telefonit të shtëpisë dhe pyeste infermierën e rojës së pavionit të okulistikës.

— Jam unë. . .

— Ju njoha nga zëri, doktor, urdhëroni!

— Si është ushtar Resuli?

— Po fle.

— Fle, apo bën sikur fle?

Infermierja zihej ngushtë nga kjo pyetje e papri-
tur.

— Mua më duket se fle.

— Temperatura sa është?

— 37 gradë e gjysmë.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!

Ditët po shkonin njëra pas tjetrës. Po afrohej nëntori. Jashtë binte shi, një shi i rrëmbyer që përplasej në xhama me forcë. Era tundte pemët, kalonte përmbi çatitë dhe, me një vrap të çmendur, largohej në drejtim të kodrave të qytetit.

Pak ditë e ndanin nga mbrojtja e disertacionit. E mendonte veten përpara auditorit, përpara anëtarëve të këshillit shkencor, që e dëgjonin me vëmendje. Pasi të mbaronte së lexuari autoreferatin, ata do t'i bënë pyetje rreth temës, rreth problemeve që trajtonte në punën shkencore. Në ato njëqind e ca faqe që kishte shkruar që përqëndruar puna e pesëmbëdhjetë bulluar gjithë përvoja e klinikës që drejtonte, në ato shifra bëhej fjalë për operacione, për njerëz të diluar nga ai dhe kolegët e tij, për njerëz që dinin nga spitali me gëzimin e natyrshëm se shikonin përsëri, se ishin në gjendje të punonin, t'i jepnin akoma shoqërisë. A kishte vallë gëzim më të madh për njerëzit që shërbenin në atë klinikë?

Po me ushtar Resulin si do të shkonte mjekimi? Ç'do të bënte ai po të mos shikonte nga njolla e bardhë që mund t'i krijohej përpara bebes së syrit? A do të

pyetja e dot me errësirën? Nga përpunimi kirurgji-

kal që i kishte bërë plagës korneale, varej dhe pamja që do të rifitonte ushtari. A e kishte bërë vallë mjekimin ashtu siç e përshkruante në punën shkencore? Ai që i bindur se asgjë nga ato që kishte shkruar nuk pat lënë mangut. Operacionin e kishte kryer me kujdesin më të madh. E megjithatë...

Përvoja e kishte mësuar mjekun që të mos nxitohet. Dëshirat janë të mira, por në operacione ka dhe të papritura, ka komplikacione të afërta e të largëta, të cilat mjeku duhet t'i ketë gjithmonë parasysh. Mjekun e shqetësonte gjendja shpirtërore e ushtarit. Ai nuk duhej të binte moralisht. Një ditë i solli librin «Përsëri në këmbë» dhe iu lut oficer Naimit që t'ia lexonte me zë pjesë-pjesë.

Një dorë e druajtur trokiti në zyrën e mjekut.

— Hyni!

— Një oficer i ri dhe dy ushtarë u paraqitën te dera, veshur me bluza të bardha.

— Urdhëroni!

Oficeri bëri disa hapa përpara i druajtur, duke vërtitur kapelen nëpër duar.

— Unë...

Ai u kollit pak dhe bëri edhe dy hapa përpara.

— Ne jemi shokë të ushtar Resulit.

— Ashtu?

— Po, shoku doktor.

— Çfarë doni?

— Po ja... duam të dimë nëse... nëse do të shikojë Resuli pasi të dalë nga spitali. Shokët e togës janë të shqetësuar për këtë dhe duan të dinë...

Ndërkohë qenë afruar dhe ushtarët pranë tryezës së mjekut dhe po e shikonin të shqetësuar. Në sytë e

mjekut ata donin të gjenin përgjigjen për pyetjen që i mundonte; a do të shikonte shoku i tyre?

Pyetja ishte e thjeshtë, e qartë. Por ç'mund t'u thoshte mjeku shokëve të Resultit? A do ta kuptonin ata drejt situatën në të cilën gjendej ai? Edhe për mjekët vetë ka situata të tilla të vështira, kur jeta e të sëmurit është në presë të thikës dhe lëkundet sa nga njëra anë në tjetrën. Aq më tepër me syrin, që është një organ kaq delikat, kaq i brishtë. Ndoshta mjeku me shokët e tjerë të klinikës edhe mund të mos ndër-hynin. Rasti që i rëndë dhe askush nuk do t'u thoshte gjë sikur të mos e operonin. Por ata bënë atë që u thoshte ndërgjegjja e tyre, si njerëz të rinj, si luftëtarë të vijës së parë, dhe nuk e përfillën rrezikun. Duhej vepruar sa më parë. Koha, për rastin e ushtar Resultit, peshonte më shumë se çdo gjë. Ata morën vendim dhe e operuan.

— Ju jeni komandanti i tij, shoku oficer?

— Si urdhëroni!

Mjeku heshti një hop, sikur deshi t'i zgjidhte fjalët që do të thoshte.

— Unë mund të them se shoku juaj është jashtë çdo rreziku për sa i përket jetës. . .

— Vërtet?, — pyeti oficeri, duke parë ushtarët në sy i gëzuar.

— Po a do të shohë?, — nguli këmbë Agroni, sanitari që i skuqnin faqet nga shëndeti.

— E vërteta është se tani sytë e Resultit kanë një përmirësim të madh, dhe. . .

— Ne duam të dimë, — e ndërpreu mjekun ushtari faqekuq, — nëse do të shohë Resulti, doktor. Ne ishëm tek ai dhe me sa kuptojmë, Resulti lufton me veten.

Oficeri aprovoi me kokë mendimin e ushtarit, pastaj, duke u kthyer nga mjeku, tha:

— Ushtar Resuli është njeriu më me humor që kemi në togë. Kur se tani nuk flet, nuk bën shaka. Ne nuk dimë se ç'të bëjmë për të.

— Ju duhet t'i flisni vazhdimisht për repartin, për fshatin, — tha mjeku.

Me nënën e Resultit mjeku e kishte akoma më vështirë të bisedonte. Ajo ishte nënë dhe vuante shumë shpirtërisht. Por, që prej disa ditësh, nëna nuk po e pyeste më për fatin e syve të djalit. Ndoshta mendonte: «Ai është i zanatit dhe i di punët më mirë se unë».

Mjeku hyri në dhomën e errët ku kishte biomikroskopin dhe u ul mbi një stol. E ndjeu veten pak të lodhur. Atë ditë kishte pasur shumë punë.

Jashtë frynte erë dhe binte shi. Bënte ftohtë dhe lagështirë. Një lagështirë që të hynte thellë, deri në koskë.

Data e mbrojtjes së disertacionit po afrohej. Lajmërimet qenë shpërndarë në të gjitha rrethet. Një ditë do të mblidheshin të gjithë në bibliotekën shkencore të spitalit dhe do ta dëgjonin. . .

Atë çast infermierja hyri në dhomë dhe qëndroi në këmbë.

— Doktor, ta sjell ushtar Resulin?

— Sille, të lutem!

Infermierja bëri të dilte, po mjeku e ndali.

— Ka njerëz tek ushtari?

— Po, doktor, është e ëma, dy shokë të tij dhe oficer Naimi.

Mjeku mori frymë thellë dhe ndjeu sikur u lehtësua. . . Sot ai do të hiqte garzat nga sytë e ushtar

Resulit dhe... do të shikonte rezultatin e punës së tij, të mjekëve, infermiereve, sanitarëve, të shokëve ushtarakë. Mjeku u çua dhe hapi perden. Drita e një dite nëntori të vrenjtur u fut me shpejtësi në dhomën e errët. Pemët qenë pa gjethe. Oborri përpara spitalit qe i lagur. Atë çast porta e jashtme e hekurt u hap dhe i la rrugë të lirë një autoambulance të bardhë që hyri brenda me shpejtësi të madhe.

«Me siguri ndonjë urgjencë, — mendoj. — Jeta është në lëvizje, ditën dhe natën».

Dera u hap dhe brenda u futën infermierja me ushtar Resulin. Prapa saj, në korridor, mbetën nëna e ushtarit, oficer Naimi, komandanti i togës dhe ushtari faqekuq.

— Ulu Resul, këtu, përpara dritares!

Ushtari u bind. Më në fund kishte ardhur për të çasti kaq i pritur: ndjeu se duart po i dridheshin dhe, për të mos e vënë re, kapi anët e karriges.

Kujtoi për një çast Din Hykën e romanit «Përsëri në këmbë». Tani, Resuli kishte fituar qetësinë. I kishte vënë vetes një qëllim në jetë. Sido që të ndodhte, nuk do të binte në dëshpërim e pesimizëm, por do të punonte me mish e me shpirt për kooperativën, për njerëzit, për atdheun, për ta bërë jetën më të bukur e më të begatshme. «Në jetë çdo gjë është e mundur po të kesh vullnet». Oficer Naimi kishte të drejtë. Partizanët gjatë luftës kishin kaluar vështirësi shumë më të mëdha dhe nuk u përkulën. Mjekët partizanë kishin operuar këmbë me sharrë druri, pa narkozë. Këto gjëra sot dukeshin si të pabesueshme. E megjithatë ato kishin ngjarë në ditët e vështira të luftës.

Mjeku zgjidhi nyjën e fashos dhe nisi ta çmbështillte me kujdes e mengadalë, bile shumë ngadalë. Resuli do të donte që mjeku të shpejtonte dhe të mos



e mundonte me atë ngadalësi.

— Ki durim, Resul!

Siç duket ai ia kishte kuptuar mendimin. Ushtari u qetësua, e la trupin të lirë dhe filloi të numëronte me vete rrotullimet e bendës së gjatë.

— Një, dy, tri, katër, pesë, gjashtë...

Pastaj fasha ra poshtë dhe mjeku pa sytë e ushtarit, që i mbante të mbyllur sikur të kishte frikë t'i hapte.

— Ushtar Resuli, hapi sytë!

Ushtari përpëliti qepallat.

— Unë shoh!... Unë shoh!, — thirri me sa zë pati.

Mjeku buzëqeshi. Infermierja mori dorën e ushtarit që dridhej dhe ia shtrëngoi me dashuri prej motre në të sajat!

— Shoku doktor! Shoqja infermiere! Unë shoh!

Kur ushtar Resuli doli nga dhoma, u takua me të ëmën. Nëna rrinte në korridor, në këmbë, pranë një dritareje, e gjatë, e dobësuar nga netët pa gjumë dhe nga shqetësimet që e kishin brejtur tërë ato javë.

— Nënë, unë të shoh!

— Biri i nënës!

Ata u përqaftuan. Nënës nuk i besohej. Kishte frikë se mos gëzimi që ndiente ishte vetëm një ëndërr. E zbetë, me duart që i dridheshin, e shqetësuar, ajo i tregoi një shami.

— Çfarë ngjyre është kjo, bir?

— Ngjyrë e kuqe.

Mjeku, infermierja, oficer Naimi, komandanti i togës dhe ushtar Agroni ecnin pas tyre të mbushur me një gëzim të papërshkruar.

PËRMBAJTJA

Bardhësi	3
Kur doli dielli majë malit	35
Drita më e madhe	48
Çanta sanitare	60
Ura	69
Pesëqind metra larg shtëpisë	81
Zbuluesit	88
Një radiogram	96
Autokolona nuk do të kalojë	103
Ato ditë lufte	109
Midis shokësh	125
Për dritën e syve	138